



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**

**“Inxhinieri Ekonomike”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**“Universiteti Politeknik i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Edlira Martiri

2. Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli

Korrik 2023

**Për Programin e studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike” ofruar nga Institucioni i  
Arsimit të Lartë, Universiteti Politeknik i Tiranës**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Prodhim Menaxhimit (FIM)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 355, datë 12.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 181, datë 16.04.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (Viti akademik 2021-2022)	19 PAE / 19 PAK
18	Numri i studentëve: 2019 - 2022	109 Studentë 2019-2020 85 Studentë 2020-2021 85 Studentë 2021-2022
19	Komente / të tjera:	-



# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

## Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike” është një program studimi me kohë të plotë, me 180 kredite, që ofrohet në 3 vite akademike në gjuhën shqipe. Në përfundim të këtij programi studentët pajisen me diplomën Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”. Ky program është licensuar me VKM Nr. 355, datë 12.05.2010. Programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2010-2011.

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”, ofrohet nga Departamenti i Prodhim Menaxhimit, njësi e vendosur në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit Politeknik të Tiranës. Gjithashtu në këtë program studimi japin kontributin e tyre në mësimdhënie edhe departamente të tjera të FIM. UPT është licensuar me VKM Nr. 215, datë 15.07.1991 dhe i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional dy herë. Së fundmi sipas VBA Nr.1, datë 07.01.2022 UPT ka marrë akreditimin institucional për 6 (gjashtë) vite.

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, UPT ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit për herë të parë të 10 programeve të studimit, nëpërmjet shërbimit AMS me shkresë Nr. 1880 Prot. Datë 16.11.2021.

Ky raport u përgatitur nga ana e Grupi të Vlersimit të Jashtëm (GVJ) dhe ka për qëllim vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”.

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me prioritetet akademike të institucionit dhe misionin e tij. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat e drejtimet akademike të UPT. Programi ka si objektiv kryesor formues t’u ofrojë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë mekanike dhe në fushat e biznesit. Programi i studimit synon gjithashtu t’u japë studentëve një përgatitje me spektër më të gjerë, veçanërisht në fushën e Inxhinierisë Industriale. Përmes kësaj synohet t’u ofrohet studentëve perspektiva më të mira lidhur me përshtatjen, fleksibilitetin dhe integrimin në tregun e punës dhe me kërkesat e industrisë jo vetëm në vend por edhe jashtë.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Ky raport është pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ekonomike", të ofruar nga Departamenti i Prodhim Menaxhimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, UPT. Për të hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) grupi i ekspertëve, Edlira Martiri dhe Ezmolda Barolli, u mbështet në 111 dokumenta që u aksesuan nëpërmjet shërbimit AMS, të cilat ishin të përfshira në Dosjen e Vetëvlerësimit të këtij programi studimi. Grupi i ekspertëve shqyrtoi gjithashtu disa dokumenta plotësuese të cilat u vunë në dispozicion gjatë vizitës dy ditore në institucion, informacione të faqes zyrtare të ëëbit të UPT, si edhe vlerësoi informacionet e marra nga takimet me personelin akademik, administrativ dhe studentët, sipas agjendës së planifikuar të vizitës. Vizitat në institucion u kryen në datat 22.06.2022 dhe 23.06.2022. Këto vizita, si dhe i gjithë procesi i vlerësimit të jashtëm nga ekspertët u asistua nga koordinatori teknik i ASCAL Z. Muhamed Prezja dhe Znj. Arjana Aliaj.

Për hartimin e RVJ ekspertët janë bazuar tek analizimi i dokumentave dhe përputhja e tyre me kriteret e kërkesat ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit "Bachelor" në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë dhe kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e planit mësimor sipas aktiviteteve dhe planit mësimor të detajuar, shpërndarjes së krediteve dhe orëve krahasuar me kërkesat e VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik në lidhje me këtë program studimi, infrastrukturës në mbështetje të programit dhe burimeve të tjera të nevojshme, mbështetjes së studentëve, sigurimit të brendshëm të cilësisë, etj.

Në përfundim raporti përmbillet me evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta të programit, si dhe dhënien e disa rekomandimeve. Në bazë të të gjithë analizës së bërë në raport, GVJ konkludon në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Ekonomike" bazur tek 6 fushat kryesore dhe ka bërë vlerësimin tërësor të programit.

Më datë 13.04.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 14/5 Prot., datë 13.04.2023 u përcoll Draft-Raporti në Institucion. Më datë 05.05.2023, përmes sistemit AMS dhe shkresës me Nr. 941/3 Prot., datë 02.05.2023, IAL përcolli komentet mbi Draft-Raportin. GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes komentet e IAL, argumenton si në vijim:

### Komentet e IAL-së:

Në lidhje me:

**Standardi I.2 Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 4

**Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.

GVJ Konstaton:

Programi i Studimit Bsc në "Inxhinieri Ekonomike", është një program që përmbush vizionin aktual të UPT, të përcaktuar në statutin e UPT dhe planin strategjik. *Në lidhje me emërtimin e programit të studimit, GVJ sugjeron që të përshtatet me kërkesat vendase, por edhe me standartet ndërkombëtare, të shihen kurrikula të tjera të ngjashme në universitete perëndimore.*

Grupi i punës, përgjegjës për hapjen e këtij program studimi, i ngitur me përfaqësues të Departamentit të Prodhim Menaxhimit dhe të Fakultetit të Inxhinierisë mekanike, i është referuar një sërë programesh të njëjta apo të ngjashme të ofruara në vendet e zhvilluara në Europë (Gjermani dhe Itali) dhe të ofruara edhe nga Universitete Politeknike në këto vende. Programi i studimit Bachelor në Inxhinierisë Ekonomike ka ngjashmëri me keto programe, psh përmendim **Ingenieria Gestionale** ofruar nga Universiteti Politeknik i Barit apo **Inxhinieri Ekonomike** ofruar nga Universiteti i Siegen. Profili që këto universitete i kanë dhënë programit të tyre të studimit, ka qenë (manaxherial apo financiar) në përputhje me tregun e punës në këto vende, sikurse edhe programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, duke qenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës në vend. Grupi i punës për hapjen e këtij programi studimi, ndër të tjera ka testuar edhe emërtimin e tij në tregun e punës dhe ka vendosur për këtë lloj emërtimi, si emërtimi që ishte më afër profilit të të diplomuarve në përputhje me atë që tregu i punës kërkon.

**Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

**Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

**Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.

GVJ Konstaton:

IAL përmban në strukturën e vet administrative disa njësi të rëndësishme, të cilat kanë funksionalitete të ndryshme në ndihmë të përmirësimit të marrëdhënieve të tij me tregun e punës. Kështu, GVJ konstaton që një prej tyre është Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila ka si focus orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës, etj. Në lidhje me ndjekjen e studentëve pas diplomimit të tyre dhe marrjen e informacioneve të rëndësishme prej tyre në drejtim të përmirësimit të kurrikulës dhe procesit mësimor, në maj të vitit 2021 u krijua shoqata Alumni e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (AIM). *Në lidhje me punësimin e studentëve, në Tabelën 8 të RVB nga 197 të diplomuar në*

*periudhën 2017-2021 në degën Inxhinieri Ekonomike, 138 janë të punësuar në përputhje me diplomën, një numër ky jo shumë i lartë.*

Bazuar në evidentimin e GVJ për punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, GVB e konfirmon këtë evidentim por GVB evidenton se pjesa më e madhe e të diplomuarve në Bachelor Inxhinieri Ekonomike, pas diplomimit, fillojnë studimet Master Shkencor në Inxhinieri Ekonomike, duke patur në këtë mënyrë profilin e nevojshëm dhe të kërkuar nga tregu i punës.

GVB, ndër të tjera nga studimet e bëra për tregun e punës ka evidentuar se tregu i punës preferon dhe kërkon të punësojë më së shumti të diplomuar në programe studimi Master më tepër sesa në nivelin Bachelor.

Gjithashtu, një pjesë e studentëve të diplomuar në nivelin e studimeve Bachelor, zgjedhin të mos punojnë (ose të punojnë me orare të shkurtuara) deri në përfundim të studimeve në nivel Master Shkencor.

**Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

**Kriteri 1.** Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar

GVJ Konstaton:

Për secilin vit akademik vëmë re që 68% e stafit është me gradën shkencore Doktor, pra më e lartë se mesatarja e fakultetit. Këtu sugjerojmë rritjen e kapaciteteve dhe mundësive për avancimin e titujve, për gjithë potencialin që mbart departamentin i Prodhim Menaxhimit.

Bazuar në evidentimin e GVJ, theksojmë se nga momenti i dorëzimit të dosjes së vëtvlerësimit për programin e studimit e deri në këto momente, rezultoi se në nivel Departamenti ka 4 (katër) staf akademik me kohë të plotë që kanë fituar titullin akademik Prof. Asoc, dhe 1 (një) staf PAE të rregjistruar në shkollën e Doktoraturës pranë UPT.

**Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.

GVJ konstaton që:

fusha e programit të studimit në Bsc në "Inxhinieri Ekonomike" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, por sugjerojmë një përfshirje dhe shkrirje dhe në nivel lëndor të disiplinave: Informatikë, Ekonomi, Menaxhim, apo të disiplinave të ngjashme që janë në varësi të Fakultetit.

Harmonizimi dhe shkrirja e disiplinave, në nivel lëndor, në pjesën më të madhe të lëndëve, bëhet në orët e seminareve dhe në detyrat e kursit.

Psh: në lëndë të tilla si: Menaxhim Operacionesh, Menaxhim i Cilësisë apo Bazat e menaxhimit të ndërmarrjeve, orët e seminareve ndërthurin konceptet manaxheriale me ato në fushëm e Inxhinierisë por edhe të informatikës.

Si psh: përdorimi i softëare në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe të planifikimit agregat apo menaxhimi i kompanive prodhuese shoqëruar me raste studimi të kompanive si Everest, Alumil etj. Madje përfaqësues të kompanive, ish studentë të programit të studimit Bachelor dhe Master Shkencor në Inxhinieri Ekonomike japin leksione të hapura, duke dhënë aplikimin e njohurive në fushën manaxheriale në Industri, dhe kjo duke sjellë eksperiencën e tyre.

**Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.

GVJ konstaton:

Në përmbajtje të programeve lëndore (syllabus), vëmë re që në pjesën e tyre më të madhe lëndët me formim të përgjithshëm janë të pakontekstualizuara (në formën e rasteve të studimit, në objektivat e tyre, në komentet e lektorëve për lëndët, apo në tematikat e veçanta të çdo jave), lëndët e profilit Ekonomi (p.sh. Mikroekonomi, etj) janë të paintegruara me çështje të inxhinierisë, si dhe lëndët e Inxhinierisë janë të pazbatuara në fushën e Inxhinierisë. *Sugjerohet një rishikim të programeve lëndore nën këtë filozofi, pra atë të integritetit të disiplinave të programit të studimit edhe në nivel syllabusi. Gjithashtu sugjerohet vendosjen e lëndëve me zgjedhje në Dokumentet e Planeve mësimore të Programit të Studimit si një listë e vecantë. Dhe së fundmi, sugjerohet përfshirja e temave bashkëkohore në kurrikul, pasi sot zhvillimi i teknologjisë parallel me atë të industrisë ka zhvendosur paradigmat si dhe ka mjaft impakt në rrafshin ekonomik (jo vetëm aplikativ), si p.sh. Industry 4.0, Printimi 3D, Teknologjia e Shkencave e Konstruksionit, Makinat inteligjente, Materialet Inovative, etj. Të gjitha këto tema mund të përfshihen në një lëndët vetme, të re, ku çdo javë të trajtohen tematika që mund të nxisin kreativitetin, inovacionin, dhe potencialin e studentëve pas përfundimit të studimeve.*

GVB sqaron që një pjesë e mirë e tematikave të sygjëruara, zhvillohen si tematika apo lëndë të vecanta. Për shembull:

Në lëndën Teknologji Mekanike, zhvillohen kapituj në lidhje me Industrinë 4.0, Scanimin dhe Printimin 3D. Pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit, përgjegjës për këtë program studimi, janë edhe laboratorët e: Skanimit dhe Printimi 3 D, Laboratori I Matjeve dhe Laboratori I Materialeve, të cilat janë rinovuar dhe pajisur së fundmi me pajisje dhe teknologji të re.

Lënda Shkencat e Konstruksionit, gjithashtu zhvillohet në këtë program studimi (për më tepër shih Planin Mësimor).

**Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.**

**Kriteri 3.** Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 7

**Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

GVJ konstaton:

Gjatë vizitës në IAL, në bazë të RVB, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton që programi Bsc në “Inxhinieri Ekonomike pasqyron në planin mësimor një disiplinë mësimore bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës, por që vazhdimisht nevojitet të përditësohet me zhvillimet vendase dhe ato globale. Sic kemi përmendur në kriteret e mësipërme, ka një strukturë mjaft të mirë lëndore brenda programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike. Megjithatë, përvec sugjerimit të përditësimit, atë të vendosjes së një lënde të re me zhvillimet e fundit, konstatohet që nuk ka një lëndë që zhvillon mendimin kritik, shkrimin akademik, apo metodat e kërkimit. Pjesa e kërkimit shkencor shihet gjithashtu shumë pak e reflektuar në programet e veçanta lëndore të programit të studimit. GVJ gjykon që për të zhvilluar *aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme, studenti duhet më parë të trajnohet në kryerjen e kërkimit shkencor.* Kjo mungesë bën që Kriteri 4 në këtë Standard të mos jetë i plotë, por vlen të theksojmë që këto aftësi në të vërtetë është e vështirë të plotësohet nga programe studimi bachelor. Nga ana tjetër vlerësojmë nxitjen e IAL për pjesëmarrje të studentëve në konferenca dhe aktivitete të tjera të ngjashme.

Sikurse edhe GVJ shprehet më sipër këto aftësi në të vërtetë është e vështirë të plotësohet nga programe studimi bachelor.

Në Planin Mësimor të Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, janë parashikuar të bëhen ndryshime në masën 20% për vitin akademik 2023-2024. Ndër të tjera do të jetë edhe përfshirja e lëndës Inovacionet në projektet inxhinierike, e cila do ti ndihmojë e aftësojë studentët me metodat innovative në projektet inxhinierike të cilat ndihmojnë në marrjen e vendimeve dhe në kontrollin e këtyre projekteve.

**Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

**Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.

GVJ konstaton:

GVJ, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve të tyre, të shpërndarjes së lëndëve dhe përmbajtjes së tyre, *sugjeron që, në përgjithësi, një pjesë e lëndëve inxhinierike kanë nevojë për një përditësim leksioneve, si dhe zbatim më konkret në aspektin ekonomik të orëve të seminareve, në mënyrë që natyra ndërdisiplinare e programit të studimit të konkretizohet sa më mirë për studentët.*

Sikurse edhe është cituar në RVB, figura e të diplomuarit në Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, është Inxhinier me njohuri dhe kompetenca në fushën ekonomike. Lëndët me

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Faqe 8



karakter Inxhinierik nuk mund të kenë një zbatim në fushën ekonomike, si psh lëndë të tilla si Vizatim Teknik, Shkenca Konstruksionesh, Shkenca e Materialeve etj. Në pjesën më të madhe të lëndëve është bërë përditësimi i leksioneve, dhe ky është një proces i përvitshëm duke synuar vazhdimisht adaptimin me ndryshimet në fushën e teknologjisë dhe industrisë.

Ndërsa në lëndë inxhinierike si Teknologji Mekanike trajtohen edhe analiza e kostove në trajtimin e Printimit 3D. Gjithashtu edhe në lëndën Impiante Industriale trajtohen koncepte të kostove dhe financiare për investimet në Impiantet Industriale duke u ndalur në tregues financiarë si psh ROI etj apo edhe në metodat e llogaritjes së kthimit të investimeve.

**Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

GVJ konstaton:

GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në prodhimin dhe menaxhimin e sipërmarrjeve dhe industrive, por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të vecanta aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore, nga të cilat do të përfitojë studenti. *Nevojitet të theksohet më shumë mendimi kritik nëpërmjet kërkimit shkencor dhe ngritjes së hipotezave, matjeve, eksperimenteve, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe parashirimit të rezultateve. Kjo është pjesa që mungon në programin e studimit Bsc në "Inxhinieri Ekonomike", pjesë që në fakt është e rëndësishme në programe të ngjashme ndërkombëtare.* Është për t'u vlerësuar fakti që departamenti çdo fund viti kalendarik zhvillon analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku diskutohet ndër të tjera edhe mbi arritjet e objektivave formuese të programit Inxhinieri Ekonomike.

Sipas përlllogaritjeve, raporti Teori/Praktikë qëndron si 1194 / (826 + 92 + 39.5), pra është në nivelet është 55.5% / 44.5%. Ky është një raport mjaft i mirë për ciklin bachelor. *Gjithsesi, sugjerojmë përditësimin e kurrikulës dhe me fusha të tjera që evidentojnë më tepër pjesën praktike të çdo lënde, shoqëruar me vlerat përkatëse në orë/ECTS, si dhe rritjen e krediteve dhe orëve përkatëse për dy lëndët: Praktikë Profesionale dhe Diploma.* Për ta përmbledhur, GVJ konstaton se ka një raport të përshtatshëm në ndarjen e veprimtarive formuese. Gjithashtu, natyra praktike e profilit duhet të saktësohet më qartë dhe në syllabus-et e lëndëve, në të cilat duhet të saktësohen orët në laborator dhe punët praktike në terma të krediteve.

Bazuar tek komentet që GVJ ka bërë, GVB gjykon si të padrejtë kontaktimin e bërë, kjo bazuar në aftësitë dhe kompetencat që duhet të marrë studenti gjatë periudhës së studimit në nivelin Bachelor. Qëllimi i studimeve Bachelor është përgatitja me aftësi dhe kompetenca të përgjithshme në fushën e Inxhinierisë dhe Ekonomisë. Kështu në këtë nivel studimi nuk mund të bëhen kërkime shkencore të mirëfillta apo ngritje hipotezash, kjo për faktin që këto kompetenca përfitohen në nivelin e studimit Master Shkencor. Lënda Metodat e kërkimit shkencor, zhvillohet në programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Ekonomike.

Për sa i përket matjeve apo eksperimenteve, këto studenti i kryen në thuajse të gjitha lëndët me karakter inxhinierik të cilat kanë të pasqyruar në Planin Mësimor edhe me kreditet përkatëse.

Gjithashtu për vitin akademik 2023-2024, është parashikuar rritja e krediteve të praktikës profesionale nga 3 Ects në 6 Ects.

**Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.

GVJ konstaton:

Sipas RVB, programi i studimit konsiderohet në përputhje me komponentët mësimorë që përbëjnë aftësitë formuese. Numri i studentëve që preferojnë të transferohen në UPT në Programin e studimit “Inxhinieri Ekonomike”, sipas Tabelës 7, RVB, është vetëm 1 (një) në vitin akademik 2020-2021, si dhe nuk ka reflektime të studentëve të larguar. *Të punësuar në Tabelën 8 janë 70% në përputhje me diplomën dhe 30% jo në përputhje. Ky raport duhet të shihet me prioritet nga Departamenti, për të rritur numrin e studentëve të punësuar në pozicione pune ku të ushtrojnë njohuritë e marra përgjatë viteve të ciklit bachelor.*

Sikurse jemi shprehur edhe më sipër (Standarti I.3, kriteri 2 dhe 3), bazuar në evidentimin e GVJ për punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, GVB e konfirmon këtë evidentim por GVB eidenton se pjesa më e madhe e të diplomuarve në Bachelor Inxhinieri Ekonomike, pas diplomimit, fillojnë studimet Master Shkencor në Inxhinieri Ekonomike, duke patur në këtë mënyrë profilin e nevojshëm dhe të kërkuar nga tregu i punës.

GVB, ndër të tjera nga studimet e bëra për tregun e punës ka evidentuar se tregu i punës preferon dhe kërkon të punësojë më së shumti të diplomuar në programe studimi Master më tepër sesa në nivelin Bachelor.

Gjithashtu, një pjesë e studentëve të diplomuar në nivelin e studimeve Bachelor, zgjedhin të mos punojnë (ose të punojnë me orare të shkurtuara) deri në përfundim të studimeve në nivel Master Shkencor.

**Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.

GVJ konstaton:

*GVJ sugjeron që ky program të orientohet pak më tepër drejt Menaxhimit të Industrive (siç e kemi cekur dhe në kritere të mëparshme), në mënyrë që të shfrytëzojë burimet njerëzore, infrastrukturën ekzistuese, mjediset e përbashkëta ku mund të zhvillohen projekte kërkimore apo detyra të natyrave të ndryshme në terren. Në këtë mënyrë ky program do gjendej saktësisht brenda njësisë së tij dhe mbi të gjitha do të plotësonte një drejtim kombëtar mjaft të rëndësishëm. Kështu, vendosja e një ose dy lëndëve të tjera me natyrë teknike, por bashkëkohore dhe të aplikueshme në industri, do e plotësonte më së miri këtë mungesë.*

Sikurse edhe kemi sqaruar më sipër, pjesa aplikative për koncepte që lidhen me menaxhimin e industrive, është bërë në orët e seminarit apo në leksionet e hapura, në lëndët me karakter manaxherial të tilla si Menaxhim Operacionesh apo Bazat e menaxhimit të ndërmarjeve.

Në Planin Mësimor të Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, janë parashikuar të bëhen ndryshime në masën 20% për vitin akademik 2023-2024. Ndër të tjera do të jetë edhe përfshirja e lëndës Inovacionet në projektet inxhinierike, e cila do ti ndihmojë e aftësojë studentët me metodat innovative në projektet inxhinierike të cilat ndihmojnë në marrjen e vendimeve dhe në kontrollin e këtyre projekteve.

**Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor**

**Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.

GVJ konstaton:

Nga RVB, ose nga dokumentacioni i dorëzuar, *GVJ nuk konstaton ndonjë procedurë që IAL ka vendosur të ndjekë në lidhje me metodat shkencore që studentët duhet të kenë parasysh për diplomën, shkrimin akademik, etj.* Kjo u konfirmua dhe gjatë vizitës. Dokumenti thotë që stafi që zakonisht ka minimum 3 studentë në udhëheqje dhe kjo e ka bërë situatën të menaxhueshme, pasi pedagogu udhëheqës është përgjegjës për cilësinë e temës së diplomës dhe jep vlerësimin e tij për procesin e mbrojtjes. Kjo situatë mund të ndryshojë kur numri i studentëve dhe temave të rritet.

Në *Ref\_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT, Neni 53, pika 1,2*, theksohen se çfarë duhet të përmbajë punimi I diplomës për nivelin e studimeve Bachelor, si më poshtë:

1. Teza e diplomës së ciklit të parë të studimeve është një punim, në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera, në fushat e programit përkatës të studimit.
2. Teza e diplomës përmban kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave projektuese ose/dhe zbatuese, probleme të prodhimit apo për të punuar me literaturën në fushën përkatëse.

Stafi akademik udhëzon dhe ndjek në detaje respektimin jo vetëm të afateve të përcaktuara në Departament për prodedurën e diplomës por edhe shkrimin dhe përmbajtjen e punimit.

**Standardi III.4. Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

**Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.

GVJ konstaton:

GVJ konstatoi si nga RVB, ashtu dhe nga vizita në IAL që Departamenti mbështet zhvillimin e metodave të reja innovative të mësimdhënies. *Por ka gjithmonë mundësi për të përmirësuar, sidomos në lidhje me infrastrukturën për mësimin online dhe laboratorët.*

Pas mbylljes së periudhës së pandemisë dhe me kthimin e studentëve në auditorë, bazuar edhe në shkresën e MAS, Nr. 6358, datë 08.11.2021, në lidhje me mënyrën e zhvillimit të mësimin, është ndaluar për çfarëdo lloj arsye mësimi online. Gjithsesi, duke qenë se në momentin e regjistrimit si studentë në UPT, studentët pajisen me adresë emaili të dedikuar *emër.mbiemër@fim.edu.al*, pedagogët e lëndëve përkatëse hapin klasat e tyre në Teams dhe vendosin në këto klasa virtuale të gjitha materialet që lidhen me lëndën: të tilla si leksione, ushtrime, raste studime, udhëzues për detyrën e kursit etj.

Gjithashtu, Departamenti i Prodhim Menaxhimit, përgjegjës për këtë program studimi, disponon disa laboratore të tilla si: Lab. i Matjeve, Lab. i skanimit dhe printimit 3D, Lab i saldimit, Lab i materialeve etj. Laboratorët përdoren jo vetëm gjatë procesit mësimor, për kryerjen e orëve të laboratorit por edhe për punimin e diplomave në fushën e inxhinierisë, për kryerjen e eksperimenteve dhe matjeve të ndryshme.

### **Standardi III.5. Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

**Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

GVJ konstaton:

GVJ vlerëson që të gjitha format e vlerësimit të njohurive të përmendura në kriterin 1 dhe 2 i japin mundësi studentit që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, por në disa nga lëndët e vitit të parë, vihet re në syllabus që kanë vetëm një provim të ndërmjetëm (në disa raste 2) dhe një provim final (Analiza Matematike 1 dhe 2, Algjebra, Vizatimi Teknik, Bazat e Informatikës, Mekanika Teorike, Statistikë, Fluidodinamika, Mekanika e aplikuar, Teknologji mekanike. Lëndët Hyrje në Ekonomi, Fizikë Teknike, Mikroekonomi, Parimet e Kontabilitetit, Drejtimi Financiar, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Bazat e Menaxhimit të Ndërmarrjeve, Analiza e Pasqyrave Financiare, Biznes Ndërkombëtar nuk ka të reflektuar seksionin Kontrollat gjatë semestrit, si dhe pjesë të tjera të syllabusit janë të paplotësuara.

Lënda CAD pohon që lënda kontrollohet me punë praktike, por nuk saktësohen sa detyra jepen, si dhe sa pikë merren në secilën prej tyre.

Lënda Bazat e Elektroteknikës nuk ka asnjë formë kontrolli gjatë semestrit.

*Së pari, GVJ sugjeron që format e vlerësimit të mos jenë të ngjashme për të tre vitet akademike. Gjatë vitit të parë të studimeve peshë e provimit përfundimtar mund të mbetet në masën 70-80%, ndërsa në vit të tretë, ku detyrat dhe projektet janë më komplekse, peshë e tyre të jetë rreth 50-60%.*

*Së dyti, sugjerohet që detyrat e kursit në ndonjë prej lëndëve të jenë në formën e "short paper", në mënyrë që studentët të trajnohen me mënyrën e të bërit kërkim shkencor.*

*Së treti, në syllabuset e lëndës, në sesionin Vlerësimi për lëndën të cilësohet jo në formë narrative,*

Në disa syllabuse nuk përkojnë cilësimet e vendosura në Kontrollin gjatë semestrit me shpjegimet nën Vlerësimi për lëndën. Në përgjithësi, lëndët kanë të organizuara në syllabuset e tyre në mënyrë të kënaqshme objektivat, temat e leksioneve e seminareve, etj, *por sugjerohet që të gjithë të rishihen dhe plotësohen në gjithe sesionet e tyre, të saktësohen qartë detyrimet semestrale të studentëve, frekuenca, detyrat, projektet, labororet, provimet e ndërmjetme, etj.* Syllabuset janë jo vetëm për stafet akademike, por edhe për studentët, e nëse shihen dhe me syrin e tyre, në raste të vecanta mund të krijojnë paqartësi tek ta.

Përsa i përket kontrollit gjatë semestrit, në varësi të lëndëve është përcaktuar edhe mënyra e kontrollit. Në përgjithësi në lëndët: Analiza Matematike 1 dhe 2, Algjebra, Vizatimi Teknik, Bazat e Informatikës, Mekanika Teorike, Statistikë, Fluidodinamika, Mekanika e aplikuar, Teknologji mekanike, janë planifikuar 1 deri në 2 provime të ndërmjetme dhe një provim final për shkak të ngarkesës së këtyre lëndëve dhe shkallës së vështirësive të tyre, duke mundësuar kështu edhe përjashtimin nga teza finale të pjesëve të cilat kanë qenë për studim në provimin e ndërmjetëm.

Për lëndët: Hyrje në Ekonomi, Fizikë Teknike, Mikroekonomi, Parimet e Kontabilitetit, Drejtimi Financiar, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Bazat e Menaxhimit të Ndërmarrjeve, Analiza e Pasqyrave Financiare, Biznes Ndërkombëtar, nuk ka provim të ndërmjetëm por vetëm profim final. Pjesë e vlerësimit final, është përveç provimit final (deri në 80 pikë) edhe detyra e kursit (deri në 10 pikë) si edhe aktivizimi në seminare (diskutimi apo detyra individuale). Kjo mënyrë vlerësimi është shpjeguar tek rubrika vlerësimipër lëndën.

Stafi akademik bazuar edhe në Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, ka parë të arsyeshme këtë mënyrë vlerësimi që pesha e provimit përfundimtar të jetë për të tre vitet akademike 70-80%.

Në lëndë të natyrës manaxheriale të tilla si Menaxhim i burimeve njerëzore dhe Bazat e menaxhimit të ndërmarrjeve, studentët përveç detyrave të kursit, kanë edhe detyra individuale (që vlerësohen në seminare me deri në 10 pikë) duke trajtuar raste studimi ose duke bërë studim të një problematike në studime të ndryshme duke e organizuar materialin në formën e një short-paper. Të gjitha gjetjet dhe problematikat diskutohen në seminare.

**Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

**Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.

GVJ konstaton:

Institucioni nuk ka një sistem elektronik për testimin dhe vlerësimin e studentëve. *Sugjerojmë që UPT të vendosë bashkëpunim me AADF (Albanian American Development Foundation) për systemin e vlerësimit elektronik: "Clean score", për sekretimin dhe leximin elektronik të testeve.*

Në nivel Institucional është diskutuar implementimi i sistemit të vlerësimit elektronik “Clean score”, sikurse është kërkuar edhe mendimi i pedagogëve për implementimin e këtij sistemi. Nuk është parë e arsyeshme nga stafi akademik pasi sidomos në lëndët e karakterit inxhinierik, provimi ndër të tjera ka edhe vizatime, figura etj. të cilat janë të pamundura duke përdorur këtë sistem vlerësimi.

**Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.

**Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

GVJ konstaton:

Sipas dokumentit Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies, UPT ka një format të vetin të fletoreve ku mund të realizohet sekretimi dhe mos njohja e identitetit të studentit deri në momentin që studenti vjen dhe e identifikon vetë fletoren dhe vendos emrin e tij/saj në fletore. Sekretimi është me karbon dhe mbyll kapakun e fletores në pjesën ku janë të dhënat përkatëse si Emër, Mbiemër, Kursi, Lënda. Në momentin që studentit i sekretohet fletorja i vendoset një numër në kapak dhe ai e di se fletorja e tij/saj mban këtë numër. Përsëri sipas RVB, shpesh ky proces nuk është zbatuar.

Disa nga arsyet kryesore të kësaj mangësie janë: 1) stafi ndihmës e ka patur të pamundur të mbulojë gjithë procesin e punës pasi orët fizike të punës që kërkon ky proces janë të shumta, 2) në rregulloret e institucionit nuk janë detajuar procedurat sepcifike për këtë proces.

*IAL nuk siguron infrastrukturë të posaçme dhe mjete survejimi në provimet e lëndëve të programit të studimit, por vë në dispozicion personel.*

Gjatë vizitës në IAL, në takimin me studentët, u konstatua që studentët kanë marrë komente dhe janë sqaruar në rastet kur nuk kanë pasur qartësi për pjesën e korrigjimit të provimeve.

GVB sikurse është shprehur në RVB, në provimet e lëndëve të programit të studimit, vë në dispozicion personel akademik dhe ndihmës akademik për mbarëvajtjen e procesit të provimeve. Mjetet e suvejimit në sallat ku zhvillohen provimet nuk mund të përdoren duke qenë se bie ndesh me parimet e privatësisë.

**Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.

GVJ konstaton:

Në programet lëndore (syllabus) të programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike” *nuk cilësohet në përgjithësi se çfarë penalitetesh mund të ketë një student që konstatohet se ka bërë plagjiaturë në detyrën e kursit /projektit.*

Mënyra e zhvillimit të provimeve saktëson që studentët duhet të hyjnë me mjet identifikimi dhe nuk lejohen të kopjojnë, tezat rifreskohen në çdo sezon provimesh, si dhe për tezat e

diplomave nuk lejohet plagjiatura. Kur studenti përdor mjete të palejuara në provim, atëherë ai përjashtohet nga provimi.

Në Kodin e Etkës së UPT, neni 6 dhe 10, sikurse edhe në Rregullore e Zhvillimit Kurrikular he Mësimdhënies në UPT, neni 73 pasqyrojnë detyrimet e studentëve, ndër të cilat citohet se ndalohej kopjimi, sikurse edhe masat që merren në rast të shkeljes dhe mospërbushjes së detyrimeve të studentëve.

Pedagogu përkatës për secilën nga lëndët, në orën e parë kur prezanton programin e lëndës, njih studentët edhe me të drejtat dhe detyrimet e tij, pjesë e të cilës është edhe respektimi I të drejtave të autorit, si edhe ndalimi I plagjaturës. Në rast se studenti ka bërë plagjaturë në detyrën e kursit apo projektet, ai automatikisht nuk hyn në provim dhe detyrimi i detyrës së kursit apo projektit duhet të shlyhet në sezonet pasardhëse.

**Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**

**Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

GVJ konstaton:

Programi i studimit “Inxhinieri Ekonomike”, sipas dokumentit “Rregullore e Programit të studimit”, Kreu I, Neni 1, synon t’u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe ekonomise. GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, por *GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhornimin e literaturave, si dhe shtimin/ modifikimin e lëndëve të caktuara, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.* Ndërkohë në dokumentin “Suplement i diplomës”, përcakton në mënyrë mjaft të detajuar (përtej çfarë përmbajnë të gjithë dokumentet e tjerë përshkruar të programit të studimit) objektivat në drejtim të fitimit të njohurive, në drejtim të njohurive intelektuale, në drejtim të aftësive praktike. Në këtë dokument, pika 5, “Mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional” gjejmë që: Diploma Bachelor në Inxhinieri Ekonomike nuk jep mundësi për të ushtruar një profesion të rregulluar në bazë të legjislacionit shqiptar. *Sugjerojmë që, për zhvillimin e programit të studimit dhe garantimin e tij të aftësive profesionale, të shihet mundësia e përcaktimit qartë të profesionit të studentëve të diplomuar në këtë program, duke vendosur ura bashkëpunimi me MAS, ose autoritetet përkatëse.* Nga ana tjetër ky session në suplementin e Diplomës mund të plotësohet dhe me përshkrimin e mundësive të punësimit të studentëve duke pasur në konsideratë dhe pozicionet e punës në rajon apo Europë, e jo vetëm ato të parashikuara në legjislacionin shqiptar.

Sikurse kemi komentuar edhe në kriteret më sipër, në përfundim të cdo viti akademik, pasi bëhet analiza e programit të studimit në nivel KPS dhe Departamenti, bëhen edhe modifikimet, rregullimet dhe ndryshimet brenda masës 20%. Edhe për vitin akademik 2023-2024, janë menduar rregullimet dhe përmirësimet për këtë program studimi. Ndër to është edhe shtimi i numrit të krediteve për praktikën profesionale, si edhe përfshirja e një lënde me karakter inxhinierik “Inovacioni në projektet inxhinierike”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 15

**Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

GVJ konstaton:

Në programin e studimit "Inxhinieri Ekonomike" rreth 50% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësive në fushën e Inxhinierisë. Në këtë program gjejmë dhe lëndë të disiplinave të tjera si Menaxhim Projektsh, Gjuhë të Huaja, apo Biznes Ndërkombëtar që mund të ndihmojnë në aftësitë organizative, apo përmirësimin e ndërveprimit dhe komunikimit. Këto module i japin mundësi studentit të kuptojë tregun e punës, të jetë më komunikues, të jetë i aftë të punojë në grup. *Sugjerohet që në ndonjë nga lëndët ekzistuese të përfshihen dhe tema që kanë të bëjnë më shumë me komunikimin, vendimmarrjen, apo aftësitë e buta në përgjithësi.*

Në lëndën Menaxhim i burimeve njerëzore, sikurse edhe në lëndën Bazat e menaxhimit të ndërmarrjeve, ka tematika të vecanta në lidhje me zhvillimin e aftësive që kanë të bëjnë me komunikimin dhe vendimmarrjen. Gjithashtu duke qenë se seminarët në këto lëndë zhvillohen në formë diskutimi dhe ndëraktive, kuke shqyrtuar raste të ndryshme studimi si dhe duke punuar dhe diskutuar në grup. Gjithashtu edhe detyrat e kursit për lëndët me karakter manaxherial, punohen dhe prezantohen në grupe, ku në secilin grup mund të jenë deri 4 ose 5 studentë, ku secili punon sa në mënyrë të pavarur ashtu edhe në grup. Kjo i ndihmon studentët praktikisht për të zhvilluar aftësitë e komunikimit sikurse edhe të menduarit llogjik për marrje vendimesh dhe të punuarit në grup.

**Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.

GVJ konstaton:

Në programet lëndëve GVJ konstaton që në një pjesë të lëndëve studentët zhvillojnë projekte dhe detyra kursi. Projektet dhe detyrat e kursit përfshihen dhe në vlerësimin e vazhduar të studentit, kështu që kjo përveçse i ndihmon studentët për të rritur frymën e bashkëpunimit në grup dhe për të marrë njohuri më të thella lidhur me lëndë të caktuara i ndihmon ata edhe për një vlerësim më të plotë të lëndës përkatëse. *GVJ mendon që për të zhvilluar idetë innovative, për të kryer studime të avancuara kërkimore e shkencore detyrat e kursit nuk mund t'i plotësojnë mjaftueshëm këto aftësi. Në rastin më të mirë, këto aftësi plotësohen duke përfshirë stafin dhe studentët në projekte kërkimore.*

*Një formë tjetër mund të jetë duke kërkuar financime nga Alumni, ose nga biznese që FIM/DPM ka marrëveshje për të financuar sadopak projekte, iniciativa, pajisje të vogla (sensorë, aparatë matës, pajisje rrjeti, nyje përpunuese, etj).*

GVB konfirmon se projektet kërkimore nuk zhvillohen për nivelin e studimeve Bachelor por në ciklin e studimeve Master shkencor në Inxhinieri Ekonomike. Janë të shumta artikujt shkencorë dhe projektet e kërkimit shkencor duke u angaxhuar staf akademik dhe studentë të ciklit të



studimit MsC. Detyrat e kursit, në lëndët me karakter ekonomi dhe manaxherial, janë në përgjithësi plan biznesi, raste studimore etj.

Një pjesë e mirë e pajisjeve janë të blera me financim nga UPT apo nga projektet në të cilat UPT është partnere. Nuk ka financime nga bizneset apo nga Alumni.

**Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.

**Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.

GVJ konstaton:

Departamenti vë në dispozicion të studentëve formatin e Diplomës (sipas dokumentit të dorëzuar), në të cilin janë të përcaktuara jo vetëm rregulla të formatimit të tekstit, por ka dhe instruksione për përmbajtjen, çështjet kryesore që duhet të mbajë tema, hipotezat, referencat etj. Gjithashtu, cilësohet që pedagogët udhëheqës asistojnë studentët që kanë nën udhëheqje për shkrimin e temës së diplomës duke i ndihmuar ata me materiale, me ndarjen në çështje dhe nënçështje, në mënyrën se si japin detajet për zhvillimin e programeve si dhe në dhënien e konkluzioneve. *GVJ konstaton që kjo është një ndihmë e rëndësishme që u jepet studentëve, por theksojmë sërish që për procesin e shkrimit të një punimi shkencor/diplome ata duhet të jenë instruktuar në një lëndë të veçantë ose në përbërje të ndonjë lënde ekzistuese.*

Ashtu sikurse GVB ka sqaruar edhe në RVB, dhe ashtu sikurse theksohet edhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe të Mësimdhënies në UPT, neni 52, 53, 55, sikurse edhe në Rregulloren e Programit të Studimit, *“Teza e diplomës së ciklit të parë të studimeve është një punim, në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera, në fushat e programit përkatës të studimit”.*

Studentët mund të zgjedhin të zhvillojnë punime diplome në fushën inxhinierike ose ekonomike dhe manaxheriale, sikurse edhe ndërthurje të tyre. Është detyrë e pedagogut udhëheqës që të udhëzojë studentin dhe ta mbikqyrë për ecurinë e punimit. Gjithashtu duke qënë se studentët deri në momentin e zgjedhjes së temës, kanë zhvilluar një sërë detyrash kursi, kjo i ndihmon ata në mënyrën e të shkruarit si edhe në rregullat e shkrimit akademik, për të cilën kanë marrë udhëzime të vecanta nga detyrat e kursit.

**Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.

GVJ konstaton:

Sipas RVB, në rastin e punimit të diplomës në programin e studimit bachelor në Inxhinieri Ekonomike institucioni i asiston studentët duke ju vendosur në dispozicion laboratorët dhe gjithë mjediset e FIM dhe jashtë orarit zyrtar të mësimit. Studentët mund të shfrytëzojnë

kompjuterat dhe programet e instaluara në laboratorë. Në këtë kriter kërkohet dhe asistenca e IAL për kryerjen e matjeve e analizave, pra procedurave eksperimentale. *GVJ rithekson nevojën që ka ky program studimi veçanërisht për zhvillimin e këtyre proceseve, ndoshta më tepër se programe të tjera të ngjashme studimi në IAL shqiptare, veçanërisht atë të Industry 4.0, që sot është kryefjalë në zhvillimet globale.*

Sikurse edhe jemi shprehur në kriteret më sipër, pjesë e Departamentit të Prodhim Menaxhimit, që është përgjegjës për këtë program studimi, janë një sërë laboratorësh, ndër të cilët edhe laboratorit i Skanimimit dhe Printimit 3D. Studentët që kanë zgjedhur tema diplomash në këtë fushë kanë përdorur pajisjet në këtë laborator duke zhvilluar matje dhe nxjerrë rezultate nën udhëheqjen e pedagogut udhëheqës.

#### Përgjigje GVJ:

Të nderuar anëtarë të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm,

Në raportin e dorëzuar nga ne si GVJ, ekspertë të jashtëm të përzgjedhur nga ASCAL, për Programin e Studimit Bachelor në "Inxhinieri Ekonomike", të ofruar nga Departamenti i Prodhim Menaxhimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, UPT, mbetemi në të njëjtin vlerësim, se ky program është i një rëndësie mjaft të lartë për tregun e Industrisë dhe Inxhinierisë, si një profil ndër-disiplinar mjaft i veçantë krahasuar me programet e tjerë të ofruar në IAL Tuaj, apo IAL të tjerë publike apo private. Vlerësimi ynë për këtë program studimi, për stafin mjaft të kualifikuar të departamentit, për shumë procese të lidhura me IAL, etj., është maksimal dhe kjo është reflektuar në çdo fushë e standard të raportit. Ky vlerësim është shpërndarë në të 6 (gjashtë) fushat e raportit, duke ndjekur me përpikmëri atë se çfarë kërkon dhe ka si fokus secili prej kriterëve. Ky raport, mbi të gjitha është parë me detaje dhe me vullnetin për të përcjellë jo vetëm realitetin e zhvillimit të programit të studimit deri më tani, pavarësisht sfidave të ndryshme që jemi përpjekur t'i mirëkuptojmë dhe justifikojmë, por dhe duke sugjeruar me vërtetësi dhe profesionalizëm, ashtu siç ne e mendojmë në të mirë të zhvillimit të këtij programi studimi për të ardhmen e studentëve, të kërkesave të tregut të punës, avancimit të kërkimit, internacionalizimit, etj. Departamenti dhe çdo instancë përgjegjëse për cilësinë e programit të studimit është i lirë t'i marrë në konsideratë këto sugjerime ose jo.

Në këtë kuadër, GVJ i mbetet vlerësimeve të raportit të tij, duke mos konsideruar komentet e dërguara nga GVB. Falenderojmë grupin e punës për hartimin në mënyrë mjaft të detajuar për 3 (tre) fushat e para, duke shpresuar që këto përpjekje të përkthehen në veprime konkrete dhe në avantazh të departamentit, stafit, kërkimit shkencor, studentëve, si dhe impaktit në tregun e punës.


Me konsideratë,

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>			
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>GVJ arrin në përfundimin se Programi i studimit “Inxhinieri Ekonomike”, ofruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, është në përputhje dhe në harmoni me interesat kombëtare dhe nuk bie ndesh me to. Madje, Inxhinieria, Industria, Informatika apo degë të ngjashme, janë sugjeruar si ndër profesionet më të kërkuara nga organizma të ndryshëm. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm përcjell dhe faktin që inxhinieria ekonomike konsiderohet si ndër fushat zhvillimore më të rëndësishme apo subjekt i projekteve të ndryshme europiane. Për të dyja këto arsye, UPT dhe njëjësia bazë kanë vendosur hapjen e degës “Inxhinieri Ekonomike”.</p> <p><i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i> <i>Ref Mendimi i Dekanit.pdf</i></p>		
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi Bsc në “Inxhinieri Ekonomike” ndjek vizionin e shprehur në dokumentin “Statuti i UPT”, sipas të cilit IAL synon të ndërthurë edukimin me kërkimin shkencor dhe transferimin e njohurive, në përgatitjen e profesionistëve dhe qytetarëve aktivë për shoqëinë.</p> <p><i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i></p>		
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Në dokumentacionin e UPT, konfirmohet që programet e studimit të ciklit të parë, ndër të cilët dhe “Inxhinieria Ekonomike”, ofrohen në përputhje me misionin dhe vizionin e UPT si dhe Fakulteteve dhe Departamenteve brenda tij, në përputhje me strategjinë për zhvillim të UPT-së.</p> <p><i>Ref_007 Plani strategjik FIM 2020-2024.pdf</i> <i>Ref_008 Rregullore e brendshme e departamentit.pdf</i></p>		
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Sipas RVB, program i studimit në thelbin e tij ka si objektiv tu japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë. Meqënëse, profesionistët e rinj që përfundojnë studimet në këtë program kanë natyrë ndërdisiplinare, ata mund të themi që integrohen mirë në sektorë të ndryshëm duke kontribuar kështu dhe në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar.</p> <p><i>Ref_001 Statuti i UPT</i> <i>Ref_010 Rregullore BSC Inxhinieri Ekonomike</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>




<b>Standardi I.2</b>			
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	IAL e shpreh qartë në Statut, që institucioni ofron programin e studimit në përputhje me strategjinë për zhvillim të UPT-së. GVJ e konstaton këtë dhe në bazë të përmbajtjes së programit të studimit, sipas të cilit një i diplomuar në “Inxhinieri Ekonomike” ndërthur drejtimin Inxhinierik me atë të Ekonomisë/Biznesit.  <i>Ref_001 Statuti i UPT</i> <i>Ref_010 Rregullore BSC Inxhinieri Ekonomike</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në Strategjinë e zhvillimit të UPT specifikohen drejtimet prioritare të Fakultetit. Sipas tij, <i>programet e studimit që ofron UPT janë në përputhje me kërkesat e tregut kombëtar të punës dhe i përshtaten tregut rajonal dhe atij europian; programet e studimit janë në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit të institucionit.</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT</i> <i>Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Programi i Studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike”, është një program që përmbush vizionin aktual të UPT, të përcaktuar në statutin e UPT dhe planin strategjik. Në lidhje me emërtimin e programit të studimit, GVJ sugjeron që të përshtatet me kërkesat vendase, por edhe me standartet ndërkombëtare, të shihen kurrikula të tjera të ngjashme në universitete perëndimore.  <i>Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>			
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	GVJ shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga IAL për të parë plotësimin e Kriteri 1, Standardi I.3. Vlerësojmë që për këtë kriter IAL shprehet në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit në Inxhinieri Ekonomike”, Kreu I, Neni 7, “Objektivat formues dhe kompetencat profesionale”. Këtu janë listuar qartësisht: Njohuritë, Aftësitë, Kompetencat. Në Nenin 8, gjenden veprimtaritë formuese dhe kompetentët mësimorë të programit të studimit. Inxhinieri ekonomik është në gjendje të marrë vendime strategjike dhe të zgjidhë probleme operacionale dhe optimizuese në kontekste komplekse, të projektojë zgjidhje inxhinierike, si dhe të përballojë në mënyrë të përgjegjshme probleme dhe mundësi në mjedisin e ndërmarrjeve dhe mjedisin industrial.		



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 20

	Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024 Ref_010 Rregullore BSC Inxhinieri Ekonomike			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	IAL përmban në strukturën e vet administrative disa njësi të rëndësishme, të cilat kanë funksionalitete të ndryshme në ndihmë të përmirësimit të marrëdhënieve të tij me tregun e punës. Kështu, GVJ konstaton që një prej tyre është Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila ka si focus orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës, etj. Në lidhje me ndjekjen e studentëve pas diplomimit të tyre dhe marrjen e informacioneve të rëndësishme prej tyre në drejtim të përmirësimit të kurrikulës dhe procesit mësimor, në maj të vitit 2021 u krijua shoqata Alumni e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike (AIM). Në lidhje me punësimin e studentëve, në Tabelën 8 të RVB nga 197 të diplomuar në periudhën 2017-2021 në degën Inxhinieri Ekonomike, 138 janë të punësuar në përputhje me diplomën, një numër ky jo shumë i lartë.			
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi I.4</b>						
<b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>						
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>					
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Sipas RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar nga IAL, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, departamenti i Prodhim Menaxhim për vitin akademik 2019-2020 ofron 7 programe studimi, nga të cilat 2 programe bachelor, 2 programe master i Shkencave, 1 program master Profesional, si dhe 1 program doktorature.					
	Në rang Fakulteti, në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat për 3 vitet e fundit akademikë, në lidhje me personelin akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK):					
	Viti akademik	Nr. i PAE	Tituj PAE	Nr. i PAK	Tituj PAK	Total
	2020-2021	42	2 Prof. Dr. 12 Prof. As 23 Dr. 5 MSc	26	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 8 Dr. 15 MSc	68

2019-2018	42	3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc	29	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 21 MSc	71
2018-2019	42	3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc	26	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 18 MSc	68

Vihet re që stafi i FIM ka qendruar pothuajse i njëjti për tre vitet akademikë, që tregon një faktor pozitiv në ofrimin e shërbimit universitar. Rreth 50% e stafit PAE zotëron gradën Doktor.

Në lidhje me Departamentin e Prodhim Menaxhimit, vëmë re tabelën e mëposhtme:

Viti akademik	Nr. i PAE	Tituj PAE	Nr. i PAK	Tituj PAK	Total
2020-2021	19	1 Prof. Dr. 3 Prof. As 13 Dr. 2 MSc	15	0 Prof. Dr. 2 Prof. As 1 Dr. 12 MSc	34
2019-2018	19	2 Prof. Dr. 3 Prof. As 13 Dr. 1 MSc	18	0 Prof. Dr. 2 Prof. As 1 Dr. 15 MSc	37
2018-2019	19	2 Prof. Dr. 3 Prof. As 13 Dr. 1 MSc	18	0 Prof. Dr. 2 Prof. As 1 Dr. 15 MSc	37

Për secilin vit akademik vëmë re që 68% e stafit është me gradën shkencore Doktor, pra më e lartë se mesatarja e fakultetit. *Këtu sugjerojmë rritjen e kapaciteteve dhe mundësive për avancimin e titujve, për gjithë potencialin që mbart departamentin i Prodhim Menaxhimit.*

Nga ana tjetër FIM disponon rreth salla mësimi, ambjente të modernizuara, si dhe hapsirën për realizimin e praktikave profesionale me makineri dhe komponentë të ndryshëm inxhinierikë.

FIM si njësi kryesore, falë departamenteve të tjera pjesë strukturore e FIM, ofron studimet e larta në nivelin 6, 7 dhe 8 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

*Ref\_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024*

*Ref\_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike*

<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>UPT është në proces të kodifikimit të programeve të studimit për të gjithë Fakultetet bazuar në LAL 80/2015 neni 86. Programi i studimit i Inxhinieri Ekonomike është program i ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale është tri vite akademike.</p> <p>GVJ konstaton që fusha e programit të studimit në Bsc në “Inxhinieri Ekonomike” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, por sugjerojmë një përfshirje dhe shkrirje dhe në nivel lëndor të disiplinave: Informatikë, Ekonomi, Menaxhim, apo të disiplinave të ngjashme që janë në varësi të Fakultetit.</p> <p><i>Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i> <i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Në RVB pohohet që programi i studimit “Inxhinieri Ekonomike” është konceptuar dhe hartuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore specifike të departamentit.</p> <p>Në Planin Mësimor të programit të studimit, vëmë re që studentët që mbarojnë këtë program ndjekin gjatë vitit të parë 10 lëndë, nga të cilat 1 prej tyre është e orientuar nga ekonomia, saktësisht: “Hyrje në Ekonomi”, 3 në drejtimin inxhinierik (Vizatim Teknik Industrial, Mekanika Teorike, dhe Bazat e Elektroteknikës), si dhe 6 tjera me natyrë të përgjithshme (Analizë, Fizikë, Informatikë, Anglisht, etj). Në vitin e dytë, gjenden 3 lëndë me formim ekonomik, 6 inxhinierike dhe 1 e përgjithshme. Në vitin e tretë gjenden 7 lëndë ekonomike dhe menaxheriale, 2 inxhinierike, 1 praktika, dhe 1 Punimi i diplomes.</p> <p>Fusha inxhinierike dhe ajo ekonomike përputhen së bashku nën kujdesin e departamentit, duke mos krijuar mungesa në formimin e studentëve. Rrjedha logjike dhe formuese e kurrikulës është mjaft e përshtatshme për formimin e studentëve.</p> <p>Në përmbajtje të programeve lëndore (syllabus), vëmë re që në pjesën e tyre më të madhe lëndët me formim të përgjithshëm janë të pakontekstualizuara (në formën e rasteve të studimit, në objektivat e tyre, në komentet e lektorëve për lëndët, apo në tematikat e veçanta të çdo jave), lëndët e profilit Ekonomi (p.sh. Mikroekonomi, etj) janë të paintegruara me çështje të inxhinierisë, si dhe lëndët e Inxhinierisë janë të pazbatuara në fushën e Inxhinierisë. <i>Sugjerojmë një rishikim të programeve lëndore nën këtë filozofi, pra atë të integritetit të disiplinave të programit të studimit edhe në nivel syllabusi. Gjithashtu sugjerojmë vendosjen e lëndëve me zgjedhje në Dokumentet e Planeve mësimore të Programit të Studimit si një listë e vecantë. Dhe së fundmi, sugjerohet përfshirja e temave bashkëkohore në kurrikul, pasi sot zhvillimi i teknologjisë parallel me atë të industrisë ka zhvendosur paradigmat si dhe ka mjaft impakt në rrafshin ekonomik (jo vetëm aplikativ), si p.sh. Industry 4.0, Printimi 3D, Teknologjia e Shkencave e Konstruksionit, Makinat inteligjente, Materialet Inovative, etj. Të gjitha këto tema mund të përfshihen në një lëndët vetme, të re, ku cdo javë të</i></p>




	<p>trajtohen tematika që mund të nxisin kreativitetin, inovacionin, dhe potencialin e studentëve pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i> <i>UPT RVB Bachelor Inxhinieri Ekonomike</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që IAL i jep rëndësi të veçantë analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Kështu, shohim së në këto analiza në vëmendje të tyre janë: Programet e studimit; Procesi mësimor; Stafit akademik; Studentët; Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm; dhe Veprimtaria ndihmëse. Gjithashtu, sipas RVB, shihet që FIM realizon çdo vit vlerësimin e ecurisë së Programeve të Studimit, bazuar në Indikatorët themelorë: Kurrikula e Studimeve, Planet Mësimore dhe Programet mësimore të cdo moduli. Hartimi dhe modifikimi i secilit prej tyre është përgjegjësi e Njesisë Bazë e cila organizon procesin me angazhimin e stafit akademik. Analiza synon të evidentojë arritjet dhe problematikat me synim rishikimin e objektivave për përmirësimin e vazhdueshëm të ecurisë së Programit të Studimit dhe procesit mësimor në tërësi.</p> <p>FIM ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me një numër institucionesh të tjerë, me qëllim realizimin e objektivave të programit të studimit. Në Tabelën 5 listohen 40 organizatat, ndërmarrjet apo institucionet bashkëpunuese për praktikat profesionale por jo vetëm.</p> <p><i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i> <i>RVB – Tabela 5</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, si dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuar GVJ konstaton që UPT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me një numër institucionesh homologe ndërkombëtare dhe vendas në funksion të ofrimit të mundësisë të shkëmbimit të dijeve. Sipas RVB, përmenden 34 institucione të huaja në kuadër të Erasmus+.</p> <p>Një numër të konsiderueshëm bashkëpunimesh janë vendosur dhe me sektorin privat, të cilat shërbejnë jo vetëm për realizimin e praktikave, por edhe për rekomandimin e mundshëm të studentëve në punësimin e tyre.</p> <p><i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i> <i>RVB – Tabela 8</i> <i>Ref_049 Marrëveshjet institucionale UPT</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 24



<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.							
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	UPT ofron për studentët e programit “Inxhinieri Ekonomike”, apo të të gjithë degëve të tjera që duan të thellojnë njohuritë e tyre ofron disa kurse profesionale, ose programe formimi të vazhduar. Kështu, në departamentin e Prodhim Menaxhimit, në bashkëpunim me departamentin e Mekanikës, ofrohet kursi i formimit në “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”.						
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet që programi i studimit “Inxhinieri Ekonomike” është organizuar në lëndë, të cilat vlerësohen me kredite në bazë të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, në bazë të Rregullores së Fakultetit, lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese. Struktura dhe përmbajtja e programeve mësimore është në përshtatje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.  Programi i studimit “Inxhinieri Ekonomike” përmban 180 ECTS dhe është i organizuar në tre vite akademike (6 semestra), ku cdo vit akademik ka 63, 60 dhe 57 ECTS.  <i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i> <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson programin e studimit “Inxhinieri Ekonomike” si një profil mjaft të domosdoshëm në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit. Struktura mësimore e programit përmban lëndë të cilat lejojnë që në fund të programit të studimit, të diplomuarit të mund




	<p>të orientohen/punësohen në një larmi profesione, brenda fushës së Inxhinierisë Industriale.</p> <p><i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i></p>															
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, në bazë të RVB, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar, GVJ konstaton që programi Bsc në “Inxhinieri Ekonomike pasqyron në planin mësimor një disiplinë mësimore bashkëkohore dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës, por që vazhdimisht nevojitet të përditësohet me zhvillimet vendase dhe ato globale.</p>															
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sic kemi përmendur në kriteret e mësipërme, ka një strukturë mjaft të mirë lëndore brenda programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike. Megjithatë, përveç sugjerimit të përditësimit, atë të vendosjes së një lënde të re me zhvillimet e fundit, konstatohet që nuk ka një lëndë që zhvillon mendimin kritik, shkrimin akademik, apo metodat e kërkimit. Pjesa e kërkimit shkencor shihet gjithashtu shumë pak e reflektuar në programet e veçanta lëndore të programit të studimit.</p> <p>GVJ gjykon që për të zhvilluar <i>aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme</i>, studenti duhet më parë të trajnohet në kryerjen e kërkimit shkencor. Kjo mungesë bën që Kriteri 4 në këtë Standard të mos jetë i plotë, por vlen të theksojmë që këto aftësi në të vërtetë është e vështirë të plotësohet nga programe studimi bachelor. Nga ana tjetër vlerësojmë nxitjen e IAL për pjesëmarrje të studentëve në konferenca dhe aktivitete të tjera të ngjashme.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i></p>															
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Sipas RVB, referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, programi i studimit në “Inxhinieri Ekonomike” plotëson të gjithë elementët për një strukturë korrekte dhe bashkëkohore. Programi i studimit është i ndarë në module të mirëfillta të cilët nuk kanë mbivendosje midis tyre dhe janë me karakter formues dhe profesional. Çdo modul ka të specifikuar qartë kreditet (ECTS) në përputhje me raportin e orëve teori/praktikë.</p> <p><i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike RVB</i></p>															
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit mbështetës të dorëzuar nga IAL, konstatohet që programi i studimit në Inxhinieri Ekonomike i ndan veprimtaritë formuese, lëndët, në disiplina të ndryshme (“Rregullore e Programit të Studimeve Bachelor në Inxhinieri Ekonomike”, Neni 9).</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Kategoria</th> <th>Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)</th> <th>% ECTS</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>15 – 20 %</td> <td>18.3%</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>50 – 55 %</td> <td>53.3%</td> </tr> <tr> <td>A+B</td> <td>≥70%</td> <td>71.7%</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>12 – 15 %</td> <td>15%</td> </tr> </tbody> </table>	Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)	% ECTS	A	15 – 20 %	18.3%	B	50 – 55 %	53.3%	A+B	≥70%	71.7%	C	12 – 15 %	15%
Kategoria	Kriteri Bachelor (VKM 41, date 24.1.2018)	% ECTS														
A	15 – 20 %	18.3%														
B	50 – 55 %	53.3%														
A+B	≥70%	71.7%														
C	12 – 15 %	15%														

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 26




	<b>D</b>	10 – 15 %	8.3%
	<b>E</b>	3 – 5 %	5%
<i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i> <i>RVB</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>			<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015, Neni 23) si njësi akademike kryesore bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, miraton kriteret e pranimit të studentëve mbi bazë të propozimeve të kryera nga njësi bazë. FIM ka në përbërje të tij 4 (katër) departamente përkatësisht: Departamenti i Energjitikës; Departamenti i Mekanikës; Departamenti i Prodhim Menaxhimit; Departamenti i Tekstili dhe Modës.</p> <p>Secili prej departamenteve është përgjegjës për zhvillimin e procesit të mësimdhënies dhe punës kërkimore-shkencore, përgjegjës për grupet mësimore dhe shkencore, përzgjedhin fituesit e programit të studimit. Departamenti Inxhinieri Ekonomike, referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015 (neni 14, 15), përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin nga ASCAL.</p> <p><i>Ref_015 Organigrama e FIM</i> <i>RVB – Tabela 1, 2</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>IAL ka përcaktuar strukturën e përbërë nga anëtarët e stafit efektiv për të qenë koordinator i programit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike”, më saktë Këshilli i Programit të Studimit, kryetari i së cilit është dhe coordinator. Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, (Ref_010), koordinatori i programit monitoron punën për mirëadministrimin e programit, përmbushjen e objektivave të tij si dhe ka suportuar iniciativat në drejtim të përmirësimit të elementeve të mësimdhënies dhe të praktikave profesionale në përputhje me objektivat. Përgjegjësi i departamentit përgatit dhe propozon kurrikulat e studimeve të Departamentit (në bashkëpunim me stafin akademik të programit IE), ndikon në mbarëvajtjen e punëve të grupeve mësimore e kërkimore dhe realizon bashkëveprimin ndërmjet grupeve mësirnorë e kërkimore. Ai gjithashtu kujdeset për mbarëvajtjen e praktikave profesionale si dhe informon titullarin në lidhje me proceset apo problematikat e punës.</p> <p><i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular</i> <i>Ref_006 Rregullore e Brendshme FIM</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 27





<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike”. Ai gjithashtu është përgjegjës për propozimin e kriterëve pranues të studentëve në programin e studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike”, kriterë të cilat miratohen dhe nga njësia kryesore FIM.</p>																											
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Ky department përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore, po ashtu edhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike plotëson të gjitha kriteret për shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Gjatë këtyre viteve UPT dhe FIM i është nënshtruar disa ndryshimeve të cilat kanë pasur për qëllim konsolidimin dhe rritjen e cilësisë si në aspektin e kualitetit të stafit akademik mësimdhënës ashtu edhe të programeve të studimit, diplomave dhe kurrikulave përkatëse dhe drejtimit. Pjesa më e madhe e stafit të angazhuar e që mbulon këtë program studimi janë staf i njësisë kryesore përgjegjëse për programin ndërkohë që angazhimi i stafit nga njësitë e tjera mbulon drejtime të përafërta me një sërë disiplinash të tjera që ofrohen në kuadrin e programeve të tjera të studimit të FIM, duke garantuar një balancë të mirë mes specializimit dhe ndërdisiplinaritetit.</p>																											
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i PAE</th> <th>Tituj PAE</th> <th>Nr. i PAK</th> <th>Tituj PAK</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>42</td> <td>2 Prof. Dr. 12 Prof. As 23 Dr. 5 MSc</td> <td>26</td> <td>0 Prof. Dr. 3 Prof. As 8 Dr. 15 MSc</td> <td>68</td> </tr> <tr> <td>2019-2018</td> <td>42</td> <td>3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc</td> <td>29</td> <td>0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 21 MSc</td> <td>71</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>42</td> <td>3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc</td> <td>26</td> <td>0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 18 MSc</td> <td>68</td> </tr> </tbody> </table>				Viti akademik	Nr. i PAE	Tituj PAE	Nr. i PAK	Tituj PAK	Total	2020-2021	42	2 Prof. Dr. 12 Prof. As 23 Dr. 5 MSc	26	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 8 Dr. 15 MSc	68	2019-2018	42	3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc	29	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 21 MSc	71	2018-2019	42	3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc	26	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 18 MSc	68
Viti akademik	Nr. i PAE	Tituj PAE	Nr. i PAK	Tituj PAK	Total																							
2020-2021	42	2 Prof. Dr. 12 Prof. As 23 Dr. 5 MSc	26	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 8 Dr. 15 MSc	68																							
2019-2018	42	3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc	29	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 21 MSc	71																							
2018-2019	42	3 Prof. Dr. 12 Prof. As 22 Dr. 5 MSc	26	0 Prof. Dr. 3 Prof. As 5 Dr. 18 MSc	68																							
<p>Te dhenat e stafit per tre vitet e fundit, jane si me lart.  <i>Ref_010 Programi BSC Inxhinieri Ekonomike</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular</i>  <i>Ref_006 Rregullore e Brendshme FIM</i></p>																												
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>X</b></p>																								

<p><b>Standardi II.3</b>  <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 28





<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Prodhim Menaxhimit disponon gjithë informacionin e nevojshëm të programit të studimit Bsc në Inxhinieri Ekonomike siç janë struktura e vitit akademik, kuotat e pranimit dhe grupet mësimore, kurrikula dhe plani mesimor, mënyra e vlerësimit të studentëve, praktika profesionale dhe diplomimi. Rregullorja e njësisë kryesore FIM bën përcaktimin e standarteve në lidhje me përgatitjen, organizimin dhe administrimin e studimeve universitare.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në këtë rregullore, Dekani miraton rregulloret e programeve të studimit të njesive bazë.</p> <p><i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular</i>  <i>Ref_006 Rregullore e Brendshme FIM</i>  <i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_044 Praktika e Miratimit te planeve mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike” organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Këto të dhëna detajohen në rregulloren e programit të studimit, si dhe pasqyrohen në të dhëna të ndryshme tabelare në dokumentacionin e dorëzuar.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit është i ndarë në 3 vite akademike, 6 semestra, me 180 ECTS në total, ku mesatarisht çdo semestër ka një ngarkesë prej 24 orësh në auditor.</p> <p><i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>RVJ konstaton që dokumenti “Plani mësimor” i programit të studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike” përmban një pjesë të rëndësishme të informacionit në lidhje me orët mësimore të çdo lënde përgjatë tre viteve të studimit; numri i ECTS, raporti leksion/seminar, detyrimet e modulit, vlerësimi i studentit, si dhe mënyra e zhvillimit të provimit. Vlerësimi i lëndëve përfshin forma të ndryshme si mbrojtje e puneve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lendes, etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullat për frekuentimin si dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe në programet e vecanta lëndore, si dhe në dokumentin e sipërcituar. Ato ndjekin Rregulloren e UPT.</p> <p>Neni 12 i këtij dokumenti saktëson dhe procesin e transferimeve të studentëve që vijnë në programin e studimit “Inxhinieri Ekonomike”. FIM ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UPT apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë publike ose private, vendase ose të huaja, dhe lejon largimin e studentëve të tij në universitete të tjera.</p>




	<i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular</i> <i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i> <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i> <i>Ref_044 Praktika e Miratimit te planeve mesimore</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Në RVB si dhe në dokumentacionin e dorëzuar, konfirmohet që për programin e studimit Bsc në Inxhinieri Ekonomike çdo fillim viti akademik hartohet dosja e plotë e këtij programi studimi e cila përmban syllabuset për secilën lëndë, kurrikulën, planin mësimor, ngarkesën e plotë të stafit akademik, strukturën e vitit akademik etj. Syllabusi përmban gjithë informacionin e nevojshëm për secilën lëndë që ofron programi në çdo semestër studimi referuar VKM Nr. 41, datë 24.1.2018. Programet lëndore ndjekin të gjithë të njëjtin format.</p> <p>Syllabuset e detajuara për çdo lëndë janë të plota dhe ofrojnë informacion të detajuar mbi: të dhënat të përgjithshme të lëndës, qëllimi dhe objektivat, kalendari i temave, forma e vlerësimit, literatura e detyruar dhe ajo e rekomanduar etj. Vihet re që pjesa më e madhe e literaturës bazë apo të rekomanduar të përfshirë në syllabus janë më të vjetra se 5 vite (p.sh. Programimi në C është i vitit 2010, CAD i 2009, Termoteknika e 2013, Shkenca e Materialeve e 1990 dhe 1997, Teknologjia Mekanike 1995, Menaxhimi 1993, Menaxhim Projektsh 2004, Konstruksiione mekanike 2004), disa mungojnë (p.sh. Hyrje në Ekonomi, Mikroekonomia, kurse Menaxhimi i operacioneve nuk ka literaturë të rekomanduar).</p> <p><i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i>  <i>RVB – Tabela 14</i></p>		
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njësive bazë dhe kryesore se programet mësimore dhe përmbajtjet e tyre lëndore janë në përmirësim të vazhdueshëm, në fillim të çdo viti akademik. Kjo konsiderohet si një aspekt pozitiv dhe shpesh i domosdoshëm për profile teknike si ai i programit të studimit në “Inxhinieri Ekonomike”.</p> <p><i>Ref_004 Rregullore e zhvillimit kurrikular</i>  <i>Ref_044 CV e stafit akademik</i>  <i>RVB – Tabela 11</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ evidentoi që ngarkesa e programit të studimit në programin “Inxhinieri Ekonomike”, prej 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademik është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me raportet mes orëve të leksioneve dhe seminareve, GVJ konstaton që ato ruhen në mënyrë të kënaqshme.</p> <p><i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i> <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>GVJ, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve të tyre, të shpërndarjes së lëndëve dhe përmbajtjes së tyre, <i>sugjeron që, në përgjithësi, një pjesë e lëndëve inxhinierike kanë nevojë për një përditësim leksioneve, si dhe zbatim më konkret në aspektin ekonomik të orëve të seminareve, në mënyrë që natyra ndërdisiplinare e programit të studimit të konkretizohet sa më mirë për studentët.</i></p> <p>Stafi akademik i DPM është i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në implementimin e politikave që lehtësojnë punësimin e studentëve ose orientimin e moduleve drejt problematikave të tregut të punës. Gjithashtu Stafi akademik ndihmon në rekomandimet e studentëve që paraqet pranë bizneseve që interesohen për punësimin e tyre. Sugjerimet e mësipërme ndihmojnë në strukturimin më të mirë të njohurive dhe aftësive praktike të studentëve, e për pasojë punësimin më të mirë të tyre.</p> <p><i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i> <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Lëndët dhe modulet e ofruara mbulojnë fushat e studimeve të inxhinierisë dhe biznesit duke ju mundësuar studentëve profilizimin në specializime të ndryshme profesionale.</p> <p>Në dokumentin Raporti i Analizës Mësimore (Ref_048), realizuar në vitin 2022 listohen për cdo lëndë informacione të detajuara për procesin mësimor, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dhëna të përgjithshme të lëndës, organizimi</li> <li>- Rezultatet e të nxënit</li> <li>- Realizimi i mësimdhënies</li> <li>- Ngarkesa e realizuar</li> <li>- Vlerësimi i studentëve</li> <li>- Problematika që kanë dalë dhe propozime për përmirësim.</li> </ul> <p>Dokumenti përbën një metodologji të mirë në aspektin e analizës mësimore të stafit, si dhe një formë nga e cila mund të nxirren indikatorë të ndryshëm të matshëm.</p> <p><i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular</i> <i>Ref_008 Rregullore e brendshme e departamentit</i> <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i></p>




	<p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i> <i>Ref_048 Raporti i analizes mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në prodhimin dhe menaxhimin e sipërmarrjeve dhe industrive, por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore në lëndë të vecanta aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore, nga të cilat do të përfitojë studenti. Nevojitet të theksohet më shumë mendimi kritik nëpërmjet kërkimit shkencor dhe ngritjes së hipotezave, matjeve, eksperimenteve, mbledhjes së të dhënave, analizës dhe parashtrimit të rezultateve. Kjo është pjesa që mungon në programin e studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike”, pjesë që në fakt është e rëndësishme në programe të ngjashme ndërkombëtare. Është për t’u vlerësuar fakti që departamenti çdo fund viti kalendarik zhvillon analizën e punës mësimore dhe shkencore, ku diskutohet ndër të tjera edhe mbi arritjet e objektivave formuese të programit Inxhinieri Ekonomike.</p> <p>Raporti Teori /Praktikë, i përlogaritur si raporti: (orë totale leksioni) / (orë Seminari + Lab + Ushtrime + praktike), në programin “Inxhinieri Ekonomike” nëse përlogaritet në bazë të dokumentit “Plani Mësimor”, do të figurojë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Total: 180 ECTS</li> <li>- Praktika: 3 ECTS</li> <li>- Diploma: 6 ECTS</li> <li>- Total Lëndët: 171 ECTS</li> </ul> <p>Përlogaritjet sipas orëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksion 1194 orë;</li> <li>- Seminare 826 orë;</li> <li>- Laboratorë 92 orë;</li> <li>- Praktika/Projekte 39.5 orë</li> <li>- Total orë: 2241.5 orë</li> </ul> <p>Sipas përlogaritjeve, raporti Teori/Praktikë qëndron si 1194 / (826 + 92 + 39.5), pra është në nivelet është 55.5% / 44.5%. Ky është një raport mjaft i mirë për ciklin bachelor. <i>Gjithsesi, sugjerojmë përditësimin e kurrikulës dhe me fusha të tjera që evidentojnë më tepër pjesën praktike të çdo lënde, shoqëruar me vlerat përkatëse në orë/ECTS, si dhe rritjen e krediteve dhe orëve përkatëse për dy lëndët: Praktikë Profesionale dhe Diploma.</i> Për ta përmbledhur, GVJ konstaton se ka një raport të përshtatshëm në ndarjen e veprimtarive formuese. Gjithashtu, natyra praktike e profilit duhet të saktësohet më qartë dhe në syllabus-et e lëndëve, në të cilat duhet të saktësohen orët në laborator dhe punët praktike në terma të krediteve.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i> <i>Ref_048 Raporti i analizes mesimore</i></p>






<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Sipas RVB, programi i studimit konsiderohet në përputhje me komponentët mësimorë që përbëjnë aftësitë formuese. Numri i studentëve që preferojnë të transferohen në UPT në Programin e studimit “Inxhinieri Ekonomike”, sipas Tabelës 7, RVB, është vetëm 1 (një) në vitin akademik 2020-2021, si dhe nuk ka reflektime të studentëve të larguar. <i>Të punësuar në Tabelën 8 janë 70% në përputhje me diplomën dhe 30% jo në përputhje. Ky raport duhet të shihet me prioritet nga Departamenti, për të rritur numrin e studentëve të punësuar në pozicione pune ku të ushtrojnë njohuritë e marra përgjatë viteve të ciklit bachelor.</i></p> <p><i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i>  <i>RVB – Tabela 7</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e moduleve janë përshtatur referuar VKM Nr. 41, por duhet të cilësojmë që literaturat e tyre është e nevojshme të rifreskohen, si dhe të citohen sipas standarteve të mirënjohura, në mënyrë që departamenti të jetë gjithmonë i përditësuar për përmbajtjet e lëndëve të programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike”. GVJ konstaton që në një pjesë të rasteve në syllabus, tek seksioni “Literaturë e detyruar” pedagogët kanë vendosur “Cikël leksionesh”. Këto janë materiale që ne e mirëkuptojmë, që janë të përgatitura dhe përditësuara, por konsiderohen si “materiale të kursit/lëndës” që studentët duhet t’i përvetësojnë, por jo literaturë në të cilën mbështetet korpusi i lëndës.</p> <p>Mungesa e përditësimit të përmbajtjeve lëndore mund të sjellë dobësim të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimi profesional.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Referuar Rregullores së FIM programet e studimit janë hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që ky program të orientohet pak më tepër drejt Menaxhimit të Industrive (siç e kemi cekur dhe në kritere të mëparshme), në mënyrë që të shfrytëzojë burimet njerëzore, infrastrukturën ekzistuese, mjediset e përbashkëta ku mund të zhvillohen projekte kërkimore apo detyra të natyrave të ndryshme në terren. Në këtë mënyrë ky program do gjendej saktësisht brenda njësisë së tij dhe mbi të gjitha do të plotësonte një drejtim kombëtar mjaft të rëndësishëm. Kështu, vendosja e një ose dy lëndëve të tjera me natyrë teknike, por bashkëkohore dhe të aplikueshme në industri, do e plotësonte më së miri këtë mungesë.</i></p> <p><i>Ref_006 Rregullore FIM</i>  <i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje</p>	<p>Programi i studimit Inxhinieri Ekonomike është në konformitet me përcaktimet e bëra në Vizionin dhe Misionin e UPT, si një program i rëndësishëm studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive. Programi i</p>




me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”, është në dobi dhe në mbështetje të nevojave dhe kërkesave për një lloj diversifikimi të mëtejshëm të diplomave që ofron FIM, në dobi të studentëve që pranohen në këtë fakultet.</p> <p>Të diplomuarit në këtë program studimesh mund t’i përgjigjen mjaft mirë nevojave të vendit. Sipas RVB pohohet se organizimi i të diplomuarve që në maj 2021 <i>do të shërbejë ndër të tjera dhe në tërheqjen e një mendimi profesional, që lidhet direkt me tregun e punës, për përmirësimin dhe adoptimin e programeve të studimit ndaj kërkesave të këtij tregu.</i> Këto mendime duhet të ishin reflektuar dhe dokumentuar në listën e dorëzuar nga IAL për këtë program studimi.</p> <p>Ritheksojmë që këto prioritete janë të qarta, por sikurse i sugjeruam dhe në kriterin e mësipërm, duhet të konkretizohen më fort në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p>Vetë studentët e degës, gjatë vizitës në IAL, shprehën mungesën e implementimit të njohurive të marra në fushën e industrisë në përgjithësi, por gjithsesi ishin mjaft të kënaqur me profilin që kishin marrë.</p> <p>FIM ka nënshkruar gjithashtu mjaft marrëveshje bashkëpunimi me bizneset, në të cilët studentët realizojnë praktikat mësimore, gjejnë mundësi punësimi, si dhe ka konsulta të ndërsjellta mes tyre dhe stafit akademik në kuader të përmirësimit të programeve të studimit, thjesht këto duhet të nxirren më në pah, si dhe të formalizohen sipas procedurave të përcaktuara.</p> <p><i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i> <i>Ref_011 Plani Mesimor BSC Ing Ekonomike</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
		X	

**Standardi II.5**

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike” është me grada dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.</p> <p>Sipas VKM nr. 418, janë përcaktuar raportet e personelit akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore, gjë që plotësohet nga IAL. Tabela me poshte reflekton numrat e personelit PAE dhe PAK per 3 vitet e fundit akademike.</p>																
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i PAE</th> <th>Tituj PAE</th> <th>Nr. i PAK</th> <th>Tituj PAK</th> <th>Total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>19</td> <td>1 Prof. Dr. 3 Prof. As</td> <td>15</td> <td>0 Prof. Dr. 2 Prof. As</td> <td>34</td> </tr> </tbody> </table>	Viti akademik	Nr. i PAE	Tituj PAE	Nr. i PAK	Tituj PAK	Total	2020-2021	19	1 Prof. Dr. 3 Prof. As	15	0 Prof. Dr. 2 Prof. As	34				
Viti akademik	Nr. i PAE	Tituj PAE	Nr. i PAK	Tituj PAK	Total												
2020-2021	19	1 Prof. Dr. 3 Prof. As	15	0 Prof. Dr. 2 Prof. As	34												




		13 Dr. 2 MSc		1 Dr. 12 MSc	
2019-2018	19	2 Prof. Dr. 3 Prof. As 13 Dr. 1 MSc	18	0 Prof. Dr. 2 Prof. As 1 Dr. 15 MSc	37
2018-2019	19	2 Prof. Dr. 3 Prof. As 13 Dr. 1 MSc	18	0 Prof. Dr. 2 Prof. As 1 Dr. 15 MSc	37
<p><i>Ref_006 Rregullore FIM</i>  <i>Ref_010 Rregullore BSC Ing Ekonomike</i>  <i>RVB – Tabela 7</i>  <i>Ref_057 Procedura e punesimit te personelit</i></p>					
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Referuar Curriculum Vitae të anëtarëve të stafit akademik të programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike”, çdo modul mbulohet nga personel akademik që ka nivelin e duhur akademik me profil studimi në përputhje me fushën kryesore formuese dhe kërkimore të modulit.</p> <p><i>RVB – Tabela 1, 2</i>  <i>Ref_013 Miratimi nga MAS</i>  <i>Ref_024 CV e stafit akademik</i></p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Sipas Statutit të UPT, veprimtaria kërkimore dhe shkencore përbën njërin prej dy shtyllave kryesore mbi të cilat mbështetet misioni i Universitetit Politeknik të Tiranës. Ajo konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të stafit të tij akademik duke qenë se arrijtet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejtë me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me rritjen akademike të stafit të tij në botën e kërkimit shkencor.</p> <p><i>RVB – Tabela 1, 2, 7</i>  <i>Ref_024 CV e stafit akademik</i></p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Referuar Statutit dhe Programit të Studimit, praktika profesionale, procedurat dhe standardet, në Rregulloren e Programit të studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike”, GVJ konstaton që hartimi dhe ndjekja e praktikave kryhet nga departamenti. Ai harton programin e praktikës profesionale si dhe cakton stafin akademik që do të drejtojnë zhvillimin e praktikës në objekt. Stafit akademik përgjegjës në përfundim të praktikës profesionale, dorëzojnë në departament një raport mbi kryerjen e praktikës profesionale. Praktikën profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private, me të cilat Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka realizuar paraprakisht një kontratë. Praktikën profesionale zhvillohen në përputhje me profilin e përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës.</p>				

Në përfundim, departamenti cakton një datë për mbrojtjen e praktikave nga ana e studentëve.

*Ref\_052 Model kontrate per praktiken*  
*Ref\_053 Procedura e organizimit te praktikës*  
*Ref\_058 Model marreveshje per praktiken mesimore*  
*Ref\_060 Procedura, konceptimi dhe mbrojtja e praktikës*

**Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

Departamenti i Prodhim Menaxhimit ka në përbërje stafin ndihmës akademik mësimor, i cili ka përgjegjësi të plotë për mbarëvajtjen e laboratorëve kompjuterikë. Gjatë vizitës, GVJ u prezantua me mjediset ku studentët kryejnë praktikën profesionale.

Stafi ndihmës akademik ndihmon në mbarëvajtjen e procesit mësimor duke siguruar mjediset laboratorike nga ana teknike si dhe nga ana e mjediseve të nevojshme për praktikën mësimore. Gjithashtu ai ka në përbërje edhe staf ndihmës akademik administrativ i cili ndihmon në zhvillimin e departamentit si pjesë e strukturës së UPT. Konkretisht, sipas Tabelës 16, RVB, në infrastrukturën e UPT bëjnë pjesë:

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia
Salla për leksione	8
Klasa për seminare	15
Salla për aktivitete promovuese	1
Salla për praktikë lëndore/profesionale	2
Laboratorë për lëndët	11
Laboratorë informatike	1
Salla interneti	1
Salla për bibliotekë	
Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1
Zyrë informacioni për studentët	

*RVB – Tabela 1*  
*Ref\_006 Rregullore e brendshme FIM*  
*Ref\_008 Rregullore e brendshme Departament*  
*Vizita ne IAL*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	
	tryesisht	plotësisht
		X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet	
	tryesisht	plotësisht
		X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
 Faqe 36




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b> <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter, GVJ gjen të paraqitur në dokumentin “Plani strategjik: Zhvillimi i infrastrukturës digjitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik” metodat që UPT ka përshtatur për mësimin online. Të tilla metoda janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Microsoft Teams.</b> Nëpërmjet kësaj platforme stafi akademik hedh të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët si: leksionet, literaturën e rekomanduar, ushtrimet, etj</li> <li><b>2. PITAGORA,</b> është një sistem online i aplikuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, ku ofrohet shërbimi i sekretarisë dhe kurrikulës.</li> </ol> <p><i>Ref_002 Plani strategjik i UPT 2019-2024</i>  <i>Ref_038 Informimi i studenteve nepermjet platformave online</i>  <i>Ref_042 Udhezues dhe manual per zhvillimin e mesimit ne distance</i>  <i>Ref_043 Manual perdorimi platforma e sekretarise mesimore Pitagora</i>  <i>Ref_062 Model faqe website pedagogu</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar, si dhe nga takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, konstatohet që Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar dhe zyrtarizuar në Planin Strategjik të UPT. Një element i mirë matës është dhe analiza semestrale mësimore që stafet plotësojnë, ku cilësohet dhe sugjerimi i formave të përmirësimit të problematikave të hasura.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UPT në mënyrë periodike realizon dhe vlerësimin e performancës së pedagogëve në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe FIM.</p> <p>Një mënyrë e tretë është dhe realizimi i pyetësorëve, të cilët realizohen në fund të çdo semestri me studentët e UPT.</p> <p>Në pyetësor, studentët pyeten në lidhje me: kushtet e mësimin, bazën didaktike, cilësinë dhe qartësinë e prezantimit të leksioneve e seminareve, korrektesen e mesimit, çështjen e blerjes së teksteve, mitmarrjes, abuzimeve të ndryshme, etj (marrë nga dokumenti “Pyetësor online për studentin”).</p> <p>Pyetësorët në UPT përdoren dhe për stafin akademik dhe ndihmës, në lidhje me cilësinë, kushtet, kërkimin, si dhe për të identifikuar problemet. Pyetësorët ruajnë anonimatin.</p>




	<p>Përveç vlerësimit të kritereve të ndryshme të mësimdhënies, studentët kanë dhe të drejta të tjera. Në RVB si dhe në rregulloren e FIM cilësohen procedurat për përmirësimin e notës, ankimimit të studentëve, e më pas trajtimi i ankimimeve.</p> <p><i>Ref_047 Praktika e parashikimit te ngarkeses</i>  <i>Ref_048 Raporti Analizes mesimore staf</i>  <i>Ref_057 Procedura e punesimit</i>  <i>Ref_065 Anketimi studentor</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacioni të dorëzuar nga IAL, konfirmohet rëndësia që i vihet monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në mësimdhënie. Rezultatet e analizës vjetore përmbledhen në një dokument, në të cilin përfshihen: Programet e studimit, Procesi mësimor, Stafit akademik, Studentët, Organizimi dhe menaxhimi i brendshëm. Sipas RVB, rezultatet finale të përfituara prej pyetësorëve bëhen publike ne faqen <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a>. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.</p> <p><i>Ref – Faqja ueb zyrtare e UPT</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Një nga arsytet e zhvillimit të pyetësorëve dhe shpërndarjes së rezultateve të tyre tek pedagogët përkatës, është edhe nevoja e përmirësimin të mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies, apo të aspekteve të tjera në punë.</p> <p>Gjithashtu, UPT mbështet dhe promovon stafin akademik për kualifikime afatgjata apo afatshkurtra në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të. Në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie, Universiteti ka marrë pjesë në projektet Erasmus Mundus, Erasmus Plus, ku është munduruar mobiliteti i stafit kryesisht në moshë të re dhe në proces kualifikimi.</p> <p><i>Ref_048 Raporti i analizes mesimore</i>  <i>Ref_066 Mobilitetet e realizuara</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>X</p>

### Standardi III.2


**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikatat profesionale e klinike,</p>	<p>Në bazë të dokumentave të ndryshëm të vënë në dispozicion të GVJ, si dhe nga vizita gjatë institucionit, u konstatua që procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, praktikatat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
 Faqe 38




<p>orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton që format e mësimdhënies dhe mësimnxënies janë sipas kategorive të ndryshme, sic kërkohen në këtë kriter. Detyrat e kursit dhe projektet janë të specifikuar në çdo syllabus, në rastet kur ato janë të planifikuara nga lektori. Në kurrikulën e studimeve të programit Inxhinieri Ekonomike i është dhënë hapësirë praktikës profesionale me qëllim aftësimin profesional të studentëve dhe njihjen me tregun e punës.</p> <p><i>Ref_011 Plani mesimor BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_044 Praktika e miratimit te planeve mesimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Sipas RVB, por edhe në bazë të dokumentacionit të konsultuar, GVJ evidenton që personeli akademik ka respektuar diversitetin e studentëve dhe nevojat e tyre. Metodatat dhe teknikat e mësimdhënies që aplikohen e përdoren për programet e ciklit të parë Bachelor janë të shumëllojshme.</p> <p>Gjithashtu nga RVB, GVJ konstaton që departamenti dhe stafi akademik janë zhvendosur nga forma tradicionale e mësimdhënies në atë bashkëkohore të ndërveprimit, duke e konsideruar veten shpesh në rolin e moderatorit në klasë. Ata theksojnë që disa nga format e mësimdhënies janë laboratorët, puna në grup, si dhe prezantimet. Gjatë vizitës GVJ u njoh me klasat, ambientet e laboreve, si dhe sallën e mjeteve mekanike.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, të bibliotekës apo të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore të të nxënësve.</p> <p>Mjetet e ndryshme teknologjike që stafi akademik shfrytëzon për procesin mesimor, janë të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve. Studentët ndjekin praktika në institucione të ndryshme publike e private.</p> <p><i>Ref_054 Informacion labororet FIM</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Curriculum Vitae të dorëzuara nga IAL për anëtarët e stafit që japin mësim në programin Bsc në "Inxhinieri Ekonomike", GVJ arrin në përfundimin që ky personel akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, si pasojë e edukimit të tyre, përvetësimit të titujve dhe gradave apo edhe nga eksperiencia e tyre profesionale në kompani apo projekte IT apo fusha të tjera.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm që angazhohet në mësimdhënie është i diplomuar në fushën përkatëse dhe ka kryer studime të mëtejshme në atë fushë. Në varësi të temës personeli akademik përdor</p>




<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>edhe metoda të ndryshme të mësimdhënies të cilat i kemi përmendur më sipër.</p> <p>UPT për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë të pjesshme, plotëson dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore, me të cilën GVJ u njoh dhe gjatë vizitës në IAL. Është departamenti ai që formulon kërkesën për ekspertizën e personave në profesion të specifikuar dhe bën një planifikim paraprak të moduleve që këta pedagogë të rinj do të mbulojnë duke zhvilluar leksionet dhe seminarat.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interaktive dhe diskutimi me studentët.</p> <p>Nga vëzhdimi i syllabus-eve të detajuar të lëndëve, GVJ konstaton dhe lëndë të caktuara që përfshijnë diskutimin e rasteve, punën në grup, etj. Këtë e konfirmuar edhe studentët gjatë vizitës në IAL.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i>  <i>Ref_024 CV e stafit akademik</i>  <i>Ref_057 Procedura e punesimit te personalit</i>  <i>Ref_069 Praktike punesimi staf akademik</i>  <i>Vizita ne IAL</i></p>								
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve, detyrat e kursit ose projektet lëndore zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup, si edhe bën që studentët të mësojnë nga njëritjetri. Studenti në këto prezantime mund të përfshijë literaturë shtesë si dhe të punojë në mënyrë individuale apo në grup.</p> <p>Nga vizita në IAL në takimin me studentët u konstatua një marrëdhënie mjaft e mirë mes tyre me njëri-tjetrin e mbi të gjitha kundrejt stafit akademik. U vu re respekt i ndërsjellë, ku studentët u shprehën që për çdo çështje apo problematikë në universitet që ata mund të kishin pasur, u ishin drejtuar pa problem stafit dhe kishin gjetur zgjidhjen ose mirekuptimin e tyre.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve BSC Ing Ekonomike</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="616 1532 815 1592">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="815 1532 1015 1592">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1015 1532 1214 1592">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1214 1532 1417 1592">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
 Faqe 40



<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në bazë të RVB, si dhe duke shqyrtuar dokumentacionin, GVJ konkludon që procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. Në bazë të vizitës dhe RVB ambjentet e UPT janë të pastra si rrjedhojë e punës që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të institucionit. Ky IAL ofron mjedise të reja e të pajisur plotësisht me të gjithë kapacitetin infrastrukturor dhe teknologjik për të plotësuar kërkesat e programit të studimit si dhe në përputhje me qëllimet e programit. I tërë procesi mësimor i programit të studimeve Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, ambjentet e të cilit i kemi listuar në kriteret e mëparshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Për laboratorët kujdeset stafi ndihmës. Pranë ambienteve të universitetit gjenden dy biblioteka, një e universitetit dhe një e Fakultetit, ku studentët mund të shkojnë në çdo kohë për të studjuar si dhe për të gjetur çdo informacion që atyre ju nevojitet. Biblioteka kryesore, ajo e vendosur pranë godinës së Rektoratit të Universitetit të Tiranës, është ambjenti që frekuentohet më së shumti nga studentët e programit Inxhinieri Ekonomike.</p> <p><i>Ref_070 Relacion per infrastrukturen e FIM</i>  <i>RVB – Tabela 16, 17</i>  <i>Vizita ne IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, institucioni ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Përmendim Microsoft Teams për profilet e pedagogëve dhe lëndëve, sistemin Gradua për Alumni, dhe Pitagora. Këto sisteme u demonstruan një pjesë dhe gjatë vizitës në IAL në mënyrë të detajuar.</p> <p><i>Ref_070 Relacion per infrastrukturen e FIM</i>  <i>Vizita ne IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Për çdo modul që zhvillohet në degën Inxhinieri Ekonomike pedagogu përkatës i vë në dispozicion studentëve literaturën bazë dhe ndihmëse/të rekomanduar, që do të përdoret për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve. Këto materiale janë në formë elektronike ose të printuara. Por, në disa raste literatura është më e vjetër se 5 vite, e për këtë rekomandohet përditësimi i këtyre rasteve.</p> <p><i>Ref_068 Shembull klase virtuale</i>  <i>Ref_073 Pasurimi i Bibliotekes Shkencore</i>  <i>Ref_074 Informacion mbi Bibliotekat ne UPT</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Sipas RVB, në bibliotekë janë përfshirë periodikë të ndryshëm të shkruar dhe elektronikë të revistave më influencuese në fushën e ekonomisë dhe inxhinierisë. Nevojitet një plotësim i bibliotekës edhe me tituj nga fusha e industrisë, sidomos gjeneratës 4.0, megjithatë IAL ka bërë përpjekje serioze për shtimin e këtyre titujve. Përditësimi i kësaj biblioteke bëhet në vazhdimësi nga IAL. Në RVB cilësohet që Biblioteka e FIM është në</p>




<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>fazë ristrukturimi, e për pasojë vlerësimi i këtij kriteri konsiderohet i realizuar, <i>por sugjerohet që FIM të ndjekë një plan strategjik për plotësimin me tituj bashkëkohorë të saj.</i></p> <p>Së fundmi, me vendosjen e Bibliotekës Dixhitale U-Library të mundësuar nga RASH studentët do të kenë mundësi të aksesojnë literaturën ndihmëse që ju është dhënë për referencë dhe thellim të njohurive nga pedagogu i modulit përkatës dhe gjithashtu për zhvillimin e temave të diplomave.</p> <p><i>Ref_074 Informacion mbi Bibliotekat ne UPT</i> <i>Ref_075 Biblioteka Digjitale</i></p>																																																												
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton që hapsirat për realizimin e laboratorëve dhe studimeve specifike janë të mjaftueshme për studentët. Këto paraqiten në tabelën e mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="625 689 1407 1102"> <thead> <tr> <th></th> <th>Emërtimi</th> <th>Sasia</th> <th>Sip.</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>Salla për leksione</td> <td>8</td> <td>639</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>Klasa për seminare</td> <td>15</td> <td>663</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>Salla për aktivitete promovuese</td> <td>1</td> <td>130</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>Salla për praktikë lëndore/profesionale</td> <td>2</td> <td>1150</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>Laboratorë për lëndët</td> <td>11</td> <td>875</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>Laboratorë informatike</td> <td>1</td> <td>37</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>Salla për internet</td> <td>1</td> <td>252</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>Mjedis për fotokopjime, librari etj.</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>Zyrë informacioni për studentët</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>10</td> <td>Korridore/holle</td> <td>13</td> <td>1873</td> </tr> <tr> <td>11</td> <td>Mjedise sportive</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>12</td> <td>Mjedise shërbimi për të tretë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>13</td> <td>Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>14</td> <td>Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj.</td> <td>2</td> <td>508</td> </tr> </tbody> </table> <p>Objektivi bazë i Laboratorit të programit të studimit Bsc në “Inxhinieri Ekonomike” është, që studentët të zhvillojnë praktikat mësimore për të konkretizuar procesin e mësimdhënies dhe realizimin e kërkimit shkencor, bazuar në metoda standarde si dhe në interpretimin e rezultateve në bashkëpunim me pedagogët e fushave përkatëse.</p> <p><i>Sugjerojmë që këto mjedise dhe kjo infrastrukturë të zgjerohet më tej në kuadrin e rritjes së kryerjes së kërkimit shkencor nëpërmjet eksperimenteve, përdorimit të pajisjeve matëse, ndërtimit të rrjeteve, financimit të sensorëve dhe pajisjeve të tjera që mund të përdoren në fusha të ndryshme të industrisë. Mund të ishte në ndihmë të studentëve, si dhe për të përballuar ngarkesën e lektorëve, që të shtohet një laborator i dytë informatike, meqënëse përvec lëndës së kësaj fushe studentët kanë dhe CAD, apo orë seminarike në lëndë të tjera ku mund të shfrytëzojnë programe softuerike apo mjete digjitale. Gjithashtu sugjerojmë dhe mundësinë e krijimit të një mjedisi të dedikuar për aktivitetet e qeverisë studentore si dhe një për informimin e studentëve.</i></p> <p><i>Ref_054 Informacion laboratorët FIM</i> <i>Ref_072 Evidenca mbi laboratorët FIM</i></p>		Emërtimi	Sasia	Sip.	1	Salla për leksione	8	639	2	Klasa për seminare	15	663	3	Salla për aktivitete promovuese	1	130	4	Salla për praktikë lëndore/profesionale	2	1150	5	Laboratorë për lëndët	11	875	6	Laboratorë informatike	1	37	7	Salla për internet	1	252	8	Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1	20	9	Zyrë informacioni për studentët			10	Korridore/holle	13	1873	11	Mjedise sportive			12	Mjedise shërbimi për të tretë			13	Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore			14	Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj.	2	508
	Emërtimi	Sasia	Sip.																																																										
1	Salla për leksione	8	639																																																										
2	Klasa për seminare	15	663																																																										
3	Salla për aktivitete promovuese	1	130																																																										
4	Salla për praktikë lëndore/profesionale	2	1150																																																										
5	Laboratorë për lëndët	11	875																																																										
6	Laboratorë informatike	1	37																																																										
7	Salla për internet	1	252																																																										
8	Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1	20																																																										
9	Zyrë informacioni për studentët																																																												
10	Korridore/holle	13	1873																																																										
11	Mjedise sportive																																																												
12	Mjedise shërbimi për të tretë																																																												
13	Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore																																																												
14	Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj.	2	508																																																										




<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>IAL përdor Microsoft Teams jo vetëm si një LMS (Learning Management System), por edhe për mësimin online. Po ky sistem mundëson komunikimin e brendshëm, si dhe për shpërndarjen në format elektronik të dokumentacioneve. Secili, studentët dhe stafi, ka hapsirën e vet të dedikuar në këtë sistem.</p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p><i>Ref_043 Manual perdorimi platforma e secretarise mesimore Pitagora</i> <i>Ref_068 Shembull klase virtuale ne platformen MS Teams</i></p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Realizimi i temave të diplomave si përmbyllje e këtij cikli studimi vendoset në bazë të dokumentit “Procedura, konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor” po ashtu dhe të departamentit.</p> <p>Për t’i ardhur në ndihmë në punën studimore dhe laboratorike të studentit, Departamenti propozon një person ndihmës, i quajtur Konsulent i Diplomës.</p> <p>Drejtuesi i Departamentit krijon fondin e temave të diplomave sipas propozimeve të stafit akademik dhe numrit të studentëve, duke pasur parasysh:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– temat përcaktohen dhe miratohen mbasi Departamenti ka bërë një analizë të nevojave dhe fushave të ekspertizës;</li> <li>– punimi i diplomës së ciklit të parë të studimeve është në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera, studim literature* në fushat e programit përkatës të studimit.</li> <li>– tema e diplomës përmban kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së studimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave projektuese ose/dhe zbatuese, probleme të prodhimit apo për të punuar me literaturën në fushën përkatëse, por kjo nuk duhet të tejkalojë kufizimet që vijnë nga niveli i njohurive të marra dhe kreditet e parashikuara për punimin e diplomës; etj.</li> </ul> <p>Nga RVB, ose nga dokumentacioni i dorëzuar, <i>GVJ nuk konstaton ndonjë procedurë që IAL ka vendosur të ndjekë në lidhje me metodat shkencore që studentët duhet të kenë parasysh për diplomën, shkrimin akademik, etj.</i> Kjo u konfirmua dhe gjatë vizitës. Dokumenti thotë që stafi që zakonisht ka minimum 3 studentë në udhëheqje dhe kjo e ka bërë situatën të menaxhueshme, pasi pedagogu udhëheqës është përgjegjës për cilësinë e temës së diplomës dhe jep vlerësimin e tij për procesin e mbrojtjes. Kjo situatë mund të ndryshojë kur numri i studentëve dhe temave të rritet.</p> <p><i>Ref_011 Plani Mesimor PS BSc ne Inxhinieri Ekonomike</i> <i>Ref_060 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet pjesësisht</p>
		X	




**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në IAL Universiteti Politeknik i Tiranës, vepronë Zyrat në përbërje të Rektoratit si Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe Drejtoria e Kurrikulave. DBSC vendos lidhje bashkëpunimi me dekanët, drejtorët e institutive, drejtuesit e programeve të studimit, përgjegjësit e departamenteve dhe entitetete të tjera. Personeli përgjegjës për cilësinë e mësimin në nivel njësie qendrore (FIM) është zëvendësdekani për mësimin dhe kurrikulat i cili emërohet nga dekani. Ai, nën drejtimin e dekanit organizon, ndjek dhe kontrollon gjithë veprimtarinë mësimore në Fakultet, ndjek dhe përgjigjet për zbatimin e kurrikulave, planeve dhe programeve mësimore, strukturës së vitit akademik. Ai përgjigjet për organizimin, ndjekjen dhe zhvillimin e analizave të punës mësimore në departamente dhe ndjek procedurat e vetëvlerësimit në departamente. Një prej detyrave të zëvendësdekanit është që në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit të sigurojë përmirësimin e cilësisë, nxjerrjes së të pikave të dobëta dhe paraqitjes së masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies si në nivelin e formës ashtu edhe atë të përmbajtjes.</p> <p><i>Ref_001 Statuti i UPT</i> <i>Ref_005 Organigrama e UPT</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Prodhim Menaxhimit është përgjegjës për programin e studimit “Inxhinieri Ekonomike”. Ai kujdeset për cilësinë e mësimdhënies, përzgjedh personelin akademik, si dhe bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me rregullatorët e institucionit si dhe bazuar në ligjet e arsimit të lartë. Departamenti përgjigjet për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes si të pedagogëve ashtu dhe të studentëve që programi i studimit Bsc në Inxhinieri Ekonomike është një program që nuk ofrohet në IAL të tjerë në formë të ngjashme, që e bën atë unik ndër ofertat akademike për studentët. Gjithsesi, departamenti has sfida që janë të përgjithshme për mjedisin tonë akademik, e shkojnë përtej mundësive, si numri dhe larmishmëria e vendeve të punës që duhet të ofrohen nga tregu.</p> <p><i>Ref_010 Rregullore PS BSc ne Inxhinieri Ekonomike</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstatoi si nga RVB, ashtu dhe nga vizita në IAL që Departamenti mbështet zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. <i>Por ka gjithmonë mundësi për të përmirësuar, sidomos në lidhje me infrastrukturat për mësimin online dhe laboratorët.</i></p> <p><i>Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024</i> <i>Ref_007 Plani Strategjik FIM 2020-2024</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti ndjek politika lehtësuese për kërkimin shkencor të personelit i cili konsiderohet një aset thelbësor. GVJ konstaton që UPT nxit pjesëmarrjen e pedagogëve në trajnime që zhvillojnë aftësitë e tyre. Ky IAL ka organizuar konferenca, në të cilat stafi i brendshëm është përjashtuar nga pagesa e artikujve. Nga ana e tyre stafi është i interesuar për të marrë pjesë në projekte të ndryshme ndërkombëtare si dhe në trajnime jashtë vendit për të përmirësuar fushën e tyre të kërkimit e për ta pasqyruar këtë dhe në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Në këto projekte ka pasur impakt dhe zhvillimi i vetë degës “Inxhinieri Ekonomike”, pasi janë vendosur dhe ura të rëndësishme bashkëpunimi si dhe është zgjeruar rrjeti akademik, që mund të sjellë përfitime të tjera në të ardhmen, vecanërisht me universitetet që ofrojnë një kurrikul të ngjashme, si Politekniku i Barit, Itali.</p> <p><i>Ref_066 Mobilitetet e realizuara 2017-2020</i>  <i>Ref_076 Raporti aktivitetit të Kerkimit Shkencor pedagog departament FIM</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në UPT përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale e personelit akademik. Institucioni bën përpjekje për të promovuar përdorimin e këtyre metodave, por përsëri vihet re se përvetësimi dhe shfrytëzimi i tyre në mësimdhënie përqafohet më kollaj nga brezi i pedagogëve të rinj, ndërkohë që përdoren më pak nga brezi i atyre me më shumë përvojë (vite eksperiencë pune). Në programin e studimit “Inxhinieri Ekonomike”, pjesa më e madhe e stafit u vu re që janë në moshë të re, që kanë titullin Doktor, si dhe puna e bërë prej tyre është e rëndësishme për programin. Sipas RVB, në Departamentin e Prodhim Menaxhimit, diskutohet përdorimi i mjeteve audio-vizive; ndërthurja e teorive të përçuara me shembuj të botës reale për të rritur nivelin e asimilimit; nxitja e ideve nëpërmjet punës në grup etj.</p> <p><i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM</i></p>		
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.5**


**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në lidhje me kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, IAL ka të përcaktuara në dokumentin “Rregullore e Programit të Studimit”, sipas të cilës: nota përfundimtare është shumë e elementeve të një procesi të vazhduar, që përfshin detyra, projektet, angazhimin e studentëve, etj. Saktësisht:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Provimit me shkrim;</li> <li>- Provimit me gojë;</li> </ul>



Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
 Faqe 45




<p>profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>- Vlerësimin të projektit; - Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt.</p> <p>Format dhe kriteret e vlerësimin të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura paraprakisht studentëve në fillim të çdo lëndë. Studentët njihen me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimin të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës, në fillim të çdo semestri.</p> <p><i>Ref_041 Procedura per vleresimin e dijeve ne FIM</i> <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ vlerëson që të gjitha format e vlerësimin të njohurive të përmendura në kriterin 1 dhe 2 i japin mundësi studentit që të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara, por në disa nga lëndët e vitit të parë, vihet re në syllabus që kanë vetëm një provim të ndërmjetëm (në disa raste 2) dhe një provim final (Analiza Matematike 1 dhe 2, Algjebra, Vizatimi Teknik, Bazat e Informatikës, Mekanika Teorike, Statistikë, Fluidodinamika, Mekanika e aplikuar, Teknologji mekanike.</p> <p>Lëndët Hyrje në Ekonomi, Fizikë Teknike, Mikroekonomi, Parimet e Kontabilitetit, Drejtimi Financiar, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Bazat e Menaxhimit të Ndërmarrjeve, Analiza e Pasqyrave Financiare, Biznes Ndërkombëtar nuk ka të reflektuar seksionin Kontrollin gjatë semestrit, si dhe pjesë të tjera të syllabusit janë të paplotësuara.</p> <p>Lënda CAD pohon që lënda kontrollohet me punë praktike, por nuk saktësohen sa detyra jepen, si dhe sa pikë merren në secilën prej tyre. Lënda Bazat e Elektroteknikës nuk ka asnjë formë kontrolli gjatë semestrit.</p> <p><i>Së pari, GVJ sugjeron që format e vlerësimin të mos jenë të ngjashme për të tre vitet akademike. Gjatë vitit të parë të studimeve pesha e provimit përfundimtar mund të mbetet në masën 70-80%, ndërsa në vit të tretë, ku detyrat dhe projektet janë më komplekse, pesha e tyre të jetë rreth 50-60%.</i></p> <p><i>Së dyti, sugjerohet që detyrat e kursit në ndonjë prej lëndëve të jenë në formën e "short paper", në mënyrë që studentët të trajnohen me mënyrën e të bërit kërkim shkencor.</i></p> <p><i>Së treti, në syllabuset e lëndës, në sesionin <b>Vlerësimi për lëndën të cilësohet jo në formë narrative, por lista e pikëve për çdo vlerësim gjatë lëndës, p.sh.</b></i></p> <p>Detyrë kursi 5 pikë Laborator 10 pikë Provimi i ndërmjetëm 20 pikë Provimi final 65 pikë.</p>


	<p>Në disa syllabuse nuk përkojnë cilësimet e vendosura në Kontrollin gjatë semestrit me shpjegimet nën Vlerësimi për lëndën.</p> <p>Në përgjithësi, lëndët kanë të organizuara në syllabuset e tyre në mënyrë të kënaqshme objektivat, temat e leksioneve e seminareve, etj, <i>por sugjerohet që të gjithë të rishihen dhe plotësohen në gjithë sesionet e tyre, të saktësohen qartë detyrimet semestrale të studentëve, frekuenca, detyrat, projektet, labororet, provimet e ndërmjetme, etj.</i> Syllabuset janë jo vetëm për stafet akademike, por edhe për studentët, e nëse shihen dhe me syrin e tyre, në raste të vecanta mund të krijojnë paqartësi tek ta.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Ekonomike</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>
		<b>X</b>	

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Sipas të dhënave të reflektuara në syllabus-et e lëndëve, e në bazë të Rregullores të Programit të studimit, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit është shumë e elementëve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Provimit të ndërmjetëm</li> <li>Nivelit të diskutimit në seminare dhe frekuencës</li> <li>Detyrës së kursit/detyra praktike/laboratorë</li> <li>Provimit përfundimtar.</li> </ol> <p>Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në mes të semestrit (java e 7-të ose e 8-të, sipas Rregullores, seminaret janë të përjavshme, kurse detyrat e tjera janë të shpërndara sipas planit të secilit pedagog të lëndës. Kjo, për GVJ, vërteton shpërndarjen e vlerësimit përgjatë gjithë semestrit.</p> <p><i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni nuk ka një sistem elektronik për testimin dhe vlerësimin e studentëve.</p> <p><i>Sugjerojmë që UPT të vendosë bashkëpunim me AADF (AlbanianAmerican Development Foundation) për systemin e vlerësimit elektronik: "Clean score", për sekretimin dhe leximin elektronik të testeve.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion ("Rregullore e programit të studimit"), si dhe RVB, çdo komision përbëhet nga dy pedagogë njëri prej të cilëve është titullari i lëndës dhe pedagogu tjetër është pedagog që zhvillon module të ngjashme apo dhe mund të ndajë me pedagogun përgjegjës së lëndës pjesën e zhvillimit të seminareve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 47





	<i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie në UPT</i>
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Sipas dokumentit Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie, UPT ka një format të vetin të fletoreve ku mund të realizohet sekretimi dhe mos njohja e identitetit të studentit deri në momentin që studenti vjen dhe e identifikon vetë fletoren dhe vendos emrin e tij/saj në fletore. Sekretimi është me karbon dhe mbyll kapakun e fletores në pjesën ku janë të dhënat përkatëse si Emër, Mbiemër, Kursi, Lënda. Në momentin që studentit i sekretohet fletorja i vendoset një numër në kapak dhe ai e di se fletorja e tij/saj mban këtë numër. Përsëri sipas RVB, shpesh ky proces nuk është zbatuar.
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Disa nga arsyt kryesore të kësaj mangësie janë: 1) stafi ndihmës e ka patur të pamundur të mbulojë gjithë procesin e punës pasi orët fizike të punës që kërkon ky proces janë të shumta, 2) në rregulloret e institucionit nuk janë detajuar procedurat specifike për këtë proces.  <i>IAL nuk siguron infrastrukturë të posaçme dhe mjete survejimi në provimet e lëndëve të programit të studimit, por vë në dispozicion personel.</i>  Gjatë vizitës në IAL, në takimin me studentët, u konstatua që studentët kanë marrë komente dhe janë sqaruar në rastet kur nuk kanë pasur qartësi për pjesën e korrigjimit të provimeve.  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie në UPT</i> <i>Ref_041 Procedura për vlerësimin e dijeve në FIM</i>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në programet lëndore (syllabus) të programit të studimit “Inxhinieri Ekonomike” nuk cilësohet në përgjithësi se çfarë penaltetesh mund të ketë një student që konstatohet se ka bërë plagjiaturë në detyrën e kursit /projektit.  Mënyra e zhvillimit të provimeve saktëson që studentët duhet të hyjnë me mjet identifikimi dhe nuk lejohen të kopjojnë, tezat rifreskohen në çdo sezon provimesh, si dhe për tezat e diplomave nuk lejohet plagjiatura. Kur studentit përdor mjete të palejuara në provim, atëherë ai përjashtohet nga provimi.  <i>Ref_003 Kodi i Etikës i UPT</i>
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në dokumentin “Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënie në UPT”, Neni 34, Format e Kontrollit përmendet që: në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni jo më vonë se pesë ditë pune nga data e dhënies së provimit. Vonesa në dhënie e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi komisionin e provimit.
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Gjithashtu, komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës sipas nenit 36 (fleta e provimit). Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose të kundërshtojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i




	<p>detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Këto u konfirmuan dhe nga vizita me studentët në IAL.</p> <p><i>Ref_003 Kodi i Etikës i UPT</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT Vizita ne IAL</i></p>						
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ konstaton që procedura e ankimeve të studentëve është e dokumentuar në “Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT” Neni 35. Sipas këtij dokumenti: studenti ka të drejtë të ankimohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, brenda një afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit. Kjo ankesë shqyrtohet nga dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime drejtuesin e njësisë bazë përkatëse, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë, brenda tri ditëve pune.</p> <p><i>Sugjerojmë që IAL të rishohë këtë procedurë dhe për shqyrtimin e ankesave nga studentët të merren departamentet e programit të studimit. Gjithashtu, sugjerojmë që procesi i provimeve, vlerësimit dhe ankimit të përfshihet dhe në Rregulloren e Programit të Studimit.</i></p> <p><i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

<p><b>Standardi III.7</b> <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Inxhinieri Ekonomike”, sipas dokumentit “Rregullore e Programit të studimit”, Kreu I, Neni 1, <i>synon t’u japë studentëve njohuri shkencore themelore në fushën e inxhinierisë dhe ekonomisë.</i> GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të vecanta të studentëve, <i>por GVJ sugjeron përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin/ modifikimin e lëndëve të caktuara, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.</i></p> <p>Ndërkohë në dokumentin “Suplement i diplomës”, përcakton në mënyrë mjaft të detajuar (përtej çfarë përmbajnë të gjithë dokumentet e tjerë përshkrues të programit të studimit) objektivat në drejtim të fitimit të njohurive, në drejtim të njohurive intelektuale, në drejtim të aftësive</p>

	<p>praktike. Në këtë dokument, pika 5, “Mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional” gjejmë që:</p> <p>Diploma Bachelor në Inxhinieri Ekonomike nuk jep mundësi për të ushtruar një profesion të rregulluar në bazë të legjislacionit shqiptar.</p> <p><i>Sugjerojmë që, për zhvillimin e programit të studimit dhe garantimin e tij të aftësive profesionale, të shihet mundësia e përcaktimit qartë të profesionit të studentëve të diplomuar në këtë program, duke vendosur ura bashkëpunimi me MAS, ose autoritetet përkatëse. Nga ana tjetër ky session në suplementin e Diplomës mund të plotësohet dhe me përshkrimin e mundësive të punësimit të studentëve duke pasur në konsideratë dhe pozicionet e punës në rajon apo Europë, e jo vetëm ato të parashikuara në legjislacionin shqiptar.</i></p> <p><i>Ref_010 Rregullore PS BSc ne Inxhinieri Ekonomike</i> <i>Ref_011 Plani Mesimor PS BSc ne Inxhinieri Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në programin e studimit “Inxhinieri Ekonomike” rreth 50% të lëndëve të kurrikulës e zënë lëndët karakterizuese për zhvillimin e aftësive në fushën e Inxhinierisë. Në këtë program gjejmë dhe lëndë të disiplinave të tjera si Menaxhim Projektsh, Gjuhë të Huaja, apo Biznes Ndërkombëtar që mund të ndihmojnë në aftësitë organizative, apo përmirësimin e ndërveprimit dhe komunikimit. Këto module i japin mundësi studentit të kuptojë tregun e punës, të jetë më komunikues, të jetë i aftë të punojë në grup.</p> <p><i>Sugjerojmë që në ndonjë nga lëndët ekzistuese të përfshihen dhe tema që kanë të bëjnë më shumë me komunikimin, vendimmarrjen, apo aftësitë e buta në përgjithësi.</i></p> <p><i>Ref_011 Plani Mesimor PS BSc ne Inxhinieri Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në programin e studimit, për secilin modul të programit të studimit gjendet rubrika Përmbledhje dhe Rezultate e të Nxënit. Në përfundim të modulit stafi akademik bën një vlerësimin të nivelit të përfitimit të kompetencave të synuara në syllabusin e modulit. Njësia kryesore dhe njësia bazë organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij.</p> <p><i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde pedagogu i modulit bën një përmbledhje të çështjeve më të rëndësishme duke i orientuar në lidhje me provimin përfundimtar, zbatimin e tyre në praktikë si dhe sjell raste studimi nga eksperiencia e tij të viteve të kaluara. Një pjesë e mirë e syllabuseve dhe planeve kalendar të moduleve kanë të parashikuara seanca speciale për përsëritjen e lëndës, pra evidentimin e temave më të rëndësishme mesqarimet e nevojshme.</p> <p><i>Ref_041 Procedura per vleresimin e dijeve ne FIM</i></p>




<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Përgjithësisht personeli akademik i brendshëm integron të reja më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Në Planin e Aktiviteteve të UPT-së një nga pikat është edhe zhvillimi i Konferencave studentore, nën drejtimin e pedagogëve.</p> <p><i>Ref_079 Programi Konferences Studentore FIM</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në programin e studimit "Inxhinieri Ekonomike", përveç leksioneve janë dhe seminarët të cilat aplikojnë çdo njohuri të marrë në leksione. Ata kanë në program dhe mjaft laboratore në lëndë të caktuara, si dhe forma të tjera të kontrollit. Praktika është pjesë përbërëse e kurrikulës, në të cilën studentët njihen me tregun dhe kulturën e punës.</p> <p><i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT</i> <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Ekonomike</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, në takimin me stafin GVJ konstatoi mirëkuptimin dhe dëshirën e stafit për të zhvilluar më tej programin e studimit. Në këtë takim morën pjesë një numër i stafit akademik. Të gjithë anëtarët e DPM i diskutojnë çështjet që lidhen me programin e studimit Inxhinieri Ekonomike dhe më pas në nivel departamenti. Gjithashtu anëtarët e departamentit DPM bashkëpunojnë dhe me anëtarët e departamenteve të tjera që zhvillojnë mësim në programin e studimit IE. Nga ana tjetër pedagogët e diskutojnë dhe bashkëpunojnë me sektorin e IT-së për mirëfunksionimin dhe mirëmbajtjen e laboratorëve dhe rrjetit përkatës.</p> <p><i>Ref_023 Syllabuset e lendeve ne PS BSc Inxhinieri Ekonomike</i> <i>Vizita ne IAL</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Në programet lëndëve GVJ konstaton që në një pjesë të lëndëve studentët zhvillojnë projekte dhe detyra kursi. Projektet dhe detyrat e kursit përfshihen dhe në vlerësimin e vazhduar të studentit, kështu që kjo përveçse i ndihmon studentët për të rritur frymën e bashkëpunimit në grup dhe për të marrë njohuri më të thella lidhur me lëndë të caktuara i ndihmon ata edhe për një vlerësim më të plotë të lëndës përkatëse. <i>GVJ mendon që për të zhvilluar idetë innovative, për të kryer studime të avancuara kërkimore e shkencore detyrat e kursit nuk mund t'i plotësojnë mjaftueshëm këto aftësi. Në rastin më të mirë, këto aftësi plotësohen duke përfshirë stafin dhe studentët në projekte kërkimore.</i></p> <p><i>Një formë tjetër mund të jetë duke kërkuar financime nga Alumni, ose nga biznese që FIM/DPM ka marrëveshje për të financuar sadopak projekte, iniciativa, pajisje të vogla (sensorë, aparatë matës, pajisje rrjeti, nyje përpunuese, etj).</i></p> <p><i>RVB – Tabela 20</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në UPT, studentët që kanë mesataren e lartë dhe studentët të kategorive të caktuara, përfitojnë bursë mujore sipas vendimeve të bordit të administrimit dhe të senatit për bursat. GVJ nuk konstaton ndonjë formë</p>




	tjetër mbështetjeje financiare për idetë inovative, por FIM organizon konferenca studentore të përvitshme.								
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Sikurse është përmendur në kriteret e mësipërme që lidhen me kualifikimin e stafit, një pjesë e tyre janë trajnuar jashtë vendit për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të. Gjithashtu programet e studimit në FIM janë të unifikuar me programet e universiteteve partnere në mënyrë që studentët të shkëmbejnë eksperiencën me homologët e tyre. Në ndihmë të plotësimit të këtij kriteri vijne dhe programet e ndryshme të shkëmbimit të studentëve dhe stafit akademik.  <i>Ref_066 Mobilitetet e realizuara 2017-2020</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në dokumentin “Konceptimi dhe Mbrojtja e Punimit të Diplomës në programet e ciklit të parë të studimeve në FIM” janë të hartuara dhe përcaktuara procedurat e posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës. Procedurat dhe standartet e diplomimit janë të renduara dhe në dokumentin “Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT”.
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Ky informacion gjenden i afishuar publikisht në faqen zyrtare të UPT, Rubrika Legjislacioni:  <a href="https://upt.al/2014-11-05-10-00-43">https://upt.al/2014-11-05-10-00-43</a>
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<i>Ref_060 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor</i>  Departamenti vë në dispozicion të studentëve formatin e Diplomës (sipas dokumentit të dorëzuar), në të cilin janë të përcaktuara jo vetëm rregulla të formatimit të tekstit, por ka dhe instruksione për përmbajtjen, çështjet kryesore që duhet të mbajë tema, hipotezat, referencat etj. Gjithashtu, cilësohet që pedagogët udhëheqës asistojnë studentët që kanë nën udhëheqje për shkrimin e temës së diplomës duke i ndihmuar ata me materiale, me ndarjen në çështje dhe nënçështje, në mënyrën se si japin detajet për zhvillimin e programeve si dhe në dhënien e konkluzioneve. <i>GVJ konstaton që kjo është një ndihmë e rëndësishme që u jepet studentëve, por theksojmë seriozisht që për procesin e shkrimit të një punimi shkencor/diplome ata duhet të jenë instruktuar në një lëndë të veçantë ose në përbërje të ndonjë lënde ekzistuese.</i>

	<i>Ref_060 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	<p>Në bazë të dokumentit “Konceptimi dhe Mbrojtja e Diplomës për programet e ciklit të parë të studimeve në FIM”, pikat 8.1 e në vijim, studenti e zhvillon punimin e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi të miratuar. Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, të cilat duhet të respektohen nga studenti.</p> <p>Pra, GVJ konkludon që orientimi dhe ndihma e personelit akademik për studentët në përgatitjen e temës së diplomës realizohet nëpërmjet kontrolleve të ndërmjetme.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>Sipas RVB, në rastin e punimit të diplomës në programin e studimit bachelor në Inxhinieri Ekonomike institucioni i asiston studentët duke ju vendosur në dispozicion laboratorët dhe gjithë mjediset e FIM dhe jashtë orarit zyrtar të mësimin. Studentët mund të shfrytëzojnë kompjuterat dhe programet e instaluar në laboratorë. Në këtë kriter kërkohet dhe asistencë e IAL për kryerjen e matjeve e analizave, pra procedurave eksperimentale. <i>GVJ rithekson nevojën që ka ky program studimi veçanërisht për zhvillimin e këtyre proceseve, ndoshta më tepër se programe të tjera të ngjashme studimi në IAL shqiptare, veçanërisht atë të Industry 4.0, që sot është kryefjalë në zhvillimet globale.</i></p> <p><i>Ref_006 Rregullore brendshme FIM</i></p> <p><i>Ref_054 Informacion laboratorët FIM</i></p>
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	<p>Në departamentin e Prodhim Menaxhimit, udhëheqësi i punimit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sezonin normal të mbrojtjes së diplomës. Studenti në fund të provimit, ose të mbrojtjes së diplomës vlerësohet me notë.</p>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	<i>Ref_060 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor</i>
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	<p>Sipas dokumentit “Rregullore e brendshme e departamentit”, studenti që kalon me sukses temën e diplomës/provimin e formimit pajiset me diplomën përkatëse, e cila i jepet atij së bashku me “Shtojcën e diplomës” (diploma supplement). Në dokumentin e diplomës shënohet fusha e studimit të përfunduar dhe specialiteti përkatës. Suplementi i Diplomës është i bazuar mbi modelin e hartuar nga Komisioni European, Këshilli i Europës dhe UNESCO/CEPES, dhe i miratuar nga Ministria e Arsimit.</p> <p><i>Ref_055 Modeli i suplementit të Diplomës.pdf</i></p> <p><i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrrikular dhe Mesimdhënie ne UPT</i></p>

<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, vetëm në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.  <i>Ref_081 Model programi mësimor BSc Inxhinieri Ekonomike.pdf</i>		
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore (SM) e FIM është struktura kryesore e cila administron, menaxhon dhe ruan dokumentacionin e studentëve për çdo program studimi në FIM  <i>Ref_006 Rregullore e brendshme e FIM.pdf</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Sipas strukturës organizative të UPT, institucioni ka ngritur Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike nën varësinë e zv. Rektorit, e cila ka në përbërje të saj Sektorin për çështjet Juridike ku është edhe posti i Specialistit të Burimeve Njerëzore. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike është përgjegjës për ruajtjen dhe përditësimin e dosjeve të personelit akademik efektiv, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. Gjatë vizitës në institucion GVJ zhvilloi takim me Specialistin për Burimet Njerëzore. Gjatë këtij takimi, në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë dhe të rregullt për çdo anëtar të personelit akademik efektiv, si dhe të personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Në dosjen e secilit anëtar të personelit përfshihen informacione të tilla si: diplomat, certifikat e kualifikimeve të ndryshme, vërtetimet për gradat akademike, CV-të, kontratat e punës, etj. GVJ u informua që përditësimi i dosjeve bëhet rast pas rasti kur ka ndryshime në nivelin e gradave apo titujve akademik, dhe jo sipas një planifikimi të paracaktuar periodik nga kjo zyrë. Të dhënat e personelit mbahen në dosje fizike, kurse përsa i përket ruajtjes së tyre në format elektronik, GVJ u informua se institucioni ka planifikuar blerjen e

	<p>një programi softëare-ik për hedhjen dhe ruajtjen e tyre edhe në një bazë të dhënash elektronike institucionale.</p> <p>Përsa i përket të dhënave të personelit akademik me kontratë GVJ u informua që këto dosje mbahen në Departamentin e Prodhim Menaxhimit si dhe nga Sekretarja e Dekanit të FIM (në rolin e Specialistit të Personelit dhe Arkivit). Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se kishte një moskoordinim të këtyre njësive përsa i përket mirëmbajtjes dhe përditësimit të dosjeve të personelit akademik me kontratë. GVJ sugjeron që këto dosje të administrohen nga Sektori i Burimeve Njerzëzore dhe Juridike si njësia përgjegjëse në institucion për ruajtjen dhe përditësimin e dosjeve të personelit, në mënyrë që edhe administrimi dhe përditësimi i tyre të jetë sa më i kontrolluar dhe i rregullt. Gjatë vizitës në institucion GVJ e adresoi dhe e diskutoi këtë problematikë me Përgjegjësën e Departamentit të Prodhim Menaxhimit, i cili na siguroi në angazhimin maksimal të Këshillit të Programit të Studimit, për ruajtjen dhe përditësimin e dosjeve të të dhënave të personelit akademik me kontratë çdo fillim viti akademik.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_005 Organigrama e UPT.pdf</i>  <i>Ref_015 Organigrama e FIM.pdf</i>  <i>Minuta Inxhinieri Ekonomike.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se UPT ka hartuar procedura për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Këto procedura janë përcaktuar në Statutin e UPT Neni 42. Në bazë të Statutit vendet e punës për personelin akademik fitohen me konkurim. Procedura e përgjithëshme e punësimit në UPT kalon nëpër këto faza:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia bazë përcakton nevojat dhe kriteret specifike për vendin e punës vakant;</li> <li>- Komisioni “ad-hoc” vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës në fjalë dhe ia përcjell Rektorit të UPT për miratim;</li> <li>- Rektorit i UPT shpall kandidatin fitues dhe lidh kontratën e punës me të.</li> </ul> <p>Bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se kriteret e përgjithëshme janë të përcaktuara në Rregulloren e FIM Neni 30. Sipas kësaj Rregulloreje në parim kriteret e përgjithëshme të punësimit përcaktohen në Rregulloren e UPT kurse ato specifike në Rregulloren e Departamenteve.</p> <p>Në lidhje me rekrutimin e personelit për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, nevojat për staf akademik përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Prodhim Menaxhimit në bashkëpunim me Grupin Mësimor të Menaxhimit Industrial dhe Inxhinierisë Ekonomike, nevoja të cilat i paraqiten dekanit të FIM dhe më pas Rektorit të UPT. Vlerësimi i nevojave bëhet çdo vit akademik në lidhje me ngarkesën mësimore totale të këtij programi studimi si dhe ngarkesat individuale të stafit ekzistues, duke hartuar një plan të ngarkesave mësimore për çdo pedagog. Në njoftimin për vendin vakant specifik, paraqiten fushat</p>




	<p>kryesore që do të mbulohen nga personeli i kërkuar, disiplina të tjera ku mund të përfshihet, si dhe kriteret e propozuara për kandidatin.</p> <p>Procedurat e punësimit përcaktohen dhe ndiqen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike në përputhje me Statutin e UPT dhe Vendimin e Rektorit të UPT “Për miratimin e procedurës së punësimit për personelin akademik me kohë të plotë në UPT”. Shpallja e vendeve vakante bëhet publike në faqen e ëeb-it të institucionit si dhe në mjediset e tij. GVJ shqyrtoi dokumentacionin e arkivuar (“Praktikë punësimi staf akademik”) për disa procedura rekrutimi të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme dhe vëren se të gjitha procedurat e përcaktuara në rregulloret e sipërcituara janë ndjekur me rigorozitet.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_006 Rregullore brendshme FIM.pdf</i>  <i>Ref_008 Rregullore brendshme departamenteve ne FIM.pdf</i>  <i>Ref_056 Procedura punesimit personelit PAE ne UPT.PDF</i>  <i>Ref_057 Procedura e punesimit te personelit PAK ne UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/vendepune">https://upt.al/vendepune</a>  <a href="https://fim.upt.rash.al/ep-content/uploads/2020/10/FIM-Personeliakademik-me-kohe-te-pjesshme-2020-2021.pdf">https://fim.upt.rash.al/ep-content/uploads/2020/10/FIM-Personeliakademik-me-kohe-te-pjesshme-2020-2021.pdf</a>  <a href="https://fim.upt.rash.al/index.php/njoftime/njoftime/">https://fim.upt.rash.al/index.php/njoftime/njoftime/</a>  <a href="https://upt.al/images/stories/punesim/Shpallje_FIM_Karriera.pdf">https://upt.al/images/stories/punesim/Shpallje_FIM_Karriera.pdf</a>  <i>Ref_069 Praktike punesimi staf akademik FIM.PDF</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton, në bazë të dokumentave të shqyrtuara, se institucioni ka ndjekur procedura rekrutimi dhe vlerësimi të personelit akademik, të cilat kanë garantuar përzgjedhjen e një personeli me kualifikimet e duhura, në përputhje me nevojat e departamenteve dhe lëndëve që personeli duhet të mbulojë. Sikurse e përmendëm edhe në kriteret më sipër të këtij standardi, kriteret specifike për programin Bachelor në Inxhinieri Ekonomike përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Prodhim Menaxhimit në bashkëpunim me Grupet Mësimore përkatëse. Kriteret specifike për personelin akademik për këtë program studimi kanë bazë kualifikimet akademike në përputhje me kërkesat e pozicionit vakant dhe fushën specifike sipas lëndëve të programit të studimit, eksperiencën në mësimdhënie, aktivitetin kërkimor-shkencor të kandidatit, etj. Përzgjedhja e kandidatëve nëpërmjet vlerësimit të dosjeve të aplikimit bëhet nga një komision “ad-hoc” i përbërë në shumicë nga përfaqësues të departamentit përkatës. Komisioni vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës dhe ia përcjell vendimin Dekanit të FIM, i cili pasi kontrollon rregullshmërinë e zhvillimit të konkurimit dhe zbatimit të kriterëve të propozuara, ia përcjell vendimin Rektorit të UPT për shpalljen e kandidatit fitues dhe lidhjen e kontratës së punës me të.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_006 Rregullore brendshme FIM.pdf</i></p>





	Ref_069 Praktike punesimi staf akademik FIM.PDF		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X


Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mjediset dhe kushtet e punës për personelin akademik dhe administrativ në UPT. Mbështetur tek dokumentacioni si dhe evidencat në mejdiset e vizituara, GVJ konstatoi se këto mjedise ofrojnë kushte të mira për të zhvilluar të gjitha proceset akademike dhe administrative, për përmbushjen me sukses të objektivave të procesit mësimor në tërësi. Vitet e fundit UPT ka ndërtuar një godinë të re si dhe ka rikonstruktuar mjediset e vjetra dhe godinën historike të universitetit. Ky restaurim ka sjellë një organizim të klasave dhe zyrave, duke përmiresuar ndjeshëm ambientet e punës dhe të mësimit. Të gjitha mjediset që lidhen me procesin mësimor janë të pajisura me mjete të teknologjisë së informacionit (kompjuter, projektorë, etj.) si dhe mbulohen nga rrjeti Wi-fi që ofron internet falas për stafin dhe studentët. Gjithashtu është instaluar një sistem ngrohje/ftohje, izolim termik dhe akustik, ndriçim led, shkallë emergjence, sistem monitorimi me kamera, sistem për mbrojtjen kundra zjarrit, etj.</p> <p><i>Referenca: Ref_070 Relacion per infrastrukturen e FIM.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Në bazë të Planit Strategjik të UPT 2019-2024, Pika III.1.1, konstatohet se zhvillimi i qëndrueshëm i kapaciteteve njerëzore në institucion është ndër prioritetet strategjike të UPT. Për zbatimin e strategjisë është hartuar një plan veprimi i cili përfshin krijimin e mundësive për kualifikim dhe specializime të mëtejshme të stafit me qëllim rritjen dhe zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ. Gjithashtu një rëndësi të madhe i është vënë ndërkombëtarizimit dhe intensifikimit të shkëmbimit të personelit akademik të UPT me universitetet perëndimore. Gjatë takimit me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, GVJ u informua se në kuadër të përmbushjes së objektivave strategjike, stafi akademik ka marrë pjesë në projekte Erasmus për shkëmbime mobiliteti, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UPT ka lidhur me universitete ndërkombëtare. Gjithashtu në kuadër të zhvillimit akademik dhe kërkimor – shkencor, FIM inkurajon stafin për pjesëmarrjen në konferenca e seminare kombëtare e rajonale, organizimin e konferencave etj. FIM në bashkëpunim me Departamentin e Prodhim Menaxhimit organizon konferencën shkencore, ku organizatorë janë anëtarë të stafit akademik të këtij departamenti. GVJ u informua që stafi akademik i departamentit është pjesëmarrës çdo vit në këtë konferencë. GVJ u informua në takimin me stafin akademik, që FIM i mbështet ata edhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 57


	<p>financiarisht për pjesmarrjen në konferenca të tjera shkencore dhe botimin e artikujve në revista të rëndësishme, gjithashtu konsiderohet si ngarkesë mësimore edhe angazhimi i pedagogëve në shkrimin e projekteve dhe aplikimi në thirrjet kombëtare ose ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024.pdf</i>  <i>Ref_066 Mobilitetet e realizuara 2017-2020.pdf</i>  <i>Ref_096 Procedura Mbulimi shpenzimeve te artikujve shkencore nga buxheti FIM.pdf</i>  <i>Ref_097 Procedura e njohjes ngarkeses ne ore mesimore te pedagogeve per hartim dhe aplikim projektsh ne FIM.pdf</i>  <i>Ref_098 Praktike miratim shpenzimesh per pjesmarrje konference.pdf</i>  <i>Ref_049 Marrëveshjet Institucionale UPT.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Për zbatimin e Planit Strategjik të UPT 2019-2024, sikurse e përmendëm edhe më sipër është hartuar një plan veprimi i cili përfshin krijimin e mundësive për kualifikim dhe specializime të mëtëjshme të stafit me qëllim rritjen dhe zhvillimin profesional të personelit akademik dhe administrativ. Në këtë kuadër GVJ shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion (“Praktikë miratimi shpenzimesh për trajnim stafi akademik”) ku evidentoi se FIM ka mbështetur pjesmarrjen e stafit në trajnime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu GVJ konstatoi evidenca të trajnimeve në lidhje me zhvillimin e mësimin online dhe përdorimit të metodave inovative të teknologjisë së informacionit si dhe trajnime në lidhje me përdorimin e platformës PITAGORA për menaxhimin e të dhënave të sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_002 Plani Strategjik i UPT 2019-2024.pdf</i>  <i>Ref_042 Udhëzues dhe manual për zhvillimin e mësimin në distancë.pdf</i>  <i>Ref_043 Manual përdorimi platforma Sekretarise Mesimore PITAGORA.pdf</i>  <i>Ref_067 Praktike miratim shpenzimesh per trajnim stafi akademik.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton, në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, që Departamenti i Prodhim Menaxhimit dhe FIM kanë angazhuar ndër vite, për realizimin e këtij programi studimi, burime optimale njerëzore, si përsa i përket numrit edhe kualifikimeve të tyre.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar (Aneks: Tabelat Përmbledhëse – Tabela 2), GVJ gjen evidenca për vitet akademike 2018-2019; 2019-2020; 2020-2021, kurse përsa i përket Ngarkesës Totale të personelit akademik gjejmë evidenca vetëm për vitin akademik 2019-2020 (Tabela 4).</p> <p>Nga të dhënat e shqyrtuara në tabelat e sipërpërmendura, konstatojmë se Departamenti i Prodhim Menaxhimit përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, gjatë vitit 2020 – 2021 ka angazhuar 19 pedagogë si personel akademik efektiv (PAE), 15 pedagogë me kontratë (PAK) si edhe 1 personel ndihmës akademik. Titujt dhe gradat e personelit akademik janë si më poshtë:</p>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 pedagogë me titullin akademik Profesor;</li> <li>- 5 pedagog me titullin akademik Profesor i Asociuar;</li> <li>- 14 pedagogë me gradën Doktor;</li> <li>- 14 pedagogë me kualifikimin MSc.</li> </ul> <p>Bazuar tek tabelat 1 dhe 2 të aneksit për vitet akademike 2018-2019; 2019-2020; 2020-2020, si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Prodhim Menaxhimit, i cili është edhe njësisia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, ka një angazhim të kënaqshëm të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi, duke përmbushur edhe kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit.</p> <p><i>Referenca:</i> Final-UPT-RVB-Bachelor_Ing_Ekon_Akreditim.pdf</p>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht		X
Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				
	X				

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e FIM dhe UPT dhe konstatoi se institucioni ofron një infrastrukturë moderne, komode dhe të përshtatshme për grupet mësimore të këtij programi studimi, në përputhje me natyrën specifike të programit dhe modulet e tij, si dhe në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në bazën ligjore. Bazuar tek dokumentacioni i shqyrtuar ("Relacion për infrastrukturën e FIM") GVJ konstaton se ky fakultet ka në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor mjediset e vetë fakultetit, si dhe mjedise të përbashkëta në godinën Korpusi Qendror i UPT dhe mjedise të tjera të përbashkëta me fakultetet e tjera.</p> <p>Ambientet në godinën e FIM janë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 salla leksionesh me një sipërfaqe totale 639.52 m<sup>2</sup>.</li> <li>- 15 salla seminaresh me sipërfaqe totale 663.17 m<sup>2</sup>.</li> <li>- Në godinë disponohet edhe një sallë për aktivitete promovuese me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup>.</li> <li>- 11 laboratorë për lëndët dhe një laborator informatike, në total 912.36 m<sup>2</sup>.</li> </ul> <p>Në godinën Shtesa e Korpusit Qendror tek Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, FIM ka në përdorim sipërfaqen prej 400.6 m<sup>2</sup>, ndërkohë që shfrytëzon në mënyrë të përbashkët me FIE, FTI dhe Rektoratin e UPT sipërfaqen 2203 m<sup>2</sup>. Në këtë godinë FIM zotëron 3 laboratorë për lëndët dhe 1 laborator informatike me sipërfaqe totale 276.55 m<sup>2</sup>.</p>


	<p>Nga sa konstatuam më sipër, GVJ konkludon që FIM ka siguruar mjedise të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike në programet e studimit që ofron.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_070 Relacion per infrastrukturen e FIM.pdf</i>  <i>Final-UPT-RVB-Bachelor_Ing. Ekon_Akreditim.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe mbështetur tek dokumentat e shqyrtuara (“Relacion për infrastrukturën e FIM”), GVJ konstaton se sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë fiks në mur si dhe burime të shumëfishta të furnizimit me energji elektrike dhe lidhje me kabëll për internetin. <i>Evidentohen disa mungesa për kompjutera në tavolinën e pedagogut në sallat e leksioneve, por kjo çështje u diskutua me lektorët të cilët pohuan se kryesisht pedagogët përdorin pajisjet personale kompjuterike.</i> Gjithashtu FIM ka në dispozicion edhe shumë ambjente laboratorike që i shërbejnë procesit mësimor por edhe atij kërkimor-shkencor. Të gjithë këto laboratorë janë të pajisur me pajisje elektronike specifike të programeve të studimit si dhe pajisje të teknologjisë së informacionit. GVJ u informua se këto pajisje rinovohen në mënyrë periodike sipas nevojave të përcaktuara nga departamentet përkatëse (“Informacion për laboratorët FIM”).</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_070 Relacion per infrastrukturen e FIM.pdf</i>  <i>Ref_054 Informacion labororet FIM.PDF</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar UPT zotëron 88 laboratorë specifik sipas moduleve lëndore dhe 12 laboratorë për informatikën. Nga këto, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike zotëron 15 laboratorë të cilët janë të pajisur me mjetet e nevojshme teknike dhe informatike për të zhvilluar orët e laboratorit të parashikuara në syllabuset e lëndëve, praktikat me studentët, por mund të përdoren gjithashtu edhe për kërkime dhe eksperimente shkencore nga stafi i FIM.</p> <p>Në lidhje me programin e studimit Inxhinieri Ekonomike por jo vetëm, lëndët e teknologjisë së informacionit si p.sh Bazat e Informatikës zhvillohen nga personeli akademik i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në laboratorët e këtij fakulteti, të cilët janë gjithashtu modernë dhe të pajisur me programe profesionale (gjuhët C, C++, Java, Python, sinjalet, rrjetat, sistemet elektronike, etj). Gjithashtu FIM ka një laborator CAD-i i cili është pajisur me kompjutera në të cilët është instaluar softëare-i AutoCAD.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Për sa u tha më sipër, GVJ konkludon se mjediset mësimore (klasat, labororet, etj) të UPT dhe FIM, si përgjigjëse për ofrimin e programit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, janë të pajisura me teknologji bashkëkohore e cila është në mbështetje të realizimit të objektivave formues të këtij programi studimi.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_070 Relacion per infrastrukturen e FIM.pdf</i></p>




	<i>Ref_054 Informacion labororet FIM.PDF</i> <i>Ref_072 Evidenca mbi labororet në UPT.pdf</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<p>Në bazë të Planit Mësimor dhe dokumentave të tjera të shqyrtuara (“Procedura të organizimit të praktikës profesionale në FIM”; “Model kontrate praktike”) si dhe në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Prodhim Menaxhimit, GVJ u informua që praktikat profesionale të studentëve në këtë program studimi kryhen kryesisht pranë subjekteve private apo publike, sipas fushës së interesit të vetë studentit. Për të mundësuar këtë proces institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me industrinë dhe institucione të tjera, organizata dhe kompani të ndryshme që operojnë në vend, duke krijuar mundësi të mira për eksperiencën e studentëve për të kryer praktikën profesionale për 2 javë.</p> <p>Gjithashtu gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi edhe 2 labororë specifike të FIM ku studentët mund të zhvillojnë praktikat profesionale brenda institucionit.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_011 Plani mesimor BSc Inxh Ekonomike 2020-2021 (1).pdf</i>  <i>Ref_051 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione.pdf</i>  <i>Ref_052 Model kontrate për praktikën FIM.pdf</i>  <i>Ref_053 Procedura e organizimit të praktikës profesionale në FIM.pdf</i>  <i>Ref_059 Praktika shkresore per realizimin e Praktikave Profesionale.PDF</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>			
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>			
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>		
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Sipas RVB dhe dokumentacionit të shqyrtuar, UPT ka Bibliotekën Shkencore të vet, në Sheshin Nënë Tereza, pranë FIM, të cilën GVJ e vizitoi gjatë ditës së dytë të vizitës në institucion. Kjo bibliotekë është me një sipërfaqe totale 1587 m<sup>2</sup>, e cila u shërben përdoruesve nga të gjitha njësitë kryesore të UPT, duke përfshirë edhe FIM. Kjo bibliotekë ofron 65570 tituj dhe 75 vende leximi. <i>GVJ konstaton se ky numër postesh leximi është i pamjaftueshëm për të përballuar të gjithë nevojat e studentëve të të gjithë programeve të studimit në UPT.</i></p> <p>Pavarësisht numrit të kufizuar të posteve, GVJ u informua se të gjithë studentët e UPT kanë mundësi të barabarta në përdorimin e saj, paradite ose mbase, dhe materialet e bibliotekës mund të përdoren ose në mjedisin e bibliotekës, ose mund të huazohen për përdorim të jashtëm në bazë të kërkesave të studentëve.</p>		

	<p>Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka gjithashtu një bibliotekë të vetën, vetëm për studentët dhe stafin e FIM. Ajo është e pajisur me afro 115 tituj dhe 45 poste leximi. GVJ u informua se aktualisht kjo bibliotekë i shërben studentëve vetëm me huazimin e librave në shtëpi, sepse salla e leximit nuk është e disponueshme për shkak të riorganizimit të FIM. Titujt e librave të kësaj biblioteke ishin në proces dixhitalizimi.</p> <p>Gjithashtu studentët dhe stafi i UPT-së kanë akses në Bibliotekën Dixhitale U-Library të mundësuar nga RASH që mundëson akses në EBSCO Publishing Databases.</p> <p>GVJ në bazë të konstatimeve të mësipërme, <i>sugjeron shtimin e ambjeteve të studimit në bibliotekat e institucionit, për ti dhënë mundësi studentëve kushte optimale studimi si të literaturës së bibliotekës, edhe të materialeve të tjera mësimore në funksion të programeve të studimit që ata ndjekin.</i> Në këtë mënyrë institucioni do të përmbushë edhe objektivat e ndërkombëtarizimit, duke u afruar me praktikatat e universiteteve në botë.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT.pdf</i>  <i>Ref_075 Biblioteka digjitale.PDF R</i>  <i>ef_103 Rregullore e Bibliotekës Shkencore.pdf <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a></i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Bibliotekën Shkencore të UPT, GVJ konstatoi se është e pajisur me një literaturë të pasur në një numër të konsiderueshëm të botimeve Shqiptare dhe të huaj. Ajo disponon libra, monografi, revista, akte kongresesh apo konferencash, manual, doracake, etj. Ajo që vlen për tu përmendur dhe duhet vlerësuar është fakti që në këtë bibliotekë realizohet nga një personel i specializuar restaurimi dhe lidhja e librave të vjetër dhe me rëndësi për institucionin. Gjithashtu aty bëhej edhe fotokopja e autorizuar e librave nëse kërkohej nga të interesuarit.</p> <p>Megjithatë, përpos fondit të pasur të librave dhe larmishmërisë të tyre, GVJ konstaton një numër të pakët të literaturës fizike, në shërbim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike. <i>GVJ sugjeron shtimin e këtij fondi, si me libra në gjuhë të huaj, si me përkthime apo botime të studiuesve shqiptarë dhe profesorëve të FIM.</i></p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT.pdf</i>  <i>Ref_075 Biblioteka digjitale.PDF</i>  <i>Ref_073 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2017- 2020.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sikurse e cilësuam edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, studentët dhe stafi i UPT-së kanë akses pa pagesë në Bibliotekën Dixhitale ULibrary të mundësuar nga RASH, që mundëson akses në EBSCO Publishing Databases. Gjithashtu institucioni ka siguruar përdorimin e sistemit COBISS i cili është i lidhur me bibliotekat e UPT. Ky sistem përfshin një rrjet të gjerë bibliotekash dhe shërben për krijimin e një sistemi katalogimi të përbashkët, ku përdoruesit mund të aksesojnë online secilën bibliotekë dhe të shfrytëzojnë katalogun në distancë. Në këtë sistem janë listuar Biblioteka Shkencore e UPT dhe Bibliotekat e FGJM, FIE,</p>




	<p>FIN/FAU. Përmes COBISS, studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT.pdf</i>  <i>Ref_075 Biblioteka digjitale.PDF</i>  <i>Ref_103 Rregullore e Bibliotekës Shkencore.pdf</i>  <a href="https://ulibrary.rash.al/">https://ulibrary.rash.al/</a>  <a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries">https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p><i>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion, se bibliotekat në UPT nuk janë të pajisura me kompjutera në postet e leximit, në mënyrë që të përdoren nga studentët për navigimin në bibliotekat online. Megjithatë në këto biblioteka ofrohet shërbimi i internetit wireless ose me kabëll, dhe studentët janë të lejuar të përdorin pajisjet e tyre kompjuterike në këto ambiente.</i></p> <p><i>GVJ e adresoi këtë problematikë në takimin me Përgjegjës të Departamentit të Prodhim Menaxhimit si dhe Dekanin e FIM, të cilët pohuan se me ristrukturimin e fakultetit dhe bibliotekës së FIM, që është në process, po punohet që edhe kjo çështje të zgjidhet.</i></p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p><i>GVJ u informua në takimin me punonjësit e Bibliotekës Shkencore që çdo vit akademik ju kërkohet departamenteve të përcaktojnë nevojat për tekste të reja dhe materiale të tjera që përbëjnë literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar të lëndëve të ndryshme. Më pas të gjitha kërkesat e fakulteteve mblidhen dhe i paraqiten drejtorisë së bibliotekës dhe parashikohet blerja e tyre sipas fondit të alokuar në parashikimin e buxhetit.</i></p> <p><i>Përsa i përket planit të detajuar të shtimit të zërave në bibliotekë, GVJ konstaton se institucioni ka planifikuar blerjen e titujve të rinj për periudhën 2017 – 2020 (sipas dokumentit “Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2017 – 2020). Vëmë re që fondi i parashikuar ka qenë në rritje nga viti në vit, por bien në sy që nuk janë të përfshirë të gjithë fakultetet, dhe nuk konstatojmë asnjë planifikim për blerje literature specifikisht për FIM si përgjegjës për këtë program studimi. Ashtu sikurse e evidentuam edhe në Kriterin 2 të këtij standardi, GVJ konstaton një numër të pakët të literaturës fizike në shërbim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike dhe sugjeron një planifikim më të mirë të kërkesave për shtimin e këtij fondi.</i></p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_073 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2017- 2020.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor</p>	<p><i>Bazuar tek informacioni i marrë gjatë vizitës në bibliotekën e UPT, GVJ konstaton që ajo qëndron e hapur në dispozicion të studentëve me këto orare: e Hënë - e Premte: 8.00 - 19.00; e Shtunë: 8.00 - 14.00. GVJ gjykon që orari është i përshtatshëm për tu shfrytëzuar nga studentët e interesuar,</i></p>




dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	duke qenë në një fashë të gjërë orari, pa ju çenuar oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Informacioni për oraret është i afishuar në mjediset e bibliotekës si dhe të institucionit.  <i>Referenca:</i> <i>Ref_074 Informacion mbi Bibliotekat në UPT.pdf</i> <i>Ref_103 Rregullore e Bibliotekës Shkencore.pdf</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>GVJ konstaton se institucioni e administrojnë informacionin që lidhet me studentët që në regjistrimin e tyre deri në diplomim, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky informacion administrohet fizikisht nga Sekretaria Mësimore në përmbushje të detyrave të saj të përcaktuara në Rregulloren e FIM dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore të FIM. Detyrat e Sekretarisë në lidhje me administrimin e të dhënave të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Plotëson të dhënat e studentëve në Regjistrin Themeltar;</li> <li>– Regjistron notat e studentëve në Regjistrin e Arritjeve Akademike;</li> <li>– Përgjigjet për plotësimin dhe mbajtjen e Regjistrit të Diplomave dhe Çertifikatave.</li> </ul> <p>Përveç administrimit të informacioneve në regjistrat fizikë, informacioni që administrojnë sekretaria ruhet edhe elektronikisht, nëpërmjet sistemit elektronik të menaxhimit të informacionit PITAGORA të ofruar nga RASH.</p> <p>GVJ u njoh me regjistrat gjatë vizitës në institucion dhe konstaton se plotësimi i tyre është në përputhje me kërkesat ligjore dhe të MAS.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Ref_006 Rregullore brendshme FIM.pdf</i> <i>Ref_089 Rregullore Sekretarise Mesimore FIM.PDF</i> <i>Ref_030 Modeli rregjistrave ne SM.pdf</i> <i>Ref_043 Manual perdorimi platforma Sekretarise Mesimore PITAGORA.pdf</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik,	Përsa i përket administrimit të dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, sikurse e kemi cilësuar edhe në Standardin IV.1, administrimi realizohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Sistemi i dokumentimit që përdor kjo zyrë



<p>personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>përbëhet nga dosjet fizike të personelit si dhe regjistrimi i informacioneve edhe në format elektronik. Në dosje gjenden dokumenta të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- CV e personelit (për personelin akademik, CV shoqërohet me fotokopje të artikujve dhe botimeve shkencore);</li> <li>- Fotokopje e pasaportës / ID;</li> <li>- Diplomat; - Gradat shkencore / titujt akademikë;</li> <li>- Libreza shëndetsore;</li> <li>- Kualifikime të tjera / informacione shtesë.</li> </ul> <p>Gjithashtu sipas Rregullores së FIM Neni 37, të dhënat e personelit administrohen nga Specialisti i Personelit dhe Arkivit (asistenti i Dekanit), i cili ka për detyrë të mbajë dhe të plotësojë dokumentacionin e punonjësve me të dhëna personale, kualifikimet e tyre, aktivitetin mësimor dhe shkencor, të plotësojë dosjet e tyre personale, etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ e pati të vështirë të shqyrojë dokumentacionin e administruar nga kjo zyrë.</p> <p>Përsa i përket aktivitetit të personelit akademik që lidhet me procesin mësimor, informacioni qarkullon midis pedagogëve, sekretarisë dhe studentëve nëpërmjet sistemit elektronik PITAGORA. Në takimin me studentët dhe pedagogët GVJ u informua që ky sistem ishte eficient duke ofruar informacione në kohë reale sipas kërkesave të tyre.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_006 Rregullore brendshme FIM.pdf</i>  <i>Ref_043 Manual perdorimi platforma Sekretarise Mesimore PITAGORA.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sikurse e evidentuam edhe më sipër, UPT përdor sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit PITAGORA. Sistemi lidh studentët me pedagogët dhe sekretarinë mësimore. Secili prej tyre ka ndërfaqës të dedikuar ku akseson ose shpërndan informacionin (<a href="https://upt.pitagora.rash.al/login">https://upt.pitagora.rash.al/login</a>). Aksesi bëhet duke përdorur kredencialet personale të secilit përdorues. Nëpërmjet sistemit PITAGORA pedagogët ju japin akses studentëve në syllabuset e lëndëve, materialet mësimore, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet etj. Nëpërmjet këtij sistemi, i cili përmban platforma të integruara, realizohet komunikimi apo kontrolli midis palëve sipas kompetencave të tyre, psh: rregjistri i frekuentimit javor të studentëve mund të kontrollohet në kohë reale nga sekretaria dhe titullarët. Midis pedagogëve dhe sekretarisë shkëmbehet informacioni për rezultatet e studentëve apo frekuentimin e tyre, apo midis studentëve dhe sekretarisë shkëmbehet informacion për notat, kreditet, etj, si dhe midis pedagogëve dhe studentëve shkëmbehet informacion për të gjithë materialin që lidhet me procesin mësimor. Nëpërmjet sistemit studentët mund të regjistrohen nëpër provime gjithashtu.</p> <p>Meqë sistemi PITAGORA ofron vetëm shpërndarjen e dokumentacionit midis përdoruesve, por jo komunikimin interaktiv, kjo gjë realizohet nëpërmjet klasave virtuale në Microsoft Teams. Gjithashtu komunikimi në fakultete realizohet nëpërmjet adresave zyrtare të email-it, p.sh. për FIM janë <a href="mailto:emër.mbiemër@fim.edu.al">emër.mbiemër@fim.edu.al</a>. Komunikimi zyrtar shkresor në</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	




	<p>UPT administrohet nga Sektori i Arkivit dhe Protokollit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Të dhënat e studentëve dhe dosjet e tyre administrohen nga sekretaria mësimore. Nëpërmjet faqes së Web-it të UPT (<a href="https://upt.al/">https://upt.al/</a>) shpërndahet informacion për palët e treta të interesuara për programet e studimit në UPT dhe aktivitetet e tjera që zhvillohen në institucion.</p> <p>Nga sa është cilësuar më sipër GVJ konkludon se sistemi elektronik i informacionit në UPT ka funksione dhe module të integruara të cilat ju mundësojnë stafit dhe studentëve komunikimin në kohë reale dhe shkëmbimin e dokumentave në mbështetje të procesit mësimor. Gjithashtu sistemi ju mundëson drejtuesve të institucionit aksesin në dokumenta apo raporte sipas nevojave të tyre.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_006 Rregullore brendshme FIM.pdf</i>  <i>Ref_043 Manual perdorimi platforma Sekretarise Mesimore PITAGORA.pdf</i>  <a href="https://upt.pitagora.rash.al/login">https://upt.pitagora.rash.al/login</a>  <i>Ref_089 Rregullore Sekretarise Mesimore FIM.PDF</i>  <i>Ref_030 Modeli rregjistrave ne SM.pdf</i>  <i>Ref_068 Shembull klase virtuale ne platformen Microsoft Teams.pdf</i></p>								
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ konstaton se UPT disponon web site-n e vet (<a href="https://upt.al/">https://upt.al/</a>) në të cilin janë të publikuara të gjitha informacionet në lidhje me: njësitë kryesore të këtij universiteti, programet e studimit që ofrohen sipas fakulteteve, kërkimin shkencor, bashkëpunimet, këshillimin e karrierës, projektet, njoftime të ndryshme, aktivitetet, etj. Informacionet janë të publikura në dy gjuhë: në shqip dhe në anglisht.</p> <p><i>Referenca:</i>  <a href="https://upt.al/en/nees">https://upt.al/en/nees</a>  <a href="https://upt.al/">https://upt.al/</a></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 1249 805 1317">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="805 1249 1013 1317">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1013 1249 1220 1317">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1220 1249 1426 1317">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="606 1317 805 1366"></td> <td data-bbox="805 1317 1013 1366"></td> <td data-bbox="1013 1317 1220 1366"></td> <td data-bbox="1220 1317 1426 1366" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<p><b>Standardi IV.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (“Projekt Buxheti Afatmesëm 2020 - 2022”) rezulton se institucioni harton raportin financiar në lidhje me kostot për student si dhe planin për mbështetje financiare të programeve të studimit në nivel universiteti. Raportimi financiar është detyrë e Administratorit të universitetit (Statuti i UPT). Gjithashtu nën varësinë e tij janë edhe Administratorët e fakulteteve. Administratori harton në mënyrë periodike raportin financiar i cili është</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 66




	<p>pjesë e raportit vjetor dhe miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Në këtë raport paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar, si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. GVJ konstaton se planifikimi buxhetor hartohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_099 Projekt Buxheti Afatmesëm 2020-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit bëhet në nivel universiteti. Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën afatmesme 2020 – 2022 të UPT-së përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ardhurat</li> <li>- Fondin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrin e punonjësve</li> <li>- Shpenzimet operative</li> <li>- Shpenzimet kapitale</li> </ul> <p>Këto detajime përfshijnë zërat e shpenzimeve, pagat dhe sigurime shoqërore, bursat e studentëve, shpenzimet operative të detajuara, investimet për mirëmbajtjen e mjediseve, blerjen e pajisjeve laboratorike, shpenzimet për pasurimin e bibliotekës, aksesin në bibliotekat "online", etj. UPT nuk harton plane financimi të veçanta për çdo program studimi, por merr në konsideratë kostot e institucionit në përcaktimin e kuotave dhe tarifave.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_099 Projekt Buxheti Afatmesëm 2020-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Si institucion publik, UPT kryen auditim nga KLSH dhe MAS. Gjithashtu kryen auditim të përvitshëm të brendshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar realizohet në mënyrë periodike dhe përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare. Ky raport paraqitet nga Administratori i universitetit pranë Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratim. UPT publikon çdo vit raportin e vet për veprimtarinë financiare të universitetit dhe e vë atë në dispozicion të publikut. Gjithashtu raportet financiare që pasqyrojnë të ardhurat dhe shpenzimet e UPT për çdo vit financiar dërgohen në MAS.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar ("Projekt Buxheti Afatmesëm 2020-2022") GVJ konstaton se Bordi i Administrimit diskuton dhe miraton të gjitha raportet dhe analizat financiare periodike të hartuara nga Drejtoria Ekonomike dhe Administratori i UPT. Raportet përshkruajnë realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, të detajuara për pagat, sigurimet shoqërore, shpenzimet operative dhe investimet. Konstatohet se në planin e buxhetit afatmesëm bëhen planifikime dhe ndërhyrje për</p>




	të garantuar mbarëvajtjen e të gjithë programeve të studimit që ofrohen në UPT.		
	<i>Referenca:</i> <i>Ref_099 Projekt Buxheti Afatmesëm 2020-2022.pdf</i> <a href="https://upt.al/dega-finance">https://upt.al/dega-finance</a>		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se të ardhurat e UPT-së përbëhen nga granti nga buxheti i shtetit dhe tarifat për / gjatë shkollimit. Gjithashtu të ardhurat vijnë edhe nga shërbime të tjera që ofron institucioni si dhe të ardhura të përfituara nga aktivitete të ligjshme, në përputhje me Statutin e UPT. Për periudhën e raportimit (2017-2019) konstatohet se mesatarisht rreth 66% e të ardhurave financohen nga shteti dhe rreth 34% e tyre gjenerohen prej UPT. Buxheti vjetor i UPT ka pësuar rritje të vazhdueshme me 8-10 %/vit gjatë viteve të fundit. Në të ardhurat që vetë UPT gjeneron, 53% burojnë nga tarifa e shkollimit. Bazuar në raportet financiare, GVJ konkludon që UPT ka burime të mjaftueshme për të realizuar objektivat në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve me studentët.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_100 Tabela e të ardhurave dhe investimeve 2017-2020.pdf</i>  <i>Ref_101 Lista e shërbimeve të ofruara për të tretë.pdf</i>  <i>Ref_102 Shërbimet e kryera për të tretë.pdf</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmirësimi</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmirësimi</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>


## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në	GVJ konstaton se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve në UPT, nga hyrja në dalje janë të përcaktuara në dokumentat e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>– Statuti i UPT, Kreu VI dhe VII</li> </ul>


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 68




<p>përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullore e Zhvillimit Kurrikuar dhe Mësimdhënies, Kreu III-VIII</li> <li>- Rregullore e Brendëshme e FIM, Kreu VI</li> <li>- Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, Kreu II-IV, specifikisht për studentët e këtij programi studimi.</li> </ul> <p>Këto përfshijnë kriteret dhe procedurat e pranimit, procedurat e transferimit, organizimin e studimeve, diplomimin, etj. Këto politika dhe procedura janë hartuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi përkatësisht me Ligjin Nr. 80/2015, dhe udhëzimin e MASR, Nr. 10, datë 15.05.2019 si edhe Udhëzimin e MASR, Nr. 17, datë 30.07.2019 për pranimin e studentëve në programin e ciklit të parë të studimeve Bachelor. Në takimin me Dekanin e FIM dhe Përgjegjës të Departamentit të Prodhim Menaxhimit, GVJ u informua që këto procedura zbatohen me rigorozitet dhe njësoj për të gjithë studentët e regjistruar në UPT. Këtë gjë na e konfirmuan edhe studentët gjatë takimit me ta.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT.pdf</i>  <i>Ref_008 Rregullore brendshme departamenteve në FIM.pdf</i>  <i>Ref_010 Rregullore PS BSC në Inxhinieri Ekonomike.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UPT garanton barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë apo studentët që ndjekin studimet në programet që ofron universiteti. Pranimi i studentëve të rinj bëhet në përputhje me udhëzimet e MAS (sipas VKM 295, datë 10.5.2019), pasi studentët kanë përfunduar Maturën Shtetërore. Kriteret e pranimit shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe në portalin e RASH me qëllim bërjen publike të tyre për maturantët, përpara se ata të zgjedhin programet e preferuara. Studentët i nënshtrohen një procesi të barabartë të llogaritjes së pikëve dhe renditjes së listave sipas kriterëve të paracaktura dhe të bëra publike. Kriteret dhe procedurat e pranimit në programin Bachelor në Inxhinieri Informatike janë të qarta dhe të aksesueshme nga të gjithë kandidatët për studentë. Ato janë të paraqitura edhe në Rregulloren e Programit të Studimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në “Rregulloren e Zhvillimit Kurrikuar dhe Mësimdhënies” janë të përcaktuar qartësisht të gjitha aspektet që lidhen me organizimin e studimeve, të tilla si: vlerësimi i dijeve, format e kontrollit, parakushtet për të hyrë në provim, ankimimi, vlerësimi, kushtet e kalimit në vitin pasardhës, procedurat për transferimin e studimeve, njohja e krediteve, ndërprerja e studimeve, etj. Një mjet informues për gjithë ciklin e studimeve është edhe Guida studentore, e cila është në dispozicion të studentëve gjithashtu.</p> <p>GVJ konstaton që kriteret dhe procedurat e sipërpërmendura janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për cilindo që është i interesuar, nëpërmjet faqes së ëeb-it të UPT dhe FIM.</p>




	<p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT.pdf</i>  <i>Ref_008 Rregullore brendshme departamenteve ne FIM.pdf</i>  <i>Ref_010 Rregullore PS BSC ne Inxhinieri Ekonomike.pdf</i>  <a href="https://upt.al">https://upt.al</a>  <a href="https://fim.edu.al/info">https://fim.edu.al/info</a>  <i>Ref_025 Guida studentore.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton që UPT harton dhe publikon edhe kritere të veçanta për pranimin e kandidatëve në programet e studimit që ofron. Specifikisht për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike janë përcaktuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta si më poshtë:</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kandidatët duhet të kenë mesataren e shkollës së mesme mbi 6.5 sipas VKM 295, datë 10.5.2019</li> <li>- Renditja e aplikantëve do të bëhet referuar pikëve të grumbulluara sipas formulës: <ul style="list-style-type: none"> <li>o <math>[0.7 * \text{Mes}(\text{VKM}) + 0.3(0.5 * \text{Mes}(\text{Matematikë}) + 0.4 * \text{Mes}(\text{Fizikë}) + 0.1 * \text{Mes}(\text{Kimi})) * \text{Kkoef. Shkollës} * 1000]</math></li> <li>o Të gjithë komponentët e kësaj formule janë të spjeguar qartësisht në “Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Inxhinieri Ekonomike FIM”, Kreu II, Neni 10.</li> </ul> </li> </ul> <p>GVJ konstaton se hartimi i kriterëve bëhet në përputhje me udhëzimet dhe aktet nënligjore të përcaktuara nga MAS. Pranimi në këtë program studimi bëhet në përputhje me përcaktimet e “Nenit 19 të Rregullores të Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënie në UPT”, si dhe të “Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Inxhinieri Ekonomike FIM, Kreu II”, ku përcaktohet se: “pranimi është i mundur për çdo kandidat i cili ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ose zotëron një diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, si ekuivalente me të dhe që plotëson kriteret shtetërore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi”. Pranimi bëhet në bazë të kuotave të miratuara paraprakisht nga MAS. Institucioni ndjek një politikë të ndarjes së kuotave, ku 10% i alokon për kategori të veçanta të studentëve, si kandidatë nga trojet jashtë kufijve, shtetas të huaj, kandidatë nga shtresat në nevojë, kandidatë me aftësi të veçanta, sikurse edhe për transferim studimesh apo program të dytë studimi. Në bazë të dokumentave të shqyrtuara (“Praktika e miratimit të kuotave në FIM”) GVJ konstaton se për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, janë alokuar edhe kuota për studentë të huaj.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT.pdf</i>  <i>Ref_008 Rregullore brendshme departamenteve ne FIM.pdf</i>  <i>Ref_010 Rregullore PS BSC ne Inxhinieri Ekonomike.pdf</i></p>





	<i>Ref_026 Praktika e miratimit te kuotave te pranimit ne FIM.PDF</i> <i>Ref_027 Praktika e miratimit te kriterëve te pranimit ne FIM.PDF</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ konstaton se institucioni përdor mjete dhe metoda të ndryshme informimi për të maturantët dhe të interesuarit që dëshirojnë të ndjekin studimet në UPT. Në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale zhvillohen aktivitete informuese nga Zyra e Këshillimit të Karrierës të UPT, gjatë të cilave shpjegohen kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për tu pranuar në programet e studimit, si dhe shpërndahen fletë palosje me këto informacione. Gjithashtu informimi bëhet përmes faqes së Web-it të institucionit, mediave vizive, aktiviteteve që organizon Zyra e Këshillimit të Karrierës në UPT me Qendrat Rinore, etj.		
	<i>Referenca:</i> <i>Ref_033 Aktivitete informuese mbi programet e studimit.pdf</i> <i>Ref_034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës.pdf</i> <a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/Kriteret-pranimit%20per%20cikli%20I,%202023-24,%20Eeb.pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/Kriteret-pranimit%20per%20cikli%20I,%202023-24,%20Eeb.pdf</a>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

## Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se institucioni i ka përcaktuar qartësisht procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Neni 37 dhe 38. Këto procedura ju bëhen të ditura studentëve nëpërmjet disa formave të drejtpërdrejta ose të tërthorta të tilla si: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nëpërmjet faqes zyrtare të Web-it të UPT (<a href="https://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes">https://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes</a>).</li> <li>- Nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit PITAGORA ku studentët marrin të gjitha informacionit në lidhje me kushtet e përparimit apo kalimit nga një vit në tjetrin.</li> <li>- Studentët informohen në mënyrë të hollësishme nga pedagogët për këto procedura në fillim të studimeve të tyre që në vitin e parë, si dhe në fillim të çdo semestri secili pedagog prezanton syllabusin e lëndës si dhe procedurat për përparimin akademik, detyrimet e lëndës, mënyrën e vlerësimit, kërkesat për frekuentimin, etj.</li> <li>- Nëpërmjet Guidës studentore.</li> <li>- Një rol të rëndësishëm luan sistemi i tutorazhit akademik, nëpërmjet pedagogëve kujdestarë të cilët asistojnë dhe orientojnë studentët gjatë periudhës së studimeve.</li> </ul>


	<p>Në takimin që u zhvillua me studentët, GVJ u informua që ata ishin plotësisht të qartë për këto kritere.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes">https://upt.al/kushtet-e-kalimit-ne-vitin-pasardhes</a>  <a href="https://upt.pitagora.rash.al/login">https://upt.pitagora.rash.al/login</a>  <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve PS BSC Ing Ekonomike.pdf</i>  <i>Ref_025 Guida studentore.pdf</i>  <i>Ref_035 Lista e pedagogëve kujdestarë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Procedurat dhe kriteret për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme janë të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënie në UPT, Kreu VI. Studentët e interesuar kanë akses në informacionet që lidhen me këto kritere përmes faqes së webit të UPT (<a href="http://upt.al/transferime">http://upt.al/transferime</a>) dhe të FIM (<a href="https://fim.edu.al/info/regjistrimettransferime">https://fim.edu.al/info/regjistrimettransferime</a>) dhe Guidës studentore. Gjithashtu të interesuarit marrin informacion nëpërmjet Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Karrierës dhe Zv. Dekanit për anën mësimore.</p> <p>Procedura për transferimet është e përcaktuar në rregulloren e sipër cituar Neni 41. Drejtuesi i njësisë kryesore miraton komisionin “ad hoc” të njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve të përbërë nga 3-5 anëtarë të personelit akademik, të propozuar nga drejtuesi i njësisë bazë, për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me kriteret e vendosura dhe kuotat e parashikuara për çdo program studimi, si dhe njohjen e krediteve të fituara prej tyre në programet apo vitet e mëparshme të studimit. Komisioni “ad-hoc” shqyrton dokumentat e paraqitura nga kandidati, bën njohjen e lëndëve/moduleve që ka dhënë studenti me lëndët/modulet respektive të programit të studimit ku kandidati aplikon. Njohja e lëndëve/moduleve dhe krediteve bëhet duke patur parasysh kreditet e lëndës dhe programin e lëndës.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT.pdf</i>  <a href="http://upt.al/transferime">http://upt.al/transferime</a>  <a href="https://fim.edu.al/info/regjistrimettransferime">https://fim.edu.al/info/regjistrimettransferime</a>  <i>Ref_025 Guida studentore.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se studentët e këtij programi studimi informohen nga pedagogët e tyre në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve në fillim të çdo semestri kur bëhet prezantimi i çdo lënde. Këto kritere janë të shprehura qartë në çdo syllabus të lëndëve. Gjithashtu institucioni i ka të përcaktuara këto procedura në detaje edhe në “Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënie në UPT, Kreu V”, si dhe në dokumentin “Procedura për vlerësimin e dijeve në FIM” i cili është i publikuar në faqen e ëeb-it të institucionit. Gjithashtu një rol të rëndësishëm luan në këtë proces edhe sistemi i tutorazhit akademik dhe Sekretaria Mësimore.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT.pdf</i> <i>Ref_023 Syllabuset e lendeve PS BSC Ing Ekonomike.pdf</i></p>







	<a href="https://fim.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura">https://fim.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura</a> <a href="http://upt.al/sesionet-e-provimeve">http://upt.al/sesionet-e-provimeve</a> Ref_041 Procedura per vleresimin e dijeve ne FIM.pdf		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<p>Kriteret dhe procedurat e diplomimit i gjejmë të përcaktuara në “Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Kreu VIII” si dhe në dokumentin “Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomës Bachelor”. Të gjitha procedurat janë të publikuara në faqen e web-it të UPT dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik. Specifikisht për këtë program studimi këto procedura janë të përcaktuara edhe në “Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike”. Studentët njihen me to jo vetëm përmes dokumentave, por edhe përmes pedagogëve udhëheqës të cilët caktohen që në fillim të vitit akademik të diplomimit dhe kanë detyrim ndjekjen dhe udhëzimin e studentëve në çdo hap të këtij procesi.</p> <p><i>Referenca:</i>  Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT.pdf  Ref_060 Procedura konceptimi dhe mbrojtja e diplomes bachelor.pdf  <a href="http://upt.al/diplomimi">http://upt.al/diplomimi</a>  <a href="https://fim.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura">https://fim.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura</a>  Ref_010 Rregullore PS BSC ne Inxhinieri Ekonomike.pdf</p>		
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Sikurse e cilësuam edhe në Standardin V.1 Kriteri 6, institucioni zhvillon periodikisht në periudhën para provimeve të Maturës Shtetërore si dhe përpara fillimit të vitit të ri akademik, takime informuese me të interesuarit dhe studentët e ardhshëm të këtij institucioni. Informacionet shpërndahen nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta që zhvillon Zyra e Këshillimit të Karrierës të UPT të tilla si Open Day, Ditët e Maturantëve, aktivitetet Work &amp; Study, si dhe nëpërmjet fletë palosjeve, Guidës studentore, publikimeve në faqen e web-it të UPT, mediat sociale, etj.</p> <p><i>Referenca:</i>  Ref_033 Aktivitete informuese mbi programet e studimit.pdf  Ref_034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës.pdf  Ref_025 Guida studentore.pdf  Ref_028 Njoftim per ceremonine e vitit te ri akademik.pdf</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

<b>Standardi V.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe	UPT zhvillon takime informuese me studentët e vitit të parë në javën e parë të fillimit të vitit akademik. Takimi organizohet sipas programeve të




<p>kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>studimit ku ata janë regjistruar, me pedagogët e secilit program sipas departamenteve që i ofrojnë ato programe. Studentët informohen për kohëzgjatjen e programit, numrin e krediteve që ka çdo vit apo gjithë ciklit të studimit, lëndët, etj. Përveç këtyre takimeve ky informacion bëhet i ditur edhe nëpërmjet faqet së web-it ku gjendet plani mësimor i çdo programi dhe struktura e tij. Gjatë vazhdimësisë së ciklit të studimeve studentët mund të marrin informacion në lidhje me strukturën dhe organizimin e programit të tyre të studimit në Sekretarinë Mësimore, nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Koordinatori i Programit, apo pedagogët kujdestarë.</p> <p>Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, Rregullorja e Programit përcakton strukturën e tij, me një kohëzgjatje 3 vite akademik në përfundim të të cilave përfitohen 180 kredite. Në Nenin 9 të kësaj Rregulloreje përcaktohen kategoritë e veprimtarive formuese, lëndët që bëjnë pjesë në secilën kategori dhe kreditet përkatëse për secilën prej tyre. Studentët kanë akses në këtë informacion edhe nëpërmjet Planit Mësimor të Programit të Studimit. Përveç aksesit në dokumenta, ata orjentoohen të navigojnë edhe informacionet që gjenden në faqen e ëeb-it të institucionit në lidhje me programin e studimit të tyre, për tu njohur me strukturën dhe organizimin e tij.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_010 Rregullore PS BSC ne Inxhinieri Ekonomike.pdf</i>  <i>Ref_011 Plani mesimor BSc Inxh Ekonomike 2020-2021 (1).pdf</i>  <i>Ref_028 Njoftim per ceremonine e vitit te ri akademik.pdf</i>  <a href="https://fim.upt.rash.al/index.php/programet/bachelo/">https://fim.upt.rash.al/index.php/programet/bachelo/</a>  <a href="https://fim.upt.rash.al/index.php/programet/bachelo/ing-ekonomike/">https://fim.upt.rash.al/index.php/programet/bachelo/ing-ekonomike/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se UPT ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila ka si mision të orientojë, inkurajojë dhe mbështesë studentët dhe të diplomuarit me mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit dhe udhëzimit në karrierë. Përfaqësuesit e kësaj zyre GVJ i takoi në ditën e dytë të vizitës në institucion. Ata na informuan që kjo zyrë është gjithë kohën në dispozicion të studentëve për këshillimin e karrierës. Ajo ka zhvilluar një sërë aktivitete (dokumenti “Aktivitete të organizuara nga zyra e karrierës”) duke ju dhënë studentëve informacione rreth mundësive të ndryshme që institucioni në bashkëpunim me partnerët ofron për trajnimet, aktivitete të ndryshme, internshipe, praktika profesionale dhe mundësitë e punësimit. UPT ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet publike dhe private, universitete në vend dhe të huaja. Në kuadrin e këtyre marrëveshjeve bëhet i mundur realizimi i praktikave mësimore të studentëve, të cilat shërbejnë dhe si pikënisje për punësimin e mëtejshëm të studentëve mbas diplomimit.</p> <p>Përsa i përket programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike në bazë të dokumentit “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve për periudhën 2017 - 2021, Tabela 8” konstatohet se numri i të diplomuarve është 197 ku 138 prej të cilëve janë punësuar në pozicione që</p>




	<p>përputhen me profilin e diplomës (reth 70%) dhe 59 janë punësuar jo në të njëjtin profil (reth 30%).</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës.pdf</i>  <a href="https://upt.al/keshillimi-i-karrieres?start=4">https://upt.al/keshillimi-i-karrieres?start=4</a>  <a href="https://fim.upt.rash.al/wpcontent/uploads/2019/06/UDH%c3%8bZUES-P%c3%8bRZHVILLIMIN-E-KARRIER%c3%8bS.pdf">https://fim.upt.rash.al/wpcontent/uploads/2019/06/UDH%c3%8bZUES-P%c3%8bRZHVILLIMIN-E-KARRIER%c3%8bS.pdf</a>  <i>Ref_049 Marrëveshjet Institucionale UPT.pdf</i>  <i>Ref_051 Marrëveshjet me industrinë dhe institucione.pdf Aneks-Tabelat Përmbledhëse-Tabela 8_RVB</i>  <i>Ref_090 Pyetësori dhe databaza Alumni UPT.pdf</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët GVJ u informua që ata kanë marrë informacion për të hollësishëm në lidhje me organizimin e procesit mësimor, klasat, labororet, bibliotekat, etj, gjatë javës së parë të fillimit të studimeve të tyre. Që në javën e parë ata pajisen me email zyrtar, nëpërmjet të cilit ata komunikojnë me pedagogët për orarin, klasat, procesin mësimor, etj. Çdo grupi mësimor i caktohet një kujdestar, që është pedagog i FIM, i cili realizon takime sipas një orari të caktuar, për të ndihmuar studentët për çdo paqartësi apo problem në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Informacionet në lidhje me organizimin e procesit mësimor, oraret, klasat, labororet, etj, janë të afishuara në stendat e FIM kati i tretë, si dhe në faqen e ëeb-it, seksioni i dedikuar për studentët.</p>						
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Sikurse e kemi përmendur edhe në Standardin IV.5 të këtij raporti, UPT përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit PITAGORA, nëpërmjet të cilit studentët informohen për të gjitha aspektet që lidhen me programin e tyre të studimit. Sistemi lidh studentët me pedagogët dhe sekretarinë mësimore. Secili prej tyre ka ndërfaqës të dedikuar ku akseson informacionin (<a href="https://upt.pitagora.rash.al/login">https://upt.pitagora.rash.al/login</a>). Aksesimi bëhet duke përdorur kredencialet personale të secilit përdorues. Nëpërmjet sistemit PITAGORA pedagogët ju japin akses studentëve në syllabuset e lëndëve, materialet mësimore, informacion mbi frekuentimin, vlerësimet e vazhduara, notat, kreditet etj. Ky sistem i jep mundësinë atyre të aksesojnë informacionet edhe në distancë. Gjithashtu GVJ u informua që pedagogët përdorin edhe platformën MS-Teams për të komunikuar me studentët në distancë, apo për të zhvilluar seanca mësimi apo konsultimi online, sipas nevojave të studentëve.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

#### Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 75

**Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.

**Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

**Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

Sikurse e kemi cilësuar edhe në Standardin IV.5, për këtë program studimi, Sekretaria Mësimore e FIM është përgjegjëse për administrimin e informacionit që lidhet me studentët që në regjistrimin e tyre deri në diplomim. Ky informacion ruhet në regjistra fizikë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Udhëzimin e MAS “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore“, Udhëzimin e MAS, Nr. 16, datë 08.07.2019 “Për pajisjen e institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve“. Përkatësisht Sekretaria Mësimore administron:

- Regjistrin Themeltar të studentëve;
- Regjistrin e Arritjeve Akademike (të notave);
- Regjistrin e Lëshimit të Diplomave.

Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ shqyrtoi regjistrat e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike dhe u njoh me statistikat që përmbanin të dhëna në lidhje me mesataret në hyrje dhe në dalje, rekordet për të larguarit, transferimet, numrin e të diplomuarve, etj. Këto statistika shërbejnë edhe si të dhëna për Raportin e Analizës Vjetore të FIM.

Bazuar në dokumentin: “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike për vitet akademike 2019 - 2022, Tabela 7” tabelat e mëposhtëme paraqesin për tre vitet e fundit përkatësisht:

Tabela 1: Numri i të regjistruarve dhe mesatarja përkatëse

Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje
2019-2020	109	8,56
2020-2021	85	8,70
2021-2022	85	8.79

Tabela 2: Numri i studentëve të transferuar dhe atyre të larguar

Viti akademik	Student të transferuar	Studentë të larguar
2019-2020	-	17
2020-2021	1	9
2021-2022	-	6

Informacioni në Tabelën 3 u mor pas kërkesës për dokumenta shtesë, gjatë vizitës së GVJ në Sekretarinë Mësimore.

Tabela 3: Numri i studentëve të diplomuar

Viti akademik	Studentë
2018-2019	27

		2019-2020	43
		2020-2021	58
	<p>Gjithashtu në këtë zyrë gjendet Regjistri i Aritjeve Akademike i cili përmban të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve. Fillimisht notat hidhen në Proces Verbalet e provimeve të cilat gjenerohen nga sistemi i informacionit PITAGORA, pastaj hidhen në Regjistrin e Aritjeve Akademike.</p> <p>GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat për studentët ruhen në dokumenta fizikë (hard copy) dhe elektronike. GVJ konstatoi se të gjitha të dhënat nëpër regjistrat e sipërpërmendur ishin plotësuar sipas standardeve që kërkon ligji.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisish dhe universiteti.pdf</i>  <i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM.pdf</i>  <i>Informacion shtese per Inxh Ekonomike.pdf</i>  <i>Ref_030 Modeli rregjistrave ne SM.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni disponon sistemin elektronik të menaxhimit të informacionit PITAGORA nëpërmjet të cilit menaxhon të dhënat statistikore të studentëve në lidhje me gjithë veprintarinë e tyre mësimore që në hyrje deri në dalje në programet e ndryshme të studimit. Në këtë sistem kanë akses studentët në llogaritë e tyre personale, pedagogët sipas moduleve apo lëndëve që drejtojnë si dhe sekretaria. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të studentëve kryhet bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Sistemi është i ndërtuar në mënyrë të tillë që t’ju japë mundësi editimi vetëm personave të autorizuar, dhe personave të tjerë legjitim vetëm qasje në informacion.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_043 Manual perdorimi platforma Sekretarise Mesimore PITAGORA.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sikurse e cilësuam edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, të dhënat që administron Sekretaria Mësimore nëpërmjet regjistrave të përcaktuara nga LAL Nr. 80/2015 dhe udhëzimet e MAS, përdoren edhe në hartimin e Raportit të Analizës Vjetore të FIM. Të dhënat për cilësinë në hyrje të studentëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, si dhe statistika në lidhje me diplomimin dhe punësimin e tyre janë paraqitur edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në Aneks Tabelat Përmbledhëse, përkatësisht Tabela 7: “Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve të Inxhinierisë Ekonomike” dhe Tabela 8: “Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve të Inxhinierisë Ekonomike” Statistikat në lidhje me shkallën e punësimit të studentëve mbahen edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila mban gjithashtu kontaktet me studentët e diplomuar.</p> <p><i>Referenca:</i></p>		

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 77




	<i>Ref_082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisish dhe universiteti.pdf</i> <i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM.pdf</i> <i>Ref_090 Pyetësori dhe databaza Alumni UPT.pdf</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstaton se përfshirja e studentëve dhe angazhimi i tyre në organet kolegjiale të UPT bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe garantohet nëpërmjet statutit të UPT Neni 49. Në bazë të Statutit të UPT si dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi studentët kanë përfaqësuesit e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senatin Akademik, 4 përfaqësues që zgjidhen me votim të përgjithshëm të studentëve çdo 4 vite.</li> <li>- Këshillin e Etikës, 1 përfaqësues që zgjidhet me votim të përgjithshëm të studentëve çdo 4 vite.</li> <li>- Këshillat e Programeve të Studimit 1 përfaqësues.</li> <li>- GVB të programeve të studimit, 1 përfaqësuese për secilin program.</li> </ul> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_083 Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin Akademik.pdf</i>  <i>Ref_003 Kodi i Etikës i UPT.pdf</i>  <i>Ref_020 Vendimi DFIM per ngritjen KPS.PDF</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në bazë të Statutit të UPT, Neni 51 studentët gëzojnë të drejtën e organizmave të tyre, të cilat janë të pavarura. Këshilli Studentor është një organizëm i studentëve të UPT, krijuar në 2015, ku ata shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UPT, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret, për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Kryetari dhe anëtarët e Këshillave Studentorë të UPT zgjidhen me votim nga gjithë studentët dhe kanë mandate 2 vjeçarë. Gjatë takimit me studentët GVJ u informua se zëri i studentëve dëgjohet jo vetëm nëpërmjet pjesmarrjes në këshilla të ndryshëm por edhe në nivele më të ulëta në diskutime me pedagogët për të zgjidhur problemet dhe shqetësimet e tyre. Një rol të rëndësishëm në këtë komunikim ka luajtur edhe Koordinatorin i Programit.</p> <p><i>Referenca:</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 78





	<p><i>Ref_086 Këshilli Studentor (Aktivitete).pdf</i>  <i>Ref_087 Rregullore për Këshillin Studentor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>GVJ konstaton se hartimi i Planit Mësimor të këtij programi është bërë në përputhje me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019. Programi Bachelor në Inxhinieri Ekonomike është me një kohëzgjatje 3 vjet dhe në fund të diplomimit studentët pajisen me 180 kredite evropiane (ECTS). Çdo vit akademik zgjat 30 javë mësimore i ndarë në 2 semestra me nga 15 javë. Plani mësimor respekton ngarkesën javore në auditor (maksimumi 25 orë në javë / 50 minutëshe). Numri i krediteve sipas viteve është përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 63 kredite për vitin e parë</li> <li>- 60 kredite për vitin e dytë</li> <li>- 57 kredite për vitin e tretë.</li> </ul> <p>Kreditet minimale europiane për një lëndë janë 3 ECTS dhe maksimumi 6 ECTS. Sipas Planit Mësimor ka një shpërndarje të ekuilibruar ndër vite midis numrit të orëve në auditor plus studimit individual. Kjo shpërndarje lehtëson edhe procedurat për transferimin e studentëve nga institucione të tjera drejt UPT ose anasjelltas, ose të studentëve që ndjkin bursat e mobilitetit Erasmus, ose studentëve që kalojnë në programe të tjera studimi brenda UPT. Sikurse është evidentuar edhe në standardet e mësipërme, kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose të studimeve të pjesëshme janë të përcaktuara në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, Kreu VI. GVJ konstaton që këto procedura janë të thjeshta dhe lehtësisht të kuptueshme nga studentët. GVJ u njoh me evidenca të këtyre procedurave për raste transferimi dhe ekuivalentimi të studimeve në rastin e ndjekjes së programeve të dyta të studimit.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_011 Plani mesimor BSc Inxh Ekonomike 2020-2021 (1).pdf</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT.pdf</i>  <i>Ref_045 Praktike transferim studimesh FIM.PDF</i>  <i>Ref_046 Praktike ekuivalentim program i dyle studimesh FIM.PDF</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët përfshihen në vlerësimin e programeve të studimit, duke kontribuar në përmirësimin e tyre të vazhduar nëpërmjet anketimeve që zhvillohen në fund të çdo semestri. Njësia Qëndrore e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton Raportin në bazë të të dhënave të marra nga pyetsorët. Ky raport analizon performancën e secilës lëndë, dhe të programit të studimit në tërësi. Raporti është pjesë e analizave në nivel departamenti dhe dekanati, duke adresuar problematikat dhe duke bërë ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_065 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit</p>	<p>GVJ konstaton se Procedurat e ankimimit janë të paraqitura në dokumentin “Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Neni 34 dhe 35”. Studentëve ju jepet mundësia të japin mendim për zhvillimin e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe të ankimojnë rezultatin e marrë apo të rishikojnë fletoren e provimit. Gjatë vizitës në institucion,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
Faqe 79




nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>në takimin me studentët e këtij programi studimi, GVJ u informua që studentët marrin vlerësimin për provimin e kryer dhe kanë të drejtë të sqarohen për çdo paqartësi ose të kundërshtojnë rezultatin, përpara se të hidhet nota në procesverbal. Pedagogu ballafaqon studentin me përgjigjet e tezës së zgjidhur dhe të dokumentuar në departament. Gjatë diskutimit me studentët ata u shprehën që procesi i vlerësimit të dijeve është transparent dhe i barabartë për të gjithë. Nëse studenti gjykon se ndaj tij ka pasur shkelje procedurale në provim apo vlerësim atëherë ai bën ankesë me shkrim në sekretarinë e Dekanit brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit, i cili pas gjykimit të çështjes merr vendim bazuar tek Neni 35 i “Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT” deri në zgjidhjen e problemit.</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT.pdf</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>


<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve dhe problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>GVJ konstaton se UPT ka ngritur disa njësi në shërbim të studentëve dhe informimit të tyre gjatë gjithë ciklit të programit të studimit për të gjitha aspektet që lidhen me procesin mësimor, orientimin e tyre për praktikat profesionale dhe tregun e punës, etj. Këto njësi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtoria e Kurrikulave e cila ka si pjesë të saj Sektorin e Kurrikulave dhe atë të Procesit Mësimor.</li> <li>- Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit e cila në Sektorin e Komunikimit me Publikun ka Specialistin për Këshillimin e Karrierës dhe Specialistin për ALUMNI</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Këto struktura funksionojnë si njësi të posaçme në shërbim të studentëve dhe informimit të tyre, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>Gjithashtu edhe Sekretaria Mësimore është në dispozicion të studentëve me informacione që lidhen me procesin mësimor, lëndët, kalimin nga njëri vit në tjetrin, kreditet, etj.</p> <p>GVJ konstaton se një rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit është vetë departamenti përgjegjës për çdo program studimit. Përkatësisht studentët asistohen nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshilli i Programit të Studimit, në përbërje të të cilit ka edhe studentë të cilët sjellin në mënyrë të drejtpërdrejtë pyetjet dhe kërkesat e studentëve.</li> </ul>







	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pedagogët Kujdestarë nëpërmjet sistemit të tutorazhit.</li> <li>- Koordinator i Programit të Studimit</li> </ul> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_005 Organigrama e UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/dega-mesimore">https://upt.al/dega-mesimore</a>  <a href="https://upt.al/sherbimi-i-rrjetit">https://upt.al/sherbimi-i-rrjetit</a>  <i>Ref_038 Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online.pdf</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie në UPT.pdf</i>  <i>Ref_020 Vendimi DFIM për ngritjen KPS.PDF</i>  <i>Ref_035 Lista e pedagogëve kujdestarë.pdf</i>  <i>Ref_089 Rregullore Sekretarise Mesimore FIM.PDF</i>  <i>Ref_006 Rregullore brendshme FIM.pdf</i></p>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Sikurse është cilësuar edhe në Standardin V.3 të këtij raporti, UPT ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh për studentët dhe të diplomuarit e UPT të cilat kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës. Konkretisht kjo zyrë ofron shërbime lidhur me këshillimin e karrierës, përmirësimin e përpilimit të një CV-je dhe letre motivimi, informon në lidhje me ofrimin e intershipeve, trajnimeve, vendeve të punës vakante apo kërkesat e kompanive që vijnë në këtë zyrë për studentët e programeve të studimit në UPT, etj.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar dhe krijon bazën e të dhënave të alumnit. Të dhënat e kësaj baze raportohen tek njësitë kryesore dhe përdoren në raportet e institucionit. Për këtë program studimi ato janë paraqitur në Aneks – Tabelat Përmbledhëse-Tabela 8.			
	<p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_090 Pyetësori dhe databaza Alumni UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/sherbimi-i-rrjetit/ sektori-i-komunikimit-mepublikun?start=4">https://upt.al/sherbimi-i-rrjetit/ sektori-i-komunikimit-mepublikun?start=4</a>  <i>Ref_034 Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës.pdf</i>  <a href="https://upt.al/keshillimi-i-karrieres?start=4">https://upt.al/keshillimi-i-karrieres?start=4</a>  <a href="https://fim.upt.rash.al/epcontent/uploads/2019/06/UDH%c3%8bZUES-P%c3%8bRZHVILLIMIN-E-KARRIER%c3%8bS.pdf">https://fim.upt.rash.al/epcontent/uploads/2019/06/UDH%c3%8bZUES-P%c3%8bRZHVILLIMIN-E-KARRIER%c3%8bS.pdf</a>  Aneks-Tabelat Përmbledhëse-Tabela 8_RVB</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	<b>X</b>
---	--	----------------------	-----------------------	----------





## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të Statutit të UPT Kreu IX, që institucioni ka parashikuar ngritjen e strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Sipas Nenit 78 të Statutit, ky sistem përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC) e ngritur në rektoratin e UPT</li> <li>- Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT</li> </ul> <p>NJQSC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe aktet rregullatore institucionale. Këto standarde miratohen nga Senati Akademik i UPT. Sipas Statutit të UPT përbërja e saj propozohet nga Senati Akademik, dhe në përbërje mund të angazhohen edhe ekspertë të jashtëm për çështje specifike. GVJ nuk konstaton përfshirjen e studentëve në këtë njësi, dhe as ndonjë dokument të përzgjedhjes së antëtarëve të NJQSC. Gjithashtu konstatohet që mungon Tabela 24 “Të dhëna për anëtarët e NJBSC” në listën e tabelave përmbledhëse të Aneksit të RVB. GVJ zhvilloi takimin me NJSC të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në ditën e parë të vizitës, dhe u informua që kjo njësi ka 4 anëtarë.</p> <p>NJSC ngrihen në njësitë kryesore dhe mbulojnë çdo program studimi dhe kërkimi-shkencor, që njësitë bazë ofrojnë.</p> <p>Pjesë e sistemit të sigurimit të cilësisë është edhe Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) të UPT, e ngritur me vendim të Senatit Akademik të UPT datë 26.03.2009 që varet nga Rektori i UPT. Sipas Statutit, anëtarët e NJSC, zgjidhen në përputhje me rregulloren e Sigurimit të Cilësisë. GVJ nuk gjen evidencë të këtij dokumenti dhe as të ngritjes së NJSC. Nuk evidentohet përfshirja e studentëve në këtë njësi gjithashtu.</p> <p>Megjithatë GVJ konstaton që institucioni i ka ngritur këto njësi të sigurimit të cilësisë, ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ka një sistem funksional. Përfshirjen e studentëve në sistemin e sigurimit të cilësisë e gjejmë në grupet (GVB) e punës të ngritura me urdhër të Dekanit, për administrimin e procesit të akreditimit të programeve të studimit.</p> <p><i>GVJ sugjeron përfshirjen e studentëve në Njësitë e Sigurimit të Cilësisë të njësisë kryesore dhe të institucionit, si dhe hartimin e rregullores së funksionimit të këtyre njësive apo manualit të cilësisë të institucionit.</i></p> <p><i>Referenca:</i> <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i></p>





	<p><i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a>  <i>Ref_019 Urdheri Dekanit FIM per ngritjen GVB.PDF</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ konstaton se UPT përdor instrumentat e duhura të Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në përputhje me Statutin e UPT Neni 81, kornizën ligjore në fuqi dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional 2 herë, dhe në akreditimin e dytë me Vendim Nr.01 të Bordit të Akreditimit më datë 07.01.2022 është vlerësuar pozitivisht për gjashtë vite.</p> <p>Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL.</p> <p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë në rang institucional dhe të programeve që ofron, UPT i nështrohet edhe vlerësimit nëpërmjet sondazhit kombëtar të studentëve, rezultatet e të cilit bëhen publike prej ASCAL.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_018 Vendimi Bordit ASCAL per akreditimin e UPT.pdf</i>  <a href="https://ëëë.asc.al/sq/sondazhi-kombetar-istudenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022">https://ëëë.asc.al/sq/sondazhi-kombetar-istudenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022</a></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në bazë të Statutit të UPT Neni 81 dhe Rregullores për Zhvillimin Kurrikular dhe Mësimdhënien në UPT Kreu IX, vlerësimi i brendshëm i programeve organizohet si rregull një herë në tre vjet. Instrumentat e përdorur nga NJSC për vlerësimin e brendshëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësi i studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në UPT</li> <li>- Pyetësi i studentëve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara prej stafit administrativ dhe ndihmës akademik në UPT</li> </ul> <p>Përfundimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionin. Rezultatet e vlerësimeve bëhen publike.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënie ne UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORT%20MBI%20ANKETIMIN%20STUDENTOR%20PER%20VITIN%20AKADEMIK%202021-2022%20(SEM%20I).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORT%20MBI%20ANKETIMIN%20STUDENTOR%20PER%20VITIN%20AKADEMIK%202021-2022%20(SEM%20I).pdf</a></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p><b>X</b></p>	




**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton që sipas Nenit 65 të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, njësia e posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit është Këshilli i Programit të Studimit (KPS). KPS ka 5 anëtarë për programet e ciklit të parë të cilët zgjidhen nga departamenti që ofron programin, midis tyre ka edhe 1 përfaqësues të studentëve, drejtuesi i KPS është Koordinator i Programit. Gjatë takimit me Përgjegjësën e Departamentit të Prodhim Menaxhimit dhe Dekanin e FIM, GVJ u informua se ky grup është ngritur dhe është funksional (Vendim i Dekanit Nr. 8, datë 15.04.2022).</p> <p>Në fund të çdo viti akademik, njësia bazë apo kryesore organizon rishikimin periodik të programit të studimit dhe të rregullores mësimore duke ia kërkuar këtë KPS. Për realizimin e këtij procesi KPS fokusohet tek: -</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Rishikimi i shpërndarjes së krediteve për disiplinat apo grupdisiplinat përkatëse.</li><li>- Rishikimi i programeve mësimore të lëndëve të veçanta.</li><li>- Rishikimi i elementëve përbërës të disiplinave dhe ndarja e krediteve ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratorë, etj.).</li><li>- Rishikimi i rregullores së programit të studimit.</li><li>- Rishikimi i bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimi i mangësive dhe marrja e masave për vitin pasardhës.</li><li>- Rishikimi i literaturës së përdorur, mungesat e vërejtura dhe masat për përmirësimin e situatës.</li><li>- Rishikimi i zbatimit të programit të studimit në vitin përkatës akademik.</li><li>- Rishikimi i procedurave të kontrollit të dijeve/provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit.</li><li>- Rishikim i feedback-ut të marrë nga studentët.</li></ul> <p>Në përfundim të procesit të rishikimit të programit, KPS mund të konkludojë në një nevojë për përmirësimin e elementëve të tij në masën 20% ose mund të sugjerojë riorganizimin e plotë të tij. Procedurat që ndiqen janë përcaktuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular. Propozimet e KPS i dërgohen për miratim Dekanit, nëpërmjet Përgjegjësës të Departamentit (Praktika e miratimit të planeve mësimore).</p> <p><i>Referenca:</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT.pdf</i> <i>Ref_020 Vendimi DFIM per ngritjen KPS.PDF</i> <i>Ref_044 Praktika e miratimit te planeve mesimore.PDF</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përdor instrumenta të ndryshëm për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit që ai ofron. Këto instrumenta përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kontrollat periodike që bëhen KPS.</li> <li>- Analizat që i bëhen procesit mësimor në departamentet përkatëse nga stafi akademik dhe përgjegjësi i departamentit, kryesisht në fund të çdo semestri.</li> <li>- Analizat vjetore në nivel njësie kryesore, e cila përfundon me hartimin e një raporti i cili përcillet në rektorat.</li> <li>- Analiza vjetore në rang institucioni e cila mbështetet tek raportet vjetore të fakulteteve dhe është pjesë e raportit vjetor ku përfshihen edhe raportet e analizës financiare dhe të punës kërkimore – shkencore, që UPT përcjell në MASR.</li> </ul> <p>Një peshë të rëndësishme në hartimin e këtyre raporteve zënë analizat e pyetsorëve të studentëve për vlerësimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_044 Praktika e miratimit te planeve mesimore.PDF</i>  <i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM.pdf</i>  <i>Ref_065 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti.pdf</i>  <i>Ref_063 Raportimi realizimit ngarkeses vjetore Pedagog Departament FIM.PDF</i>  <i>Ref_082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësishe dhe universiteti.pdf</i>  <i>Ref_091 Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies online sem ii 2019-2020.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sikurse u cilësua edhe në Kriterin 3 të këtij standardi, në përfundim të analizave që bëhen nga njësia bazë apo njësia kryesore hartohen raportet vjetore të cilat përcillen në nivelet drejtuese dhe vendimmarrëse, në Dekanat apo Rektorat, për vendimmarrje në lidhje me nevojat e evidentuara për ndryshime apo përmirësim.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>GVJ konstaton se Raporti Teknik që verifikon përputhshmërinë e programeve të studimit të rishikuara si rrjedhojë e analizave në njësitë bazë dhe kryesore, me standardet e cilësisë hartohet nga Drejtoria e Kurrikulave të Rektoratit, i cili më pas përcillet në Senatit Akademik për miratim.</p> <p>Këto raporte janë të dokumentuara dhe janë bërë të njohura për Dekanët, Përgjegjësat e Departamenteve, stafin dhe studentët. Gjithashtu janë publike edhe në faqen e ëeb-it të UPT.</p> <p>Në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Prodhim Menaxhimit, GVJ u informua që raportet diskutohen gjithmonë në departament dhe fakultet duke dhënë propozime përkatëse, të cilat më pas diskutohen në Mbledhjen e Rektoratit.</p> <p><i>Referenca:</i>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies ne UPT.pdf</i>  <i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM.pdf</i>  <i>Ref_065 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti.pdf</i></p>

	<i>Ref_063 Raportimi realizimit ngarkeses vjetore Pedagog Departament FIM.PDF</i> <i>Ref_082 Raport i aktivitetit mësues në nivel njësisish dhe universiteti.pdf</i> <i>Ref_091 Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimit online sem ii 2019-2020.pdf</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar GVJ konstaton se UPT realizon vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit në mënyrë periodike një herë në tre vjet (Statuti i UPT Neni 81). Nëse është e nevojshme këto vlerësime bëhet edhe më shpesh. Njësia e Brendshme e Cilësisë është ngritur në nivel institucional dhe në nivel fakultetesh. GVJ u informua se strukturat e njësive të sigurimit të cilësisë janë të reja dhe po punohet për konsolidimin e praktikave të tyre të punës si në nivel fakultetesh edhe në nivel departamentesh, për shtrirjen e veprimtarisë së tyre. Vlerësimet e bëra nga këto njësi janë pjesë e analizave vjetore si në nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Pëveç Njesisë së Sigurimit të Cilësisë, për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional, ngrihet Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga organizata studentore (Statuti i UPT Neni 80). Përfundimet e vlerësimit të brendshëm mbështeten në analizën statistikore të të dhënave, në konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin joakademik, studentët dhe grupet e interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionin. Këto analiza kanë shërbyer edhe në hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Institucional të UPT, si dhe në RVB për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ekonomike, që është në proces akreditimi.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf Final-UPT-RVB-Bachelor_Ing. Ekon_Akreditim.pdf</i>  <i>Ref_018 Vendimi Bordit ASCAL per akreditimin e UPT.pdf</i>  <i>Ref_019 Urdheri Dekanit FIM per ngritjen GVB.PDF</i>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni në përputhje me Statutin e UPT Neni 81, përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofron.</p>


<p>vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Ndër metodat e drejtpërdrejta, të cilat u referuan në takimin me Përgjegjësin e Departamentit të Prodhim Menaxhimit dhe pedagogët, ishin vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet vëzhgimeve në auditor. Përgjegjësi i Departamentit realizon vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së leksioneve/seminareve etj, praktikë që verifikon kryerjen e procesit të mësimdhënies nga pikpamja sasiore (orët për leksion, seminare, laboratore). GVJ konstaton se gjatë këtij kontrolli nuk përdoret ndonjë formular standard i miratuar për vlerësimin, dhe nuk prodhohen të dhëna të standardizuara për kontrollin e cilësisë, megjithatë vlerësimet e bëra shërbejnë për analizën mësimore që bëhet çdo fund viti akademik në nivel stafi, departamenti dhe fakulteti. Në fillim të vitit akademik Përgjegjësi i Departamentit kontrollon dhe vlerëson edhe përmbajtjen e syllabuseve. Në nivel institucional, Drejtoria e Kurrikulave monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës, dhe raporton në Rektorat mbi rezultatet e monitorimit.</p> <p>Ndër metodat e tërthorta të vlerësimin janë sondazhet e intervistat me studentët aktualë që realizohen çdo fund semestri për vlerësimin e procesit mësimor në tërësi. Gjithashtu janë realizuar edhe sondazhe me të diplomuarit (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ. UPT disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme. Për ngritjen e rrjetit Alumni ka filluar puna përmes një pyetësori për të identifikuar studentët e diplomuar në UPT dhe për të ndjekur zhvillimin e karrierës së tyre. Deri më sot është krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e rrjetit Alumni në UPT. Nëpërmjet këtij rrjeti UPT merr informacion në lidhje me përputhshmërinë e programeve të studimit që ofron me tregun e punës.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_065 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti.pdf</i> <i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM.pdf</i>  <i>Ref_082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisish dhe universiteti.pdf</i>  <i>Ref_091 Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies online sem ii 2019-2020.pdf</i>  <i>Ref_090 Pyetësori dhe databaza Alumni UPT.pdf</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e</p>	<p>Në bazë të Statuti të UPT Kreu IX dhe takimit me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ konstaton se UPT ka ngritur</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
 Faqe 87



<p>brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në të gjithë njësitë përbërëse organizative. Këto struktura janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia Qendrore e Sigurimit të Cilësisë (NJQSC) e ngritur në rektoratin e UPT.</li> <li>- Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të UPT.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Këto struktura kanë në përbërje staf efektiv të institucionit, dhe sipas Nenit 79 të Statutit, institucioni mund të angazhojë periodikisht edhe ekspertë të jashtëm për çështje specifike ose/edhe specialistë të nivelit të lartë të fushës së sigurimit të cilësisë sipas nevojës për konsulencë, ekspertizë ose për çështje të tjera. Sikurse e kemi evidentuar edhe në Standardin VI.1, GVJ nuk konstaton përfshirjen e studentëve në këtë njësi dhe as të ekspertëve të jashtëm në NJQSC. GVJ zhvilloi takimin me NJSC të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në ditën e parë të vizitës, dhe u informua që kjo njësi ka 4 anëtarë. GVJ sugjeron përfshirjen e studentëve në Njësitë e Sigurimit të Cilësisë të njësisë kryesore dhe të institucionit dhe evidentimin e rolit të tyre dhe të ekspertëve të jashtëm të përfshirë në këtë proces.</p> <p>GVJ konstaton përfshirjen e studentëve në sistemin e sigurimit të cilësisë në grupet (GVB) e punës të ngritura me urdhër të Dekanit, për administrimin e procesit të akreditimit të programeve të studimit. Gjithashtu studentët janë të përfshirë në KPS, të cilat gjithashtu shërbejnë si njësi të monitorimit dhe vlerësimit të mbarëvajtjes së procesit mësimor dhe programeve të studimit në tërësi.</p> <p>GVJ konstaton se roli i këtyre njësive dhe detyrat e anëtarëve të tyre janë përcaktuar qartë në Statutin e UPT, përkatësisht funksionet e NJQSC në Nenin 79 dhe funksionet e NJSC në nenin 80. Gjithashtu në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular përcaktohen qartë funksionet e KPS dhe të anëtarëve të saj.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies në UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a>  <i>Ref_019 Urdheri Dekanit FIM per ngritjen GVB.PDF</i>  <i>Ref_020 Vendimi DFIM per ngritjen KPS.PDF</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia bazë dhe kryesore është e përfshirë realisht në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programeve të studimit që ajo ofron, nëpërmjet Këshillave të Programeve të Studimit dhe Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm, në të cilët ka përgaqsues të stafit akademik dhe studentëve të lidhura drejtpërdrejt me këto programe.</p> <p>Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit edhe nëpërmjet pjesmarrjes së tyre në sondazhet semestrale të vlerësimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_019 Urdheri Dekanit FIM per ngritjen GVB.PDF</i>  <i>Ref_020 Vendimi DFIM per ngritjen KPS.PDF</i>  <i>Ref_065 Anketimi Studentor - Pyetësi dhe Raporti.pdf</i>  <i>Ref_091 Raport mbi anketimin studentor cilësia e mesimdhënies online sem ii 2019-2020.pdf</i></p>






<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në takimin me përfaqësuesit e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ u informua që anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë kanë respektuar integritetin akademik dhe kanë shmangur pabarazinë dhe diskriminimin. Kjo është reflektuar si në realizimin e pyetësorëve të studentëve i cili ruan anonimatit e tyre, edhe në dhënien e rezultateve të sondazheve të cilat kanë qenë gjithmonë në përputhje me rregullat për ruajtjen e privatësisë dhe integritetit akademik. Kjo gjë u pohua edhe në takimin me stafin akademik.</p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sikurse e kemi evidentuar edhe në Kriterin 1 të këtij standardi, në lidhje me këtë kriter, për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, nuk evidentohet ndonjë përfshirje konkrete e bashkëpunëtorëve apo aktorëve të tjerë të jashtëm të përfshirë në programet e studimit që ofrohen nga institucioni.</p> <p>Megjithatë sipas RVB dhe diskutimeve me Përgjegjësin e Departamentit dhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ u informua që ekspertiza e bashkëpunëtorëve ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën, në konferenca të ndryshme, në leksione të hapura, ëorkshop-e etj. Nga sa më sipër, <i>GVJ sugjeron se kjo pjesëmarrje të jetë më konkrete edhe në njësitë e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional, apo edhe të njësisë kryesore.</i></p> <p><i>Referenca:</i>  <i>Ref_001 Statuti i UPT.pdf</i>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		<b>X</b>	
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	<b>X</b>						

<p><b>Standardi VI.5</b></p>	
<p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ konstaton se informacionet në lidhje me organizimin dhe veprimtarinë e njësive për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në UPT janë të publikuara në faqen e ëeb-it të institucionit (<a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a>). Gjithashtu informacioni përcillet në institucion nëpërmjet njësive bazë tek stafi dhe studentët nëpërmjet shkresave zyrtare apo raporteve të hartuara nga këto njësi.</p> <p>Gjithashtu institucioni publikon në faqen e ëeb-it vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit, të cilat janë transparente dhe lehtësisht të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Informacionet e publikuara në raportet e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë respektojnë lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
 Faqe 89




	<p><i>Referenca:</i>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a>  <a href="https://upt.al/senati">https://upt.al/senati</a>  <a href="https://upt.al/keshilli-i-administrimit">https://upt.al/keshilli-i-administrimit</a>  <a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORT%20MBI%20ANKETIMIN%20STUDENTOR%20PER%20VITIN%20AKADEMIK%202021-2022%20(SEM%20I).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORT%20MBI%20ANKETIMIN%20STUDENTOR%20PER%20VITIN%20AKADEMIK%202021-2022%20(SEM%20I).pdf</a>  <i>Ref_065 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti.pdf</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, GVJ konstaton që NJQSC analizon rezultatet e nxjerra nga anketimet e studentëve në disa nivele të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nivel Institucioni</li> <li>- Nivel Fakulteti</li> <li>- Nivel Programesh Studimi</li> <li>- Nivel Pedagogu</li> </ul>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të këtyre rezultateve ajo ka nxjerr edhe konkluzione dhe ka dhënë rekomandime që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara (Raport mbi Anketimin e studentëve 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020, 2021-2022).</p> <p>Gjatë takimit me Përgjegjësën e Departamentit të Prodhim Menaxhimit, si dhe Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, GVJ u informua se raportet e NJSC janë analizuar në mbledhjet e departamentit, dhe janë marrë masa për zgjidhjen problematikave të evidentuara.</p> <p><i>Referenca:</i>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a>  <a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORT%20MBI%20ANKETIMIN%20STUDENTOR%20PER%20VITIN%20AKADEMIK%202021-2022%20(SEM%20I).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORT%20MBI%20ANKETIMIN%20STUDENTOR%20PER%20VITIN%20AKADEMIK%202021-2022%20(SEM%20I).pdf</a>  <i>Ref_065 Anketimi Studentor - Pyetësori dhe Raporti.pdf</i>  <i>Ref_048 Raporti Analizes Mesimore Staf Departament FIM.pdf</i>  <i>Ref_082 Raport i aktivitetit mësimor në nivel njësisish dhe universiteti.pdf</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit si dhe mbështetur tek informacioni i marrë në takimin me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ konstaton se NJQSC dhe NJSC informojnë periodikisht stafin dhe studentët në lidhje me veprimtarinë e tyre si dhe instrumentat që përdoren për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Kjo gjë realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore.</li> <li>- Publikimit të njoftimit në rrjetet promovuese online të Universitetit.</li> <li>- Publikimit të njoftimeve në llogaritë personale në UPT.</li> </ul> <p>- Faqes së web-it <a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete">https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete</a></p> <p>Objektivi nuk është vetëm informimi por edhe pjesmarrja e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="590 1713 790 1792">Përmbushet</th> <th data-bbox="790 1713 1013 1792">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1013 1713 1204 1792">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="590 1792 790 1834"></td> <td data-bbox="790 1792 1013 1834"></td> <td data-bbox="1013 1792 1204 1834" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)  
 Faqe 91




**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike”  
të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”**

**Pika të forta dhe afirmime:**

1. IAL disponon një infrastrukturë të mirë materiale për të realizuar suksesshëm mësimdhënien në programin e aplikuar për akreditim, si dhe ambiente për zhvillimin e praktikave sipas kërkesave të lëndëve inxhinierike.
2. Programi Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike” është një program studimi i alternuar midis bazës inxhinierike dhe ekonomike, në të cilin studentët fitojnë aftësi të mira analitike dhe organizuese.
3. Departamenti i Prodhim Zhvillimit ka në përbërje të tij një staf pedagogësh që e njohin mirë praktikën dhe janë profesionistë me eksperiencë disa vjeçare në mësimdhënie.
4. IAL ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe organizata të cilat ndihmojnë në rritjen e profesionalizmin të studentëve përmes zhvillimit të praktikave mësimore.
5. UPT ka një pjesëmarrje të gjerë në projekte dhe i ka dhënë një rëndësi të madhe ndërkombëtarizimit dhe intensifikimit të shkëmbimit të personelit akademik të UPT me universitetet perëndimore. Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi ka qenë pjesë e këtyre projekteve dhe ka kontribuar si në sjelljen e eksperiencave më të mira të fituara edhe të fondeve për ngritjen e kapaciteteve në institucion.
6. UPT përdor një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit që ka funksione dhe module të integruara të cilat ju mundësojnë stafit dhe studentëve komunikimin në kohë reale dhe shkëmbimin e dokumentave në mbështetje të procesit mësimor. Gjithashtu sistemi ju mundëson drejtuesve të institucionit aksesin në dokumenta apo raporte sipas nevojave të tyre.

**Pika të dobëta:**

1. IAL ka nevojë të bëjë një studim më të mirfilltë tregu për të kuptuar saktë nevojën që ka tregu për programin e studimit.
2. Kurrikula e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Ekonomike” në programet lëndore shfaq literaturë të papërditësuar në një pjesë të tyre.
3. Institucioni nuk ka një planifikim të detajuar të përditësimit të literaturës apo blerjes së një fondi periodik të librave, sipas fakulteteve dhe për më tepër specifikisht për këtë program studimi.
4. Institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe ka një sistem funksional, por nuk ka siguruar një përfshirje konkrete të studentëve në të.



### Rekomandime:

1. GVJ sugjeron realizimin e një studimi tregu të vazhdueshëm në lidhje me përditësimin e teknologjive, kërkesave dhe pritshmërive të punonjësve të studentëve të programit të studimit *[Standardi I.3, Kriteri 2]*.
2. GVJ sugjeron një rishikim të renditjes dhe përmbajtjes së disa prej lëndëve të ofruara në programin e studimit *[Standardi II.1, Kriteri 4]*.
3. GVJ konstaton që literatura bazë dhe e rekomanduar në një pjesë të lëndëve është më e vjetër se 5 vjet dhe sugjeron përditësimin e tyre *[Standardi II.1, Kriteri 6]*.
4. GVJ sugjeron shtimin e fondit të librave në bibliotekë, si me libra në gjuhë të huaj, si me përkthime apo botime të studiuesve shqiptarë dhe profesorëve të FIM, gjithashtu sugjeron një planifikim më të mirë të kërkesave për shtimin e këtij fondi specifikisht për FIM dhe këtë program studimi. *[Standardi IV.4, Kriteri 2 dhe 5]*.
5. GVJ sugjeron përfshirjen e studentëve në Njësitë e Sigurimit të Cilësisë të njësisë kryesore dhe të institucionit, si dhe hartimin e rregullores së funksionimit të këtyre njësisë apo manualit të cilësisë të institucionit *[Standardi VI.1, Kriteri 2]*.

### Conclusions of the evaluation of the Bachelor study program in “Economic Engineering” of the Higher Education Institution “Polytechnic University of Tirana”

#### Strengths and Affirmations:

1. HEI has a good material infrastructure to successfully carry out teaching in the program applied for accreditation, as well as facilities for the development of practices according to the requirements of engineering subjects.
2. The Bachelor program in "Economic Engineering" is an alternating study program between the engineering and economic base, in which students acquire good analytical and organizational skills.
3. The Department of Production and Development has in its composition a staff of lecturers who know the practice well and are professionals with several years of experience in teaching.
4. HEI has a number of cooperation agreements with public institutions and organizations that help increase the professionalism of students through the development of teaching practices.
5. UPT has a wide participation in projects and has given great importance to the internationalization and intensification of the exchange of academic personnel of UPT with Western universities. The academic staff involved in this study program has been part of these projects and has contributed both in bringing the best experiences gained and funds for capacity building in the institution.
6. UPT uses an electronic information management system that has integrated functions and modules that enable staff and students to communicate in real time and exchange documents in support of the learning process. Also, the system allows the institution's managers access to documents or reports according to their needs.

### Weaknesses:

1. HEI needs to do a more thorough market study to correctly understand the market's need for the study program.
2. The curriculum of the Bachelor study program in "Economic Engineering" in the subject programs shows outdated literature in some of them.
3. The institution does not have a detailed planning of updating the literature or purchasing a periodic fund of books, according to the faculties and moreover specifically for this study program.
4. The institution has established the Quality Assurance Unit, has designed and implements a strategy for continuous quality improvement and has a functional system, but has not ensured a concrete involvement of students in it.

### Recommendations:

1. EET suggests conducting a continuous market study regarding the updating of technologies, requirements and expectations of workers of students of the study program [*Standard I.3, Criterion 2*].
2. EET suggests a review of the order and content of some of the subjects offered in the study program [*Standard II.1, Criterion 4*].
3. EET finds that the basic and recommended literature in some subjects is older than 5 years and suggests their updating [*Standard II.1, Criterion 6*].
4. EET suggests increasing the books fund in the library, both with books in foreign languages, as well as with translations or publications of Albanian researchers and FIM professors, and also suggests a better planning of requests for increasing this fund specifically for FIM and this study program [*Standard IV.4, Criterion 2 and 5*].
5. EET suggests the inclusion of students in the Quality Assurance Units of the main unit and the institution, as well as the drafting of the regulation of the operation of these units or the institution's quality manual [*Standard VI.1, Criterion 2*].



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen kryesisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>